

## PASQYRA E LËNDËS

1. Hyrje.....
- 1.1. Parathënie.....
- 1.2. Kontekst.....
- 1.3. Marrëdhënies ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë.....
2. Kriteret politike .....
- 2.1. Demokracia dhe shteti i së drejtës .....
- 2.2. Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve .....
- 2.3. Çështjet rajonale dhe detyrimet ndërkombëtare .....
3. Kriteret Ekonomike .....
- 3.1. Ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale.....
- 3.2. Aftësia për të përballuar tryshinë e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda BE.....
4. Standardet evropiane .....
- 4.1. Tregu i brendshëm .....
- 4.1.1. Lëvizja e lirë e mallrave.....
- 4.1.2. Lëvizja e personave, shërbimeve dhe e drejta e vendosjes .....
- 4.1.3. Lëvizja e lirë e kapitalit.....
- 4.1.4. Doganat dhe tatimet .....
- 4.1.5. Konkurrenca.....
- 4.1.6. Prokurimi publik.....
- 4.1.7. Ligji i pronësisë intelektuale .....
- 4.1.8. Punësimi dhe politikat sociale.....
- 4.1.9. Arsimi dhe kërkimi shkencor.....
- 4.1.10. Çështjet e OBT-së.....
- 4.2. Politikat sektoriale.....
- 4.2.1. Industria dhe SME
- 4.2.2. Bujqësia dhe peshkimi .....
- 4.2.3. Mjedisi.....
- 4.2.4. Politikat e transportit .....
- 4.2.5. Energjia .....
- 4.2.6. Shoqëria e informimit dhe media.....
- 4.2.7. Kontrolli financiar.....

4.2.8.	Statistikat .....
4.3.	Drejtësia, liria dhe siguria .....
4.3.1.	Vizat, kontrolli kufitar, azili dhe migrimi.....
4.3.2.	Pastrimi i parave .....
4.3.3.	Drogat.....
4.3.4.	Policia.....
4.3.5.	Lufta kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit.....
4.3.6.	Mbrojtja e të dhënave personale.....
	Shtojcë statistikore.....

# DOKUMENTI I PUNËS I STAFIT TË KOMISIONIT

## Shqipëria - Progres Raporti 2007

### 1. HYRJE

#### 1.1. Parathënie

Që në mars 2002, Komisioni i ka raportuar rregullisht Këshillit dhe Parlamentit për progresin e bërë nga vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Ky raport progresi ndjek thujtë të njëjtën strukturë si vitet e kaluara. Raporti:

- përshkruan shkurtimisht marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së;
- analizon gjendjen në Shqipëri për sa i përket kritereve politike për anëtarësim;
- analizon gjendjen në Shqipëri mbi bazën e kritereve ekonomike për anëtarësim;
- shqyrton kapacitetet e Shqipërisë për zbatimin e standardeve evropiane, domethënë, përafrimin gradual të legjislacionit dhe politikave të saj me ato të *acquis*, në përputhje me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit dhe prioritetet e Partneritetit Evropian.

Ky raport mbulon periudhën nga 1 tetori 2006 deri në fillim të tetorit 2007. Progresi matet mbi bazën e vendimeve të marra, ligjeve të miratuara dhe masave të zbatuara. Si rregull, ligjet apo masat që janë në fazat e përgatitjes ose që presin miratimin e parlamentit, nuk merren parasysh. Kjo qasje garanton trajtim të barabartë midis të gjitha raporteve dhe mundëson vlerësim objektiv.

Raporti bazohet në informacionet e mbledhura dhe të analizuar nga Komisioni. Përveç këtyre, janë përdorur shumë burime, përfshi kontributet e qeverisë së Shqipërisë, e Shteteve Anëtare, raporteve<sup>1</sup> të Parlamentit Evropian, dhe informacionet nga organizata të ndryshme ndërkombëtare dhe jo-qeveritare.

Komisioni nxjerr përfundime të hollësishme duke e konsideruar Shqipërinë bazuar vetëm nga komunikimi i saj mbi zgjerimin<sup>2</sup>, bazuar në analizën teknike që përmban ky raport.

#### 1.2 Konteksti

Shqipëria është kandidatë potenciale për anëtarësim në BE.

**Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA)** ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së u nënshkrua në qershor 2006. Një Marrëveshje e Përkohshme është në fuqi që në dhjetor 2006.

---

<sup>1</sup> Për Shqipërinë, raportues është z. Libor Rouček.

<sup>2</sup> Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2007-2008.

### 1.3. Marrëdhëniet ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë

Shqipëria aktualisht merr pjesë në **Procesin e Stabilizim-Asociimit**.

Shqipëria nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA) me BE-në në qershor 2006. MSA shtron një kuadër angazhimesh të ndërsjella për një rang të gjerë çështjesh politike, tregtare dhe ekonomike. Çështjet e MSA-së që lidhen me tregtinë po vihen në zbatim nëpërmjet një Marrëveshjeje të Përkohshme derisa të përfundojë ratifikimi i plotë i MSA-së. Marrëveshja e Përkohshme hyri në fuqi në dhjetor 2006. Dispozitat e bashkëpunimit të Marrëveshjes për Tregtinë dhe Bashkëpunimin Ekonomik dhe Tregtar (TCECA) vazhdojnë të kenë efekt deri në ratifikimin e MSA-së. Shqipëria gjithashtu përfiton nga masat tregtare autonome të dhëna nga BE.

BE udhëzon autoritetet shqiptare mbi prioritetet e reformave nëpërmjet **Partneritetit Evropian**. Progresi në këto reforma kryesore inkurajohet dhe monitorohet përmes dialogut politik dhe ekonomik me Shqipërinë. Dialogu zhvillohet nëpërmjet Trojkës Ministrore, takimeve të komitetit të përbashkët dhe task-forcës konsultative (CTF) në nivel ministror dhe takimet e grupit të punës në nivel zv/ministrash.

Takimi i Trojkës Ministrore me Shqipërinë në qershor 2007 u fokusua në prioritetet kyçe politike, përfshi çështjet rajonale. Komiteti i përvitshëm i përbashkët u takua në dhjetor 2006 për të vëzhguar funksionimin e duhur të Marrëveshjes së Përkohshme dhe TCECA-s. Dy takime CTF (Grupi i Përbashkët Konsultativ) dhe pesë takime të grupit të punës u zhvilluan nga periudha tetor 2006 deri në tetor 2007. Takimet CTF u fokusuan në kriteret politike të pranimit dhe çështjet e shtetit të së drejtës. Çdo takim CTF u mbyll me një sërë rekomandimesh për veprim - të pranuar bashkërisht - për autoritetet shqiptare. Takimet e grupit të punës u fokusuan në çështje ekonomike, sektoriale dhe të tregut të brendshëm, dhe i raportuan komitetit të përbashkët.

Në shtator 2007, BE dhe Shqipëria nënshkruan një marrëveshje për **lehtësimin e vizave**. Rregullimet e reja janë të rëndësishme për të lehtësuar kontaktet mes njerëzve, dhe thjeshtojnë procedurat e dhënies së vizave për disa kategori të caktuara qytetarësh të Shqipërisë ku përfshihen studentët, akademikët, biznesmenët, gazetarët dhe turistët. Gjithashtu kostot për një vizë do ta mbahen në nivelin e tanishëm, dhe në disa raste, çon në dhënie falas të vizave. Kjo marrëveshje plotëson marrëveshjen e ripranimit KE-Shqipëri e cila hyri në fuqi në maj 2006. Ky hap shton ndërveprimin ndërmjet qytetarëve të Shteteve Anëtare të BE-së dhe atyre të Shqipërisë.

Që në janar, **asistenca financiare** e para-aderimit për Shqipërinë jepet në kuadrin e Instrumentit për Asistencën e Para-zgjerimit (IPA). Për vitin 2007, KE akordoi një total prej 61 milion EUR. Dokumenti i Planifikimit Tregues Shumëvjeçar <sup>3</sup>(MIPD) 2007-2009 për Shqipërinë në kuadrin e IPA-s, u miratua në maj 2007. Fushat kryesore që mbulon janë drejtësia dhe çështjet e brendshme, forcimi i kapaciteteve administrative, zhvillimi ekonomik e social, dhe stabiliteti demokratik. Asistenca e vazhdueshme nën CARDS dhe IPA vihet në zbatim nga Delegacioni i Komisionit Evropian në Tiranë. Menaxhimi i ndihmës me bazë të decentralizuar është një objektiv afatmesëm për Shqipërinë.

Për sa i takon dialogut të **shoqërisë civile**, 4 milion EUR janë akorduar për projekte që rrisin rolin e shoqërisë civile dhe medias në procesin e integritit evropian. Shqipëria ka përfituar mbështetje nga

---

<sup>3</sup>Multi-Annual Indicative Planning Document (MIPD)

shtetet anëtare të BE-së nëpërmjet Qendrës Monitoruese dhe Informuese të BE-së për Mbrojtjen Civile (MIC)<sup>4</sup> për ta ndihmuar në përballimin e zjarreve në pyje gjatë verës.

Në maj 2005, hyri në fuqi një Marrëveshje Kuadër ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë për pjesëmarrjen në **programet Komunitare**.

## **2. KRITERET POLITIKE**

Ky seksion ekzaminon progresin e Shqipërisë në përmbushjen e kriterëve politike të Kopenhagenit të cilat kërkojnë stabilitet të institucioneve garantuese të demokracisë, shtetit të së drejtës, të drejtave të njeriut si dhe respektimin dhe mbrojtjen e minoriteteve. Gjithashtu monitoron bashkëpunimin rajonal, marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë me vendet aspiruese dhe Shtetet Anëtare, si dhe respektimin e detyrimeve ndërkombëtare.

### **2.1. Demokracia dhe shteti i së drejtës**

Ky seksion ekzaminon progresin e Shqipërisë në përmbushjen e kriterëve politike të Kopenhagenit të cilat kërkojnë stabilitet të institucioneve garantuese të demokracisë, shtetit të së drejtës, të drejtave të njeriut si dhe respektimin dhe mbrojtjen e minoriteteve. Gjithashtu monitoron bashkëpunimin rajonal, marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë dhe respektimin e detyrimeve ndërkombëtare.

#### *Parlamenti*

Parlamenti vazhdoi të përmbushë rolin e vet si pikë fokusi për shkëmbimin politik. Presidenti i ri i Shqipërisë u zgjodh me votë parlamentare në korrik. Procesi i zgjedhjes u zhvillua në përputhje me kushtetutën. Presidenti i ri u zgjodh me shumicën e kërkuar prej 3/5 të votave në raundin e katërt. Përfundimi me sukses i zgjedhjes së presidentit i lejoi parlamentit të vazhdojë punën e vet dhe të mos ndërpritet nga zgjedhje parlamentare të parakohshme. Është ngritur një komitet parlamentar *ad hoc* për reformën zgjedhore. Sistemi aktual për përditësimin e listave të votuesve u përdor me eficiencë në përgatitjet për zgjedhjet vendore. Debatit për ligjin e buxhetit 2007 u zhvillua normalisht, si në 2006.

Megjithatë, progresi ka qenë i pakët në arritjen e konsensusit konstruktiv ndërmjet partive politike për zbatimin e reformave të nevojshme për ecurinë e Procesit të Stabilizim-Asociimit. Puna e parlamentit shpesh është dominuar nga një agjendë politike afatshkurtër e cila ka polarizuar debatin. Vendimet parlamentare shpesh janë vonuar për shkak të debateve të përqendruara në interesa të ngushta partiake ose për shkak nxitimi pa përgatitje apo diskutime të mjaftueshme. Kjo i ka ngadalësuar reformat, veçanërisht reformën zgjedhore dhe atë në drejtësi.

Komisioni Parlamentar për Integrimin Evropian nuk është takuar rregullisht dhe nuk ka kryer shqyrtim të rregullt të çështjeve që lidhen me MSA-në. Monitorimi i zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga MSA bëhet ekskluzivisht nga qeveria. Performanca e komisioneve të tjera parlamentare nuk ka qenë e njëjlojtë. Përbërja e komisioneve parlamentare në disa raste është ndryshuar për arsye politike. Diskutimet e komisioneve ende nuk po transkriptohen. Niveli i ekspertizës disponibël për parlamentin, përfshi çështjet e integritit në BE, mbetet i ulët. Kjo pasqyrohet në cilësinë e ligjeve. Komisioni për Reformën Ligjore nuk kryen konsultime të gjera të mjaftueshme që do të siguronte ekspertizën e nevojshme në hartimin e ligjeve. Besueshmëria e pajisjeve elektronike të votimit, ka vazhduar të shkaktojë debate.

---

<sup>4</sup> EU Monitoring and Information Centre for Civil Protection

Menaxhimi i buxhetit vazhdon të jetë me mangësi dhe i mbingopur me shpenzime jothelbësore, siç është transporti i deputetëve.

Mosmarrëveshjet politike vonuan zgjedhjet vendore të 2007-ës dhe çuan në mjaft mangësi teknike. Zyra e OSBE-së për institucionet demokratike dhe të drejtat e njeriut (ODIHR) si dhe misioni vëzhgues i Këshillit të Evropës, raportuan se zgjedhjet ishin konkurrese, por ishin një mundësi e humbur për mbajtjen e zgjedhjeve në përputhje të plotë me angazhimet dhe standardet ndërkombëtare. Debatet e vazhdueshme partiake çuan në bojkotimin nga opozita të zgjedhjeve të pjesshme parlamentare. Nuk është shënuar progres në zbatimin e rekomandimeve të OSBE/ODIHR apo këshillave të Komisionit të Venecias për reformën zgjedhore. Reforma e duhur e kuadrit zgjedhor, në kohë të mjaftueshme në avancë të zgjedhjeve parlamentare të ardhshme, kërkon pjesëmarrjen konstruktive të partive politike në komisionin e reformës zgjedhore.

Përgjithësisht, parlamenti ishte pikë fokusi për debatin politik dhe përmbushi rolin kushtetues në zgjedhjen e presidentit të ri. Sidoqoftë, mungesa e vullnetit për bashkëpunim të partive politike vazhdoi të ngadalësojë reformat e nevojshme për realizimin e detyrimeve të MSA-së.

### *Qeveria*

Ministria e Integritit u ristrukturua për t'u bërë më efikase në monitorimin e zbatimit të MSA-së. Të gjitha postet tashmë janë të mbushura. Procesi i zhvillimit të strategjive sektoriale në kuadrin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integritim ka qenë transparent dhe i hapur. Ministria e Integritit e përmirësoi bashkërendimin me Departamentin e Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj. Kjo do të garantojë reflektimin e plotë të objektivave të integritit evropian në Strategjinë për Zhvillim dhe Integritim. Njësi integriti evropian janë ngritur në të gjitha ministritë e linjës për të vepruar si pika kontakti për asistencën e BE-së, për raportimin dhe monitorimin.

Regjistri i gjendjes civile dhe sistemi kombëtar i adresave po forcohen. Paralelisht, kartat elektronike të identitetit dhe pasaportat biometrike janë në proces zhvillimi. Kjo do të ndihmojë në përmirësimin e të dhënave për vendimet e qeverisë, listat e votuesve, identifikimin e votuesve, si dhe kontrollin kufitar. Megjithatë, përmirësimi i regjistrit të gjendjes civile dhe i sistemit të adresave ende nuk është i bashkërenduar mjaftueshëm me zhvillimin e kartave të identitetit dhe pasaportat biometrike. Kjo përbën rrezik për suksesin e secilës prej këtyre iniciativave.

Kapacitetet institucionale të Ministrisë së Integritit pengohen nga lëvizjet e stafit të nivelit të lartë, plotësimi me vonesë i posteve të larta, dhe mungesa e stafit për përafrimin e legjislativës dhe menaxhimit të fushave specifike të asistencës Komunitare. Organizimi dhe stafi i Njësive të Integritit Evropian nuk është gjithmonë konsistent me rolin e ministrive të tyre të planifikuara në zbatimin e MSA-së. Progres i mëtejshëm kërkohet në bashkërendimin brenda qeverisë për punën e integritit evropian. Në veçanti, konsultimi më i gjerë dhe më konsistent me ministritë, sidomos me Ministrinë e Integritit, grupet e interesit dhe ekspertët e BE-së, do të përmirësonte cilësinë e propozimeve legislative.

Mjaft strategjive sektoriale nën Strategjinë për Zhvillimin dhe Integritimin u mungojnë treguesit e qartë të kostove dhe performancës, të cilat janë të nevojshme që strategjitë të përdoren me efikasitet si bazë për kuadrin afatmesëm buxhetor nëpërmjet Sistemit të Integruar të Planifikimit. Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj nuk i ka plotësuar të gjitha postet e veta, pavarësisht rrogave më të larta krahasuar me departamentet e tjera qeveritare.

Shqipëria ka marrë disa masa ligjore dhe institucionale për transferimin e përgjegjësive për TVSH, taksat vendore, ujësjellës-kanalizimet, nga qeveria qendrore te bashkitë. Sidoqoftë, progres i paktë është arritur në zbatimin e rekomandimeve të 2006-ës Këshillit të Evropës për përcaktimin e territorit gjeografik dhe kompetencat e autoriteteve rajonale. Akordimi i burimeve financiare dhe detyrave ndërmjet qeverisë qendrore dhe vendore, si dhe ndërmjet bashkive, vazhdon të jetë i pabalancuar. Një kuadër ligjor më i fortë për huadhëniet vendore do të lehtësonte investimet kapitale të nevojshme për shërbime më të mira vendore.

Përgjithësisht, Shqipëria ka bërë disa përparime në forcimin e strukturave të veta qeveritare për adresimin e angazhimeve kundrejt BE-së dhe agjendës së zhvillimit. Është i nevojshëm forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve, bashkërendimit dhe planifikimit strategjik.

#### *Administrata publike*

Ministritë i kanë kushtuar përparësi më të madhe politikave dhe strategjive. Ekspertiza dhe kujtesa institucionale po stabilizohen. Janë shkrirë disa institucione dhe agjenci të varura, çka rezulton në reduktimin e 16% të vendeve të punës të nëpunësve civilë dhe 33% të posteve administrative dhe mbështetëse. Pagat e sektorit publik janë rritur nga 5% deri në 70% në varësi të kategorisë. Qeveria e ka ndryshuar procesin e rekrutimit për të tërhequr në shërbimin civil studentët shqiptarë të diplomuar në universitetet e huaja. Plani i trajnimit për nëpunësit civilë është rishikuar në mënyrë që të përmirësohet duke pasqyruar nevojat reale. Ligji i ri për organizimin e policisë transferon përgjegjësinë për burimet njerëzore, materiale dhe financiare nga Ministria e brendshme te vetë policia. Ligji i ri është në linjë me standardet e BE-së dhe pritet të ndihmojë në depolitizimin e policisë.

Megjithatë, për përmirësimin cilësisë së personelit dhe organizimit të politikë-bërjes nëpër ministri, nevojiten ndryshime horizontale të mëtejshme. Autoriteti i Departamentit të Administratës Publike për vendosjen e strategjive të përbashkëta menaxhuese në tërë administratën publike, në praktikë, është i kufizuar. Si rezultat, shpesh ajo nuk konsultohet në rastin e krijimit të agjencive apo institucioneve të reja. Shërbimi civil shpesh nuk arrin të përfshihet në praktikë në strukturën zyrtare të karrierës dhe në kuadrin e klasifikimit të vendit të punës. Përdorimi i administrimit të performancës mbetet në faza fillestare. Kjo pengon thithjen dhe mbajtjen e stafit kompetent dhe të motivuar. Ndryshimet në staf kanë rezultuar në disa raste në lënien bosh të posteve të shërbimit civil për disa muaj rresht. Shkurtime në staf kanë bërë që disa ministri të kenë mangësi burimesh. Emërimet politike në postet e larta dhe të nivelit të mesëm vazhdojnë, shpesh pa i kushtuar vëmendjen e duhur Ligjit për Shërbimin Civil. Aktet administrative vazhdojnë të firmosen nga zëvendësues të përkohshëm të cilët ende nuk janë emëruar zyrtarisht. Sistemi i kompjuterizuar i menaxhimit të listë-pagave ka nevojë për investim të mëtejshëm. Përpjekje të mëdha kërkohen si në nivelet qeveritare edhe në ato nënkombëtare, për krijimin e një shërbimi civil llogaridhënës dhe eficient, bazuar në kriterin e karrierës profesionale. Në veçanti, rekrutimi dhe ngritja në detyrë kanë nevojë të rregullohen me kritere objektivash dhe meritash, si dhe duhet të ndiqet një dallim i qartë ndërmjet niveleve politike dhe administrative.

Përgjithësisht, administrata publike po stabilizohet dhe po bëhet disi më e fokusuar. Kërkohet progres i mëtejshëm në forcimin e Departamentit të Administratës Publike dhe garantimin e stafeve kompetente, të motivuara dhe të paanshme.

#### *Sistemi gjyqësor*

Procedurat gjyqësore përgjithësisht vazhdojnë të jenë të ngadalta dhe u mungon transparenca. Masat e qeverisë për të luftuar korrupsionin në gjyqësor çuan në konflikt të vazhdueshëm ndërmjet ekzekutivit dhe gjyqësorit, veçanërisht me Prokurorin e Përgjithshëm.

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë kontribuar në zhvillimin e jurisprudencës për decentralizimin, rolin e komisioneve hetimore parlamentare, rolin e ekzekutivit në lidhje me organet e pavarura shtetërore dhe standardet për nxjerrjen e dekreteve qeveritare.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë po vë në zbatim një sistem të ri për vlerësimin profesional të gjykatave më të ulëta paraprakisht ligjit të planifikuar për reformimin e thellë të gjyqësorit. Aftësia e gjykatave për të administruar buxhetin gjyqësor është përmirësuar ndjeshëm përmes trajnimit. Me anë të një dekreti u pakësua numri i gjykatave të rrethit, nga 29 në 21, që pritet të rrisë eficiencën. Një godinë e re për gjykatën e Krimeve të Rënda po ndërtohet në Tiranë. Sistemi i menaxhimit të çështjeve civile është shtrirë në të gjitha gjykatat e rretheve dhe të apelit në Shqipëri.

Disa përmirësime janë bërë në kapacitetet e shërbimit përmbarimor. Numri i vendimeve gjyqësore në pritje të ekzekutimit, kur përfshijnë institucione shtetërore, është zvogëluar. Shkolla e Magjistraturës vazhdoi të sigurojë trajnim në të drejtat e njeriut, çështjet tregtare dhe çështje të tjera që lidhen me MSA-në.

Sidoqoftë, një projekt ligj për reformimin thelbësor të gjyqësorit vazhdon të jetë nën diskutim në komisionin parlamentar. Ky projekt ligj garanton që në gjykatat administrative të ketë caktim transparent të çështjeve dhe përmirësim të strukturës së karrierës për gjyqtarët dhe të procedurave disiplinore. Ai kufizon rekrutimin e gjyqtarëve vetëm nga Shkolla e Magjistraturës. Ligji i planifikuar për përmirësimin e kushteve të punës të administratorëve gjyqësore (që nuk janë nëpunës civilë) po vonohet.

Ligje të mëtejshme nevojiten për forcimin e pavarësisë, mbrojtjes kushtetuese dhe llogaridhënies së gjyqtarëve. Kompetencat përkatëse të inspektorateve gjyqësore të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe të Ministrisë së Drejtësisë duhet të përcaktohen qartë. Gjyqtarët dhe prokurorët ende nuk po emërohen përmes provimeve konkurruese. Një sistem transparent bazuar në merita për vlerësimin e prokurorëve, ende nuk është vënë në zbatim. Shumë gjykata ende nuk kanë filluar të përdorin sistemin e menaxhimit të çështjeve civile. Transparenca gjyqësore nuk është rritur. Shumë urgjente është vendosja e mekanizmave më të mirë për të mundësuar ekzaminimin e hapur të vendimeve gjyqësore. Bashkërendimi ndërmjet prokurorëve dhe policisë duhet të përmirësohet.

Infrastruktura gjyqësore vazhdon të jetë e dobët, veçanërisht në gjykatën e rrethit Tiranë dhe gjykatën e Apelit, më e madhja në vend. Gjykatat vazhdojnë të mos kenë hapësirën e nevojshme për salla gjyqi, arkiva dhe pajisje. Mungesa e hapësirës për zyra dhe pajisje për përmbarimin, si dhe asistencë e pamjaftueshme nga autoritetet e tjera, siç është policia dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, pengon ekzekutimin e vendimeve, që mbetet i ngadaltë. Ekzekutimi i vendimeve të gjykatave në rastet kur përfshijnë institucionet shtetërore shpesh zgjat përtej afatit ligjor prej 6 muajsh. Planet për të reformuar sistemin përmbarimor, ende nuk kanë çuar në hartimin e ligjeve të reja.

Për ta bërë të qëndrueshme Shkollën e Magjistraturës në planin afatmesëm, nevojitet financim i vazhdueshëm kombëtar. Ende nuk është vendosur një sistem kontrolli cilësie për shumë shkolla private jurisprudence (juridiku). Planet për reformimin e legjislationit për profesionet e noterit dhe avokatit, janë akoma në faza fillestare.



Struktura e re për policinë parashikon një drejtori të veçantë për mbrojtjen e dëshmitarëve. Trajnimet kanë forcuar aftësitë e stafit që merret me mbrojtjen e dëshmitarëve. Pajisjet e video-konferencës janë instaluar në Gjykatën e Krimeve të Rënda dhe në prokurori. Megjithatë, nevojiten amendime në ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve para se të hartohen udhëzime operative. Nuk ka nisur akoma ngritja e drejtorisë së re policore për mbrojtjen e dëshmitarëve. Njësia e Gjykatës së Krimeve të Rënda për Mbrojtjen e Dëshmitarëve vazhdon të ketë burime financiare të pamjaftueshme. Kjo kufizon ndjeshëm numrin e personave që mund të mbrohen. Mungesa e mbrojtjes së konsoliduar të dëshmitarëve mbetet një pengesë e madhe për suksesin në luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikimit të qenieve njerëzore.

Përgjithësisht, janë marrë disa hapa për përmirësimin e eficiencës së gjyqësorit. Megjithatë, ka vazhduar të funksionojë dobët për shkak të mangësive në pavarësi, transparencë dhe eficiencë. Legjislacioni i planifikuar për adresimin e këtyre problemeve është vonuar.

### *Politikat anti-korrupsion*

Korrupsioni është i përhapur dhe përbën një problem shumë serioz në Shqipëri. Qeveria ka hartuar një strategji të re anti-korrupsioni për 2007-2013. Një strategji që shtrihet në periudhë të gjatë tregon një ndryshim pozitiv në qasje, nga zgjidhjet afatshkurtra, në masa më efikase dhe të qëndrueshme. Shqipëria ka bërë mjaft progres në zbatimin e rekomandimeve të GRECO-s 2002 (Grupi i Shteteve të Këshillit të Europës kundër Korrupsionit). Kjo përfshin, në veçanti, miratimin e legjislacionit të ri për prokurimin publik, masat për forcimin e pavarësisë dhe transparencës së Agjencisë së Prokurimit Publik si dhe emërimin e Avokatit të prokurimit publik.

Nëpërmjet Nismës Anti-korrupsion të Paktit të Stabilitetit<sup>5</sup> (SPAI), Shqipëria organizoi një konferencë rajonale për zbatimin e Konventës së OKB-së kundër Korrupsionit. Qeveria miratoi në legjislacionin e brendshëm këtë konventë, si edhe dispozitat për korrupsionin të Konventës së OKB-së kundër Krimit të Organizuar Tejkombëtar (Konventa e Palermos), si edhe mori masa për rritjen e sensibilizimit për standardet përkatëse. Shqipëria e ka vënë Kodin Penal në linjë me Konventën e Këshillit të Evropës për Ligjin Penal për Korrupsionin. Është miratuar legjislacion specifik për ryshfetin.

Janë fuqizuar kapacitetet institucionale për hetimin dhe procedimin e korrupsionit, me ngritjen e një task-force të re në prokurori kundër korrupsionit dhe krimit ekonomik, e cila bashkërendohet me policinë dhe strukturat e shërbimit sekret. Në këtë riorganizim të fundit të policisë, strukturat që merren me krimin ekonomik dhe financiar u ngritën në nivel drejtorie, si dhe u krijua edhe një seksion antikorrupsion. Hetimet anti-korrupsion çuan në arrestimin e një numri zyrtarësh të lartë. Prokurorët, policia gjyqësore dhe gjyqtarët janë trajnuar mbi legjislacionin anti-korrupsion. Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Auditimin e Pasurisë shënoi progres në imponimin e detyrimeve për deklarim pasurie. Nga 3 500 persona që me ligj janë të detyruar të deklarojnë pasuritë e tyre, vetëm 87 nuk e kanë bërë këtë gjë.

Megjithatë, masat për forcimin e gjyqësorit kundër korrupsionit, janë të vonuara. Strategjia anti-korrupsion e qeverisë nuk përmban mjaftueshëm objektiva dhe tregues konkretë. Progres i mëtejshëm kërkohet në zbatimin e setit të dytë të rekomandimeve të GRECO-s të vitit 2005. Shqipëria ende nuk e ka harmonizuar plotësisht Kodin Civil, Tregtar dhe Administrativ me Konventën e Ligjit Civil të Evropës për Korrupsionin. Ligji për konfliktin e interesit ka nevojë të sqarohet më tej.

---

<sup>5</sup> Stability Pact Anticorruption Initiative (SPAI)

Propozimi për ndryshim në rregulloren e parlamentit për të lejuar heqjen e imunitetit të deputetëve në bazë rast pas rasti, ende nuk është miratuar. Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Auditimit të Pasurive i mungojnë mekanizmat për të hetuar deklarimet. Nuk ekziston legjislacion që të imponojë zbatimin e detyrimit kushtetues për partitë politike që të bëjnë publike burimet e tyre të financimit. Nuk ka pasur ndryshim në përqindjen e procedurave disiplinore kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve të korruptuar. Nevojiten përmirësime në kuadrin ligjor për aksesin e lirë në informacionin publik.

Përgjithësisht, Shqipëria ka vazhduar të adresojë korrupsionin, një prioritet kyç i Partneritetit Evropian. Qeveria po ndërmerr një qasje më strategjike, por korrupsioni mbetet i përhapur dhe përbën një problem shumë serioz. Shumë punë kërkohet akoma në të gjitha aspektet e këtij problemi, përfshi llogaridhënien dhe transparencën juridike të financimeve të partive politike.

## **2.2. Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve**

### *Respektimi e të drejtës ndërkombëtare ose të drejtat e njeriut*

Për sa i përket **ratifikimit të instrumenteve të të drejtave të njeriut**, Shqipëria ka ratifikuar Protokollin 13 të Konventës Evropiane për Të Drejtat e Njeriut në lidhje me heqjen e dënimit me vdekje në të gjitha rrethanat, dhe ka ndërhyrë në Kodin Ushtarak për ta reflektuar këtë. Shqipëria është rreshtuar krahnismës së Italisë dhe Bashkimit Evropian në Kombet e Bashkuara për heqjen e dënimit me vdekje.

**Gjykata Evropiane e Të Drejtave Të Njeriut** dha një vendim pasi konstatoi se Shqipëria kishte shkelur këto të drejta. 18 çështje u gjykuan të papranueshme. Një total prej 73 aplikimesh të reja në lidhje me Shqipërinë iu paraqitën kësaj Gjykate gjatë periudhës raportuese. 143 është numri total i çështjeve në lidhje me Shqipërinë që janë në pritje të vendimit. Parlamenti dhe Komisioni i Reformës Ligjore po ekzaminon amendimet për Kodin e Procedurës Civile dhe atë Penal për t'i dhënë sistematikisht status ligjor vendës vendimeve gjyqësore të Gjykatës Evropiane të Të Drejtave të Njeriut, por miratimi i tyre po vonohet.

Për sa i përket **promovimit dhe zbatimit të Të Drejtave të Njeriut**, ato garantohen nga ligji shqiptar dhe qeveria përgjithësisht i respekton. Sidoqoftë, mangësi shfaqen akoma në zbatimin e të drejtave të njeriut në fusha si parandalimi i torturës dhe keqtrajtimit, të drejtat e të ndaluarve dhe e drejta për gjyq të paanshëm. Më poshtë jepen detajet e pikave të dobëta në fusha specifike.

### *Të drejtat civile dhe politike*

Për sa i përket **parandalimit të torturës dhe keqtrajtimit dhe luftës kundër mosndëshkimit**, përkufizimi i torturës në Kodin Penal u ndryshua dhe u soll në përputhje me Nenin 1 të Konventës së OKB-së kundër Torturës. Prokurori i Përgjithshëm u shpërndau udhëzime zyrtare prokurorëve dhe policisë gjyqësore ku nënvizohet nevoja e respektimit të të drejtave të njeriut në procedimet penale. Progres është arritur në zbatimin e rekomandimeve të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës (CPT). Veçanërisht, transferimi i përgjegjësive për qendrat e paraburgimit nga Ministria e Brendshme te Ministria e Drejtësisë, tashmë është përfunduar thuajse plotësisht. Një task-forcë ndërministrorë e drejtuar nga Ministria e Çështjeve të Jashtme u ngrit për të monitoruar zbatimin e rekomandimeve të CPT-së. Aktivitete sensibilizuese janë organizuar për gazetarët dhe publikun.

Megjithatë, akuzat për keqtrajtimit të të dyshuarve nga ana e policisë gjatë arrestimit apo marrjes në pyetje, akoma janë të shpeshta. Përparim i pakët është arritur në aplikimin e mbrojtjeve themelore kundër

keqtrajtimin gjatë parandalimit, si për shembull aksesin për një avokat dhe mjek si dhe njoftimi i të afërmeve të të dyshuarit. Procedimet për keqtrajtim jo gjithmonë e referojnë këtë shkelje si serioze. Legjislacioni që parashikon kritere për kompensimin e viktimave ende nuk është miratuar. Amendimet në ligjin për të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve po vonohen. Kodi i Etikës për sistemin e burgjeve jo gjithmonë ndiqet. Nevojitet trajnim i stafit të burgjeve mbi Konventën Evropiane të Të Drejtave të Njeriut. Komiteti Mbikëqyrës për Ekzekutimin e Dënimeve me Burgosje që synon të këshillojë Ministrinë e Drejtësisë për çështjet e ekzekutimit dhe mbrojtjes së të drejtave të të burgosurve dhe të paraburgosurve ende nuk është funksional. Vazhdojnë të shfaqen rastet e arrestimit arbitrar dhe keqtrajtimin të homoseksualëve nga ana e policisë.

Përgjithësisht, disa hapa janë marrë për parandalimin e torturës dhe keqtrajtimin të të paraburgosurve, por kërkohet respektim më i mirë i të drejtave të njeriut dhe procedim i duhur i abuzuesve.

Për sa i përket **aksesit në drejtësi**, legjislacioni shqiptar garanton mbrojtje ligjore falas për të pandehurit të cilët nuk e përballojnë financiarisht një avokat privat. Megjithatë, sistemi ekzistues është i fragmentarizuar dhe i mungon një mekanizëm praktik monitorimi. Rrjedhimisht, jo gjithmonë garanton këshillim të përshtatshëm apo në kohë reale. Mbrojtja ligjore falas nuk njihet në Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Kërkohet përmirësim i legjislacionit.

Përsa i përket **sistemit të burgjeve**, shumica e qendrave policore të paraburgimit janë mbyllur dhe të paraburgosurit janë transferuar në seksione të reja paraburgimi në mjediset e burgjeve, me kushte më të mira fizike dhe disa mundësi për rehabilitim social. Janë në ndërtim dy burgje të reja: një qendër paraburgimi dhe një spital psikiatrik mjekoligjor. Projekti i këtyre dy ndërtesave është në përputhje me standardet ndërkombëtare. Shumë burgje janë rinovuar duke u përmirësuar kushtet për të burgosurit. Janë përmirësuar standardet e ushqimit për të burgosurit. Është ngritur një program ndërmjetësimi për shkelësit e ligjit dhe viktimat.

Progresi në ndërtimin e qendrave të reja të paraburgimit para gjyqit është i ngadaltë. Është e rëndësishme që administrimi i mjediseve të reja të paraburgimit të jetë në përputhje me konventat ndërkombëtare. Praktika ndërkombëtare kërkon që rregullat e paraburgimit në pritje të gjyqimit, të shndërrohen në ligj. Rrallë përdoren alternativat e burgosjes në dhënien e dënimit. Progresi për një ligj të ri të planifikuar për ndëshkimin alternativ, po vonohet. Shërbimi garantues i lirimimit me kusht, nuk është ende operativ. Kjo është e rëndësishme në mënyrë që dënimet alternative të jenë të efektshme, gjë që do të ulte numrin në rritje të të burgosurve. Burimet njerëzore dhe materiale të nevojshme për sistemin e burgjeve mbeten të pamjaftueshme. Të gjitha burgjet dhe qendrat e paraburgimit para gjyqit janë të mbipopulluara. Ende mungon një sistem efektiv monitorimi dhe inspektimi për burgjet. Progresi në përmirësimin e aktiviteteve rehabilituese, si arsimimi, programe pune dhe sociale për të burgosurit, ka qenë i kufizuar.

Përgjithësisht, përparime janë bërë në përmirësimin e sistemit të burgjeve dhe të paraburgimit para gjyqit, por standardet e burgimit mbeten të dobëta, për shkak të mungesës së burimeve.

**Liria e shprehjes** dhe e shtypit garantohet me kushtetutë në Shqipëri, por shumë operatorë mediash vazhdojnë të mbeten objekt i interesave politike apo ekonomike.

Është vënë në zbatim vendimi i 2006-ës për të zgjeruar përbërjen e Këshillit Kombëtar të Radio-Televizionit (KKRT) si dhe të Këshillit Drejtues të Radio-Televizionit Shqiptar duke përfshirë ekspertë të propozuar nga opozita parlamentare. KKRT-ja nënshkroi një Memorandum Mirëkuptimi me Autoritetin e Konkurrencës për bashkëpunim në zhvillimin e konkurrencës së lirë në fushën e medias elektronike.

Shqipëria ra dakord për një plan veprimi për zhvillimin e legjislacionit të ri të transmetimeve. Plani parashin konsultime me grupet e interesit dhe komunitetin ndërkombëtar. Kodi i punës u amendua për të përmirësuar statusin e gazetarëve.

Qeveria fillimisht propozoi një projekt ligj mbi transmetimet numerike, pa zhvilluar konsultimet e rena dakord, si një masë urgjente kundër piraterisë. Konsultimet e mëtejshme çuan në një ligj të ri, i cili merr gjerësisht në konsideratë këshillat e Komisionit Evropian dhe Këshillit të Evropës.

Megjithatë, garancitë aktuale ligjore për lirinë e shprehjes ende nuk zbatohen plotësisht, veçanërisht në lidhje me median e shkruar dhe respektimin e pavarësisë së gazetarëve nga pronarët e mediave. Legjislacioni i propozuar nga qeveria për heqjen e masës së ndalimit për shpifje nuk është miratuar ende. Puna për përmirësimin e legjislacionit në fusha si transparencja e pronësisë së medias, shpifja dhe statusi i gazetarit, nuk është i koordinuar ende në mënyrë eficiente. Është e nevojshme që të vazhdohet dhe intensifikohet puna mbi një legjislacion të ri gjithëpërfshirës për transmetimet, duke u bazuar në procesin e rënë dakord me Komisionin dhe Këshillin e Evropës. Vendimet e qeverisë për licencimin e operatorëve transmetues si dhe zbatimi i taksave në sektorin e medias, kanë çuar në akuza për njëanshmëri.

Për të rritur lirinë e medias, si autoritetet shqiptare ashtu edhe kompanitë mediatike, duhet të veprojnë me transparencë dhe brenda ligjit.

KKRT-ja duhet të zbatojë ligjin e ri të transmetimeve numerike në përputhje me praktikën e BE-së. Këshilli i planifikuar për Etikën në Media ende nuk ka filluar nga puna. Nevojitet një debat më i gjerë mbi çështjet e etikës dhe trajnim më i mirë i gazetarëve të rinj. Shoqatat e gazetarëve mbeten të dobëta.

Përgjithësisht, Shqipëria ka bërë disa përparime në lirinë e shprehjes, një prioritet kyç ky i Partneritetit Evropian. Tashmë nevojitet përmirësimi i zbatimit të legjislacionit ekzistues si dhe i reformës në këtë fushë, në mënyrë më të bashkërenduar dhe në konsultim me grupet e interesit dhe ekspertët.

Nuk janë raportuar kufizime në **lirinë e tubimit dhe e organizimit**.

Kuadri ligjor për **organizatat e shoqërisë civile** mbetet i hapur dhe jokufizues. Aktorët e shoqërisë civile janë përfshirë në mënyrë aktive në diskutimet rreth ligjeve të reja të rëndësishme, si ligji për Policinë e Shtetit dhe ligji për arsimin e lartë. Megjithatë, grupet e shoqërisë civile vuajnë ende mungesën e burimeve të qëndrueshme, të kapaciteteve organizative dhe aftësive avokatuese. Shqipëria do të përfitonte nga përfshirja më e gjerë e qytetarëve në qeverisje, me anë të grupeve të shoqërisë civile. Kjo kërkon kanale dialogu më efektive dhe transparencë më të madhe, veçanërisht në lidhje me informacionin mbi financat publike. Grupet e shoqërisë civile do të përfitonin nga krijimi i lidhjeve më të ngushta me shoqata joqeveritare të rajonit.

Në lidhje me **lirinë e fesë**, klima ndër-fetare është pozitive dhe në mënyrë reciproke tolerante. Qeveria mbështet marrëdhëniet pozitive midis komuniteteve fetare. Shqipëria vazhdon të japë një shembull të shkëlqyer të harmonisë fetare në rajon. Megjithatë, komunitetet mbeten të prekura nga pamundësia e autoriteteve deri tani për të siguruar kthimin e plotë të pasurive dhe sendeve të tjera personale.

*Të drejtat ekonomike dhe sociale*

Në lidhje me **të drejtat e femrave (grave)**, Shqipëria po e harmonizon me *acquis* legjislacionin e saj për kushtet e punës dhe mundësitë e barabarta. Amendimet në Ligjin e Barazisë Gjinore të 2004-ës i dhanë

Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Mundësive të Barabarta përgjegjësinë ekskluzive për barazinë gjinore. Kjo çoi në ngritjen e një sektori specifik në ministri për çështjet e barazisë gjinore. Është miratuar një ligj i ri për adresimin e dhunës në familje. Ai rregullon rrjetin e autoriteteve që trajtojnë dhunën në familje dhe siguron masa mbrojtëse të reja për viktimat, si për shembull urdhër për mbrojtjen të lëshuara nga gjykatat. Një program masteri për barazinë gjinore dhe zhvillimin është ngritur nga Instituti i Studimeve Gjinore në Fakultetin e Shkencave Sociale në Universitetin e Tiranës.

Megjithatë, Ligji i Barazisë Gjinore nuk siguron mbrojtje të plotë kundër diskriminimit mbi baza gjinore siç parashikohet nga *acquis* dhe gjithsesi në të shumtën e rasteve nuk është zbatuar. Duhet më tepër punë për sigurimin e një strategjie kombëtare, legjislaionin zbatues, strukturat dhe stafin e trajnuar. Organet qeveritare që merren me barazinë gjinore si Komiteti Shtetëror për Mundësi të Barabarta, mbeten ende të dobëta, si edhe OJF-të në këtë fushë. Puna për Strategjinë Kombëtare gjithëpërfshirëse për Barazinë Gjinore nuk është përfunduar ende. Hapa të mëtejshëm nevojiten për të përmirësuar përfshirjen e femrave në tregun e punës si dhe pjesëmarrjen e tyre në procesin e vendimmarrjes politike dhe ekonomike. Nga 140 deputetë në parlament, vetëm 10 janë femra. Vetëm një nga 15 ministrat e qeverisë është femër. Shqipëria mbetet në fazat fillestare për sa i përket përfshirjes së çështjeve gjinore në politikat e punësimit dhe politika të tjera. Ligji i ri për dhunën në familje nuk e bën dhunën në familje një shkelje specifike dhe nuk parashikon çështjen e martesës së detyruar. Shqipëria vazhdon të mbetet një vend origjine për trafikimin e femrave, shpesh të mitura, për shfrytëzim seksual.

Përgjithësisht, janë bërë disa përparime në forcimin e të drejtave të femrave. Megjithatë, legjislaioni shqiptar ende nuk i mbron këto të drejta mjaftueshëm dhe nuk zbatohet plotësisht.

Në lidhje me **të drejtat e fëmijëve**, qeveria po bën përpjekje për të grumbulluar të dhënat që të mundësojnë vlerësimin e nevojave. Seksionet e reja për personat nën moshë në gjashtë gjykata rrethesh, do të përmirësojnë trajtimin e personave nën moshë për sa i përket drejtësisë penale. Sistemi i monitorimit të të drejtave të fëmijëve përfshin njësi rrethi të cilat grumbullojnë të dhëna për çështje individuale dhe forcojnë kapacitetin e autoriteteve vendore për mbrojtjen e fëmijëve. Pesë Njësi të reja lokale për të Drejtat e Fëmijëve janë ngritur. Një sistem monitorimi për punën e fëmijëve është ngritur gjithashtu për të evidentuar fëmijët e punësuar, vlerësimin e risqeve, dhe propozimin e alternativave me shanse për sukses.

Progres është bërë në drejtim të përmirësimit të aksesit në arsimin fillor dhe cilësisë së tij. Ministria e Arsimit ka filluar një program “shansi i dytë” për të ri-integruar fëmijët që kanë braktisur shkollën. Ministrinë e Arsimit dhe e Financave nënshkruan një marrëveshje për bashkëpunim dhe shkëmbim informacioni për të parandaluar aktivitetet e arsimit privat të palicencuar. Progres është bërë në përcaktimin e treguesve për ushqimin e fëmijëve. Rregullat e shërbimeve sociale për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe viktimat e trafikimit janë përmirësuar. Në lidhje me fëmijët e mbajtur në shtëpi dhe rrjedhimisht të privuar nga e drejta e tyre për arsimim, numri i fëmijëve të ngujuar nga gjakmarrja ishte 104 në vitin 2004, shkoi në 95 në vitin 2006 dhe 87 në 2007.

Megjithatë, një projekt-ligj për regjistrimin e lindjeve, i cili është jetik për zgjerimin e aksesit të fëmijëve në arsim dhe kujdes shëndetin parësor, nuk është miratuar ende nga qeveria. Burimet e qeverisë nuk janë të mjaftueshme për t’u garantuar fëmijëve të drejtën për arsimim. Mekanizmi mbrojtës për fëmijët mbetet relativisht i dobët. Për nëpunësit e shtetit që punojnë për mbrojtjen e fëmijëve, kërkohet përmirësim i trajnimit të tyre. Ndërgjegjësimi për të drejtat e fëmijëve, midis fëmijëve dhe të rriturve, mbetet i kufizuar.

Numri i lartë i fëmijëve të paregjistruar në lindje, veçanërisht në komunitetin rom, i bën ata shumë vulnerabil ndaj trafikantëve.. Puna e fëmijëve vazhdon të jetë e përhapur: 32% e fëmijëve të moshës nga 6 dhe 17 vjeç, punojnë. Amendimet në Kodin Penal në lidhje me shfrytëzimin e fëmijëve përmes punës së detyruar, shitjes dhe pornografisë, janë propozuar por ende nuk janë miratuar nga parlamenti. Neni 7 i Kartës Evropiane Sociale në lidhje me të drejtën e fëmijëve dhe personave të rinj për mbrojtje, mbetet i papërmbytur, pasi masat e autoriteteve për mbrojtjen e të miturve nga shfrytëzimi seksual deri tani kanë pasur efekt të kufizuar. Progresi i mëtejshëm në drejtësinë e personave nën moshë kufizohet nga mungesa e një kodi specifik ligjor.

Përgjithësisht, janë bërë disa përparime në të drejtat e fëmijëve. Progresi i mëtejshëm është penguar nga vonesat në legjislacionin parësor dhe mungesa e burimeve.

Për sa i përket **personave vulnerabël (në nevojë) nga ana sociale dhe/ose personave me aftësi të kufizuar**, aktualisht 114.000 familje përfitojnë ndihmë sociale. Qeveria ka miratuar standarde të reja për shërbimet sociale dhe ka ngritur një njësi për t'i monitoruar ato. Janë rishikuar kriteret e licencimit për operatorët e shërbimit social. Ligji për Shërbimet Sociale u amendua për të hequr kufirin e moshës për përkrahjen financiare.

Një strategji kombëtare për personat me aftësi të kufizuar po zbatohet. Një Sekretariat për Personat me Aftësi të Kufizuar është ngritur në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Mundësive të Barabarta për të monitoruar zbatimin e saj. Progresi pasqyrohet nga rritja prej 30% e burimeve financiare për të mbështetur personat me aftësi të kufizuar gjatë dy viteve të fundit, si dhe nga legjislacioni i ri i miratuar për rregullat e të drejtave të njeriut dhe procedurat për spitalet psikiatrike. Hapat e parë janë marrë për të sistemuar personat e sëmurë mendorë në ambiente komuniteti, sesa në spitale psikiatrike.

Megjithatë, nuk janë caktuar burime shtetërore për zbatimin e strategjisë kombëtare për personat me aftësi të kufizuar. Progres nuk ka patur në legjislacionin përkatës. Kërkohet koordinim më i mirë midis ministrive të përfshira. Progres, duke përfshirë legjislacionin e ri, nevojitet për de-institucionalizimin dhe ndihmën për personat në vartësi. Masat që nxisin aksesin e personave me aftësi të kufizuar në punësim, arsim, përfshi arsimimin e integruar, si dhe mjedisin mbeten për t'u marrë.

Amendimet e reja në Kodin Penal parashikojnë specifikisht dënimin e nxitësve të gjakmarrjes, ngujimit dhe vrasësve të gjakmarrjes. Progres nuk ka pasur për ngritjen e një këshilli koordinues kombëtar për të zhvilluar një strategji kombëtare kundër gjakmarrjes dhe për të koordinuar aktivitetet e agjencive qeveritare përkatëse. Mungesa e të dhënave të besueshme për shtrirjen e problemit pengon veprimin e përshtatshëm.

Përgjithësisht, ka pasur disa përparime për sa i përket personave vulnerabël nga ana sociale dhe/ose personave me aftësi të kufizuar, por masat në mbështetje të tyre vazhdojnë të jenë të kufizuara, kështu koordinimi më i mirë i agjencive qeveritare do të përmirësonte rezultatet.

Për sa i përket **të drejtave të punës**, legjislacioni shqiptar u jep punëtorëve të drejtën të formojnë **sindikata**. Organi kryesor për dialogun social është Këshilli Kombëtar i Punës, në të cilin përfaqësohen qeveria, sindikatat dhe punëtorët. Shqipëria ka ngritur një rrjet ndërmjetësimi shtetëror që shtrihet në 12 rrethe për të ndihmuar në zgjidhjen e konflikteve të punës kolektive. Pozita e sindikatave është e dobët për shkak të përmasave të vogla të sektorit industrial, mbizotërimit të ndërmarrjeve shumë të vogla dhe ekonomisë me shumë informalitet. Organizatat e Punëtorëve janë shumë të dobëta. Progres nuk ka pasur

në drejtim të formimit të një Këshillit Kombëtar Ekonomik dhe Social. Mohimi i të drejtës për grevë disa punonjësve shtetërorë, bie ndesh me Kartën Evropiane Sociale.

Në lidhje me **politikat anti-diskriminim**, kushtetuta e Shqipërisë ndalon diskriminimin në bazë gjinie, race dhe feje. Megjithatë, nuk ka ndonjë përcaktim specifik ligjor të diskriminimit apo legjislacion të posaçëm për të adresuar. Duhet të sigurohet mbështetja e duhur institucionale për viktimat, përfshi këtu institucionet ekzistuese përgjegjëse për të drejtat e njeriut.

Në lidhje me **të drejtat e pronësisë**, qeveria ka miratuar një strategji e cila lidh proceset e regjistrimit fillestar të pasurisë së paluajtshme, kthimit, kompensimit dhe legalizimit të ndërtimeve informale. 86% e tokës tashmë është regjistruar. Një valë e parë e vendbanimeve të ndërtuara pa leje mbi tokë shtetërore, është legalizuar nëpërmjet pagesës së një tarife e cila kontribuon në fondin kompensues për ish-pronarët. Ndërtimet pa leje në disa zona bregdetare janë shembur. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ka përmirësuar organizimin e saj të brendshëm, transparencën dhe llogaridhënien, dhe ka bërë disa përparime në përshpejtimin e shqyrtimit të ankesave. Është duke u testuar një databazë për identifikimin, vlerësimin, menaxhimin dhe prioritizimin e 41.000 pretendimeve të vonuara për kthimin dhe kompensimin. Puna për hartën e vlerës së tokës po vazhdon, me rrethin e Tiranës tashmë të përfunduar. Prona shtetërore që mund të përdoret për të kompensuar në natyrë, është duke u identifikuar dhe hedhur në hartë.

Megjithatë, ritmi i kthimit dhe kompensimit mbetet i ngadaltë. Informacioni për rezultatet nuk jepet publikisht. Kërkohen përpjekje të mëtejshme për të adresuar problemin e kthimit të pronës komuniteteve fetare. Strategjia e re duhet të zbatohet dhe monitorohet me efikasitet. Legjislacioni ekzistues kërkon përmirësime, siç është planifikuar në strategji. Organet shtetërore që merren me regjistrimin e pronës, kthimin dhe kompensimin, ende nuk koordinohen mjaftueshëm.

Përgjithësisht, ka pasur progres në forcimin e të drejtave të pronësisë, një prioritet kyç në Partneritetin Evropian. Tashmë nevojitet koordinimi i duhur dhe përshpejtimi i mëtejshëm i kthimit dhe kompensimit të pronave.

#### *Të drejtat e minoriteteve, të drejtat kulturore dhe mbrojtja e minoriteteve*

Në fushën e **të drejtave kulturore**, legjislacioni shqiptar njeh tre minoritete kombëtare ('grekë', 'maqedonas' dhe 'malazezë') dhe dy minoritete etno-gjuhësore (arumunë dhe romë). Në përgjithësi një klimë respekti dhe tolerance mbizotëron në lidhje me grupet e minoriteteve.

Shqipëria ratifikoi Konventën e UNESCO-s për mbrojtjen dhe promovimin e diversitetit të shprehjes kulturore, e cila ka hyrë në fuqi. Shqipëria, brenda caqeve të saj buxhetore, po përpiqet të përmbushë angazhimet e saj sipas Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare. Qeveria nënshkroi memorandume mirëkuptimi me pushtetin vendor për të nxitur përdorimin e gjuhëve minoritare në marrëdhëniet me autoritetet administrative, si dhe për t'i vendosur emra tradicionalë zonave të banuara nga persona që i përkasin minoriteteve kombëtare. Kushtetuta shqiptare parashikon se personat që i përkasin minoriteteve kanë të drejtë të marrin mësim në gjuhën e tyre amtare. Shkollat specifikisht për pjesëtarët e minoriteteve grek dhe 'maqedonas' kanë raport mësues-nxënës shumë më të lartë sesa mesatarja kombëtare. Ministria e Arsimit dhe Shkencës nxori një udhëzim që i lejon fëmijët romë që të pranohen në shkolla edhe pa qenë të regjistruar.

Disa radio dhe operatorë televizivë transmetojnë në gjuhë minoritare, kryesisht në gjuhën greke dhe 'maqedonase'. Minoriteti grek, 'maqedonas' dhe arumun kanë gazetat e tyre. Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve mbështet botimin e një reviste që fokusohet në çështjet sociale dhe kulturore të romëve, si dhe organizon festivale kombëtare të përvitshme me qëllim promovimin e trashëgimisë kulturore të të gjitha minoriteteve në Shqipëri.

Megjithatë, zhvillimi i politikave mbrojtëse kërkon që të dhënat statistikore për minoritetet të jenë të përditësuara. Nuk është bërë progres për rritjen e pranisë në forcat e policisë të njerëzve që i përkasin minoriteteve kombëtare në zonat ku ata jetojnë. Mbetet e vështirë përfshirja në programe shkollore e disa gjuhëve minoritare, veçanërisht asaj rome. Shqipëria nuk e ka nënshkruar Kartën Evropiane për Gjuhët Minoritare dhe Rajonale meqenëse ende nuk mund të përballojë shpenzimet e këtij hapi. Numri i fëmijëve romë në shkollë nuk është rritur ndjeshëm dhe përqindja e romëve që dinë shkrim dhe këndim, mbetet e ulët. Kërkohej veprim i mëtejshëm për të kapërcyer barrierat në arsimin minoritar, siç është varfëria, vështirësitë e gjuhës, migrimi i përkohshëm dhe diskriminimi, veçanërisht për minoritetin rom.

Përgjithësisht, ka pasur disa përparime në të drejtat kulturore, por nevojitet përmirësim i mëtejshëm.

Situata ekonomike dhe sociale e minoriteteve grek, 'maqedonas', serbo-malazez dhe arumun është në përgjithësi e mirë. Njerëzit që i përkasin këtyre minoriteteve marrin pjesë tërësisht në jetën ekonomike, sociale dhe ekonomike të vendit dhe shpesh kanë organizata që përfaqësojnë interesat e tyre. Minoriteti etno-gjuhësor arumun është veçanërisht aktiv në përpjekjet e tij për të ruajtur trashëgiminë etnike e gjuhësore.

Strategjia Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Romëve po zbatohet. Është trajnuar stafi që monitoron zbatimin e saj. Hapa janë marrë për të përmirësuar strehimin, mundësitë për punësim dhe biznes për romët, dhe në organizimin e fushatave të vaksinimit.

Megjithatë, minoriteti rom vazhdon të përballë me varfërinë, diskriminimin, analfabizëm të lartë dhe kushte shumë të vështira jetese. Më pak se gjysma e gjithë fëmijëve romë ndjekin shkollën fillore, dhe vetëm rreth 25% e përfundojnë arsimin fillor. Popullsia rome ka nivel shumë të ulët arsimimi dhe kualifikimi profesional, çka kufizon aksesin në tregun formal të punës dhe rrjedhimisht thellon varfërinë. Romët shpesh punojnë në sektorët informalë, dhe lypja është e përhapur midis grave dhe fëmijëve. Shumë familje rome nuk janë të regjistruara në autoritetet shtetërore. Kjo i përjashton ata nga ndihma sociale, pengon aksesin në shërbimet bazë, duke përfshirë arsimin dhe kujdesin shëndetësor, dhe rrit rrezikun e trafikimit njerëzor. Situata e komunitetit rom në Tiranë tani është e qëndrueshme, por mbetet më e keqe sesa në rrethe të tjera.

Shqipëria nuk merr pjesë në Dekadën e Përfshirjes së Romëve 2005-2015. Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Romët është i ngadaltë dhe i fragmentarizuar. Aktualisht, nuk është akorduar buxhet shtetëror për zbatimin e saj – Ministria e Shëndetit, Kulturës, Arsimit, Transportit dhe e Brendshme, akordojnë fonde çdo vit nga buxhetet e tyre. Faktorë të tjerë janë edhe dobësitë e prioritetëve dhe treguesve të strategjisë, koordinimi i dobët dhe mungesa e pjesëmarrjes efikase të pushtetit vendor apo e dialogut me komunitetin rom, i cili në vetvete ka kapacitete organizative të dobëta. Janë vetëm tre vetë nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale që monitorojnë zbatimin e strategjisë. Nevojiten përpjekje të tjera për t'i dhënë minoritetit rom mundësi të barabarta dhe për t'i adresuar problemet e tyre si regjistrimi në gjendje civile, arsimimi, pjesëmarrja dhe përfaqësimi në vendimmarrje.



Përgjithësisht, pak përparime janë bërë në përmirësimin e situatës së romëve, të cilët vazhdojnë të përballen me kushte shumë të vështira jetese dhe diskriminim, veçanërisht në fushën e arsimit, mbrojtjes sociale, kujdesit shëndetësor, strehimit dhe punësimit. Mungesa e burimeve dhe dobësitë e strategjisë kanë kufizuar impaktin e masave të qeverisë.

### 2.3 Çështjet rajonale dhe detyrimet ndërkombëtare

Në lidhje me **Gjykatën Ndërkombëtare të Krimeve (ICC)**, Shqipëria ruan ende një marrëveshje dypalëshe imuniteti me Shtetet e Bashkuara, që në qershor të vitit 2003, e cila lejon përjashtime nga juridiksioni i ICC-së. Kjo marrëveshje nuk përputhet me Qëndrimet e Përbashkëta të BE-së për integritetin e Statutit të Romës, si edhe parimet përkatëse të BE-së për marrëveshjet dypalëshe të imunitetit. Shqipëria duhet të afrohet me qëndrimin e BE-së.

Shqipëria është ende pjesë e procedurës së monitorimit të Asamblesë Parlamentare të **Këshillit të Evropës** e cila verifikon përmbushjen e detyrimeve dhe angazhimeve që rrjedhin nga anëtarësimi në Këshillin e Evropës.

**Bashkëpunimi rajonal** dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë janë pjesë thelbësore e procesit të afrimit të Shqipërisë me Bashkimin Evropian.

Shqipëria gjithashtu ka vazhduar të marrë pjesë aktive në iniciativa të tjera rajonale: Pakti i Stabilitetit dhe procesi i tranzicionit të saj në një kuadër bashkëpunimi më rajonal me një Proces Bashkëpunimi të Evropës Juglindore (SEECP) të përforcuar, si dhe Këshillin e ri të Bashkëpunimit Rajonal (RCC). Në cilësinë e saj si presidente e radhës e Iniciativës së Evropës Qendrore. Gjatë vitit 2006, Shqipëria organizoi Samitin e Kryetarëve të Shteteve si dhe evenimente rajonale të fokusuara në transport, energji dhe gazetari. Shqipëria është palë në Traktatit e Komunitetit të Energjisë dhe në shkurt të vitit 2007 ratifikoi Marrëveshjen mbi Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit (ECAA). Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore hyri në fuqi në korrik 2007. Shqipëria mori pjesë në mënyrë aktive dhe konstruktive në negociata dhe e ratifikoi Marrëveshjen në mars 2007. Shqipëria, Kroacia dhe ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë kanë vazhduar të bashkëpunojnë për reformën politike, mbrojtjen dhe reformën ekonomike, me anë të Kartës së Adriatikut. Karta e Adriatikut fokusohet në qëllimin e përbashkët në arritjen e standardeve për anëtarësim në NATO dhe lejon që të tre vendet të kontribuojnë së bashku në operacionet e NATO-s, me forca të armatosura të grupuara..

**Marrëdhëniet dypalëshe** të Shqipërisë me vendet e tjera të zgjerimit dhe shtetet anëtare fqinje kanë vazhduar të intensifikohen, me anë të vizitave të rregullta dypalëshe. Konsensusi i brendshëm ndërpartiak për çështje të rëndësishme rajonale, vazhdon të jetë i fuqishëm.

Marrëdhëniet me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë kanë vazhduar të zgjerohen, me anë të zhvillimit të një numri takimesh politike dhe teknike. Është nënshkruar një Memorandum bashkëpunimi ndërmjet Prokurorive Publike të të dy vendeve dhe marrëveshja mbi bashkëpunimin kulturor ka hyrë në fuqi.

Marrëdhëniet me Malin e Zi janë zhvilluar më tej, me hapjen e Ambasadës së Shqipërisë në Podgoricë. Të dy vendet hapën pikën e parë të përbashkët kufitare në Ballkanin Perëndimor, atë të Muriqanit/Sokobine.

Marrëdhëniet me Kroacinë, Bosnjë-Hercegovinën dhe Serbinë kanë mbetur pozitive dhe të qëndrueshme. Tregtia ka vazhduar të jetë relativisht e kufizuar.

Politikanë të lartë shqiptarë, përfshi Kryeministrin, Ministrin e Punëve të Jashtme dhe Kryetaren e Parlamentit kanë vizituar *Kosovën*, duke u bërë thirrje udhëheqësve politikë të ruajnë gjakftohtësinë dhe sensin moderator në procesin e përcaktimit të statusit final të Kosovës. Në takimin e Trojkës në qershor 2007, Shqipërisë konfirmoi pozicionin e saj konstruktiv në lidhje me të ardhmen e Kosovës.

*Italia* mbetet partneri kryesor politik dhe ekonomik i Shqipërisë, si dhe investuesi më i madh i BE-së në Shqipëri. Megjithatë, problemet lidhur me mungesën e përputhshmërisë me një marrëveshje koncesionare kanë vazhduar të frenojnë një investim të madh italian në sektorin e logjistikës.

Shqipëria vazhdon të trajtojë marrëdhëniet e saj me *Greqinë* si çështje të një rëndësie strategjike. Greqia mbetet partneri i dytë më i madh tregtar i Shqipërisë si dhe një investitor thelbësor e donator dypalësh. Marrëdhëniet dypalëshe kanë vazhduar të jenë të mira dhe janë zhvilluar vizita të ndërsjella në nivele të larta. Gjithashtu, janë nënshkruar marrëveshje të ndryshme dypalëshe. Shqipëria ka ratifikuar një Marrëveshje të Tregtisë së Lirë me *Turqinë*, një nga detyrimet e Marrëveshjes së Përkohshme. Marrëveshja është në procesin e ratifikimit nga Turqia.

Përgjithësisht, Shqipëria ka vazhduar të zhvillojë marrëdhënie pozitive me partnerët e saj rajonalë, qoftë në nivelin shumëpalësh, ashtu edhe në atë dypalësh. Qëndrimi i vazhdueshëm konstruktiv i Shqipërisë për procesin e statusit të Kosovës ka kontribuar në stabilitetin e rajonit.

### **3. KRITERET EKONOMIKE**

Në ekzaminimin e zhvillimeve ekonomike në Shqipëri, Komisioni u bazua në përfundimet e Këshillit Evropian në Kopenhagen në qershor 1993, ku shprehej se anëtarësimi në Bashkimin Evropian kërkon ekzistencën e një ekonomie tregu funksionale dhe kapacitetet për të përballuar presionet konkurruese dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian.

#### **3.1 Ekzistenca e një ekonomie funksionale tregu**

##### *Politikat ekonomike*

I pari program ekonomik-fiskal për 2006-2008 u paraqit nga autoritetet në dhjetor 2006. Ai është një dokument mjaft konsistent politikash ekonomike që përvijon një kuadër afatmesëm të shëndetshëm. Sidoqoftë, meqë programi nuk parashikonte masa të rëndësishme fiskale për zbatim që nga korriku 2007, vlefshmëria e kuadrit fiskal mbetet e paqartë. Është në përgatitje një strategji kombëtare për zhvillimin dhe integrimin 2007-2013 me theks të fuqishëm mbi reformën ekonomike. Bashkëpunimi me institucionet financiare ndërkombëtare vazhdoi të jetë bazë e konsoliduar për politikat ekonomike. Në korrik 2007, Fondi Monetar Ndërkombëtar përfundoi analizën e tretë të programi aktual ku konstatoi se ishin realizuar të gjithë objektivat sasiore dhe kushtet strukturore. Përgjithësisht, është ruajtur konsensusi i brendshëm për çështje thelbësore të ekonomisë së tregut.

##### *Stabiliteti makroekonomik*

Në 2006, PBB reale u rrit me 5%, nga 5.6% në 2005, e nxitur kryesisht nga kërkesa e brendshme që u rrit nga bumi i kreditimit dhe fluksit të konsiderueshëm të remitancave. Pavarësisht veprimeve të qeverisë për rritjen e importit të energjisë pas krizës së parë energjetike në fund të 2005-ës, Shqipëria vazhdoi të vuajë ndërprerje të rënda të furnizimit me energji gjatë 2006-ës dhe 2007-ës. Gjatë 2006, kjo mungesë

energjie pati impakt të pakët mbi rritjen ekonomike dhe llogaritë rrjedhëse, pasi importet e energjisë nuk ishin edhe aq të mëdha. Megjithatë, me përkeqësimin e situatës energjetike gjatë 2007-ës, impakti i importit të saj mbi llogaritë rrjedhëse do të jetë më i ndjeshëm.

Deficiti i llogarive rrjedhëse u thellua nga 7.3% të PBB-së në 2005, në 7.6% të PBB-së në 2006; kjo kryesisht si rezultat i rritjes së importit të energjisë elektrike. Në 2006, deficiti tregtar u rrit në 23.1% të PBB-së dhe u thellua më tej me rreth 24% në gjysmën e parë të 2007-ës, krahasuar me të njëjtën periudhë vitin e kaluar. Rritja e eksporteve të mallrave dhe shërbimeve, me rreth 21%, parakaloi rritjen në importet e mallrave, me përafërsisht 19.5% në 2006. Mbulimi i importit, domethënë, eksportet si përqindje e importeve, u rrit lehtësisht në 49% në 2006 krahasuar me 2005. Trendi pozitiv, pra rritja më e shpejtë e eksporteve sesa e importeve, vazhdoi edhe në gjysmën e parë të 2007-ës me norma vjetore rritjeje prej përafërsisht 27% dhe 24%. Të ardhurat nga turizmi u rritën me 16% në 2006 dhe e tejkaluan vlerën e eksporteve të mallrave me 28%.

Financimi i deficitit tregtar vazhdoi të varet ndjeshëm nga remitanatet e konsiderueshme dhe transferua të tjera rrjedhëse nga jashtë shtetit, që zënë rreth 13% të PBB-së në 2006 ose përafërsisht 55% të deficitit tregtar. Investimet e huaja të drejtpërdrejta (FDI) u rritën me 16% në 2006 krahasuar me 2005, me një vlerë prej 3.6% të PBB-së për 2006-ën. Borxhi i jashtëm qeveritar ishte rreth 17% i PBB-së në fund të vitit 2006, ose 31% i borxhit publik total. Rezervat bruto vazhduan të rriten gjatë 2006-ës dhe u shtuan në rreth 4.5 muaj importi mallrash dhe shërbimesh. Përgjithësisht, deficitet e jashtme u thelluan më tej, kryesisht për shkak të vështirësive të sektorit energjetik.

Të dhënat tregojnë se papunësia ka rënë në 13.8% në 2006, krahasuar me 14.2% në 2005. Kjo prirje vazhdoi edhe në tremujorin e parë të 2007-ës, dhe papunësia u ul deri në 13.6%. Punësimi më i lartë është vërejtur në sektorët e minierave, të përpunimit dhe të shërbimeve. Të papunët afatgjatë zënë 65% të totalit të të papunëve të regjistruar. Përgjithësisht, niveli i papunësisë së regjistruar vazhdoi të ulet.

Objektivi primar i regjimit të shkëmbimit vazhdoi të jetë ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Kjo është realizuar me vendosjen e objektivave/kufijve implicit për inflacionin dhe për luhatjet e pavarura. Banka e Shqipërisë hera-herës ndërhyri në tregun e këmbimeve me jashtë me objektiv zbutjen e luhatjeve të përkohshme dhe akumulimin e rezervave të valutës. Një normë vjetore inflacioni prej 3% me bandë luhatjeje +/- 1% është vendosur si objektiv për t'u realizuar në strategjinë e bankës qendrore, me anë të ndryshimeve në normën e ri-blerjes. Përgjatë 2006-ës, leku ruajti relativisht stabilitetin kundrejt euros. Pas një zhvlerësimi të lehtë, me rreth 2.5% kundrejt euros në katër muajt e parë të 2007-ës, leku u kthye në nivelet e fillimvitit, dhe në shtator u vlerësua edhe më tepër. Kanë përparuar diskutimet në Bankën e Shqipërisë për një ndryshim të mundshëm të kuadrit të politikës monetare drejt një regjimi eksplicit inflacioni .

Rritja vjetore e M2<sup>6</sup>-shit në qarkullim u përshpejtua deri në 16.3% në fund të 2006 dhe qëndroi në 16% në gusht 2007. Inflacioni mesatar vjetor arriti në 2.4% në 2006, por u ngjit në 4.4% në shtator 2007 nxitur nga rritja e çmimeve të produkteve bujqësore. Pas rritjes së politikës kryesore të interesave në korrik 2006 dhe nëntor 2006, Banka e Shqipërisë e shtrëngoi më tej normën e politikës kryesore edhe me 25 pikë të tjera. Kjo synonte që inflacioni i pritshëm të ecte paralel me rritjen e shpejtë të kreditimit dhe rritjen relativisht të lartë të sasisë së parasë. Përgjithësisht, politika monetare qëndroi e besueshme, duke e mbajtur inflacionin brenda bandës së planifikuar të luhatjeve.

---

<sup>6</sup> "broad money"

Në 2006, performanca e buxhetit përfitoi nga mjedisi i favorshëm makroekonomik. Rritja solide ekonomike, kombinuar me zbatimin e reformave që synojnë përmirësimin e administratës tatimore dhe reduktimin e evazionit fiskal, çuan në rritje solide të mbledhjes së të ardhurave. Përveç kësaj, shpenzimet kapitale ishin më të ulëta se planifikimi (me rreth 17%). Kjo ishte pjesërisht si rezultat i mungesave të kapaciteteve në disa ministri dhe menaxhimi i dobët i prokurimeve. Për 2006, qeveria kishte vënë objektivat që deficitin të ishte 4% e PBB-së dhe e arriti. Në fakt, deficitin qëndroi në 3.2% të PBB-së.

Buxheti për 2007, miratuar nga parlamenti në nëntor 2006, planifikon një deficit prej 4.8% të PBB-së, pa llogaritur të ardhurat nga privatizimet e mundshme. Të ardhurat parashikohen në 26% të PBB-së, duke tejkaluar ato të 2006-ës me rreth 10%. Shpenzimet parashikohen në 30.6% të PBB-së, me rritje rreth 12.5% krahasuar me buxhetin 2006. Sektorët prioritarë vazhduan të jenë infrastruktura, kujdesi shëndetësor dhe arsimiti, ku secili përbën rreth 3% të PBB-së. Pagat mesatare të sektorit publik u rritën me 14.9% në 2006. Në 6-mujorin e parë të 2007-ës, buxheti shënoi tepërcë prej 1% të PBB-së së projektuar për tërë vitin, kryesisht për shkak të mosshpenzimeve në buxhetin kapital. Në dritën e këtyre zhvillimeve të favorshme në aspektin e shpenzimeve dhe me të ardhurat nga privatizimi i Albtelekomit, gjysma e të cilave do të përdoret për uljen e borxhit, autoritetet ranë dakord me Fondin Monetar Ndërkombëtar për një buxhet shtesë për gjysmën e dytë të 2007-ës. Ashtu si në 2006, pjesa më e madhe u akordua si investim produktiv shtesë, kryesisht në projekte të infrastrukturës. Gjithashtu, një taksë e sheshtë për të ardhurat personale prej 10% me 0% taksë për 10 000 lekët e para për rrogat deri në 30 000 lek, hyri në fuqi në gusht 2007. Përgjithësisht, performanca e të ardhurave ishte gjerësisht në linjë me objektivat, si dhe zbatimi i buxhetit është përmirësuar.

Raporti borxh/PBB është reduktuar shumë gjatë viteve të fundit, nga 71% në fund të vitit 2000, në nën 56% në fund të 2006-ës. Sidoqoftë, niveli i borxhit publik të brendshëm mbetet relativisht i lartë, në rreth 39% të PBB-së në fund të 2006. Maturiteti mesatar i borxhit publik të brendshëm u rrit nga 195 ditë në 2005, në 242 ditë në fund të 2006-ës. Megjithatë, vazhdon të jetë relativisht i ulët dhe duhet të përshpejtohen përpjekjet për ta zgjatur. Qeveria miratoi në fillim të 2007-ës strategjinë e menaxhimit të borxhit publik dhe u ngrit një drejtori e re për menaxhimin e borxhit, nën varësinë e Ministrisë së Financave. Autoritetet nxorën me sukses të parën bono 5-vjeçare kombëtare në nëntor dhe një bono me vlerë euro në dhjetor 2006, duke zgjeruar gamën e instrumenteve si dhe bazën e investuesve. Sidoqoftë, kapacitetet administrative dhe ato të menaxhimit të riskut në menaxhimin e borxhit publik duhet të forcohen më tej në mënyrë që të pakësohen mangësitë e theksuara dhe dobësitë që rezultojnë nga struktura aktuale e borxhit.

Progresi solid ka vazhduar në zbatimin e reformave në financat publike. Autoritetet përfunduan strategjinë e financave publike për 2007-2013. Strategjia evidentoi qartë prioritetet kryesore, politikat dhe masat përkatëse për rritjen e eficiencës së financave publike në planin afatmesëm. Megjithatë, impakti i reformave të mëtejshme në qëndrueshmërinë e financave publike, mbetet për t'u diskutuar më tej. Përgjithësisht, reformat në financat publike kanë avancuar, por ekzistojnë akoma risqe fiskale.

Politika rigorozë monetare e Bankës së Shqipërisë vazhdoi të përqendrohet drejt stabilitetit të çmimeve. Rregullime shtesë fiskale u kryen në 2006, ndërsa shpenzimet u rritën në 2007, pasi përmirësimi i mbledhjes së të ardhurave lejoi harxhime më të larta. Objektivat e deficitit dhe borxhit të rënë dakord me FMN-në u realizuan dhe u tejkaluan. Një buxhet shtesë u miratua në korrik 2007 që rriti veçanërisht shpenzimet për investimet. Në përgjithësi, miksi i politikave makroekonomike vazhdon të jetë përgjithësisht mjaft i përshtatshëm.

*Ndëroprimi i forcave të tregut*

Përqindja e sektorit privat në PBB ka qenë rreth 80% në 2006. Gjatë 2006, sektori privat ka punësuar rreth 82% të numrit total të të punësuarve. Brenda kësaj shifre, bujqësia zë 71% të të punësuarve në sektorin privat. Sektori privat u zgjerua më tej, gjithashtu falë përshtetimit të procesit privatizues. Në korrik 2007, parlamenti miratoi shitjen e 76% të kuotave të Albtelekomit, operatorit publik të telekomunikacioneve. Ky ishte privatizimi më i rëndësishëm që në 2004. Çmimi ishte 120 milion EUR, i barabartë me rreth 1.5% të PBB-së së parashikuar për 2007-ën. Megjithatë, pronësia shtetërore mbetet dominuese në ndërmarrjet publike si KESH, Ndërmarrja e Rafinimit dhe Tregtimit të Naftës dhe Albpetrol-1, formuar së fundmi nga shkrirja e Albpetrolit me Servcom. Disa përparime janë arritur në përgatitjen e terrenit për privatizimin e sektorit shpërndarës të KESH-it. Objektivi i qeverisë për shitjen e një pakete kuotash të kompanisë shtetërore të sigurimeve, ende nuk është arritur. Për ta përmbledhur, pas vonesave të konsiderueshme në agjendën e privatizimeve për 2006-ën, progresi në privatizim ka rifituar ritmin që nga fillimi i 2007-ës.

#### *Hyrja dhe dalja nga tregu*

Progres solid është bërë në kompjuterizimin e të dhënave të bizneseve që kanë qenë të regjistruara. Qendra Kombëtare e Regjistrimit të bizneseve, e cila funksionon që në shtator 2007, synon të shërbejë si *one-stop-shop*. Koha mesatare e nevojshme për ngritjen e një biznesi, ishte 36 ditë. Numri i bizneseve të reja të regjistruara është rritur ndjeshëm, me rreth 46% në 2006, e barasvlershme me mbi 14 000 regjistrime të reja. Numri total i bizneseve të regjistruara qëndroi në thujse 78 000 në fund të 2006-ës. Megjithatë, kostot për hapjen dhe mbylljen e një biznesi, mbeten relativisht të larta. Përgjithësisht, procedurat e regjistrimit të shoqërive filluan të përmirësohen, por inefficiencat administrative vazhdojnë të pengojnë hyrjen në treg dhe daljen.

#### *Sistemi ligjor*

Ngritja në maj 2007 e një njësie të përbashkët investigimi për krimin ekonomik dhe korrupsionin, është zhvillim pozitiv, megjithëse kapacitetet e saj operuese kanë qenë të dobët deri tani. Sistemi gjyqësor vuan nga procedimet jotransparente dhe inefficente. Janë vërejtur ndërhyrje politike dhe të paligjshme në sistem. Ndërkohë që janë bërë përparime në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore dhe të drejtave të pronësisë, eficaenca e përgjithshme e sistemit gjyqësor dhe zbatimi i ligjit mbeten të ulëta.

#### *Zhvillimi i sektorit financiar*

Sektori financiar dominohet nga bankat tregtare, praktikisht të gjitha me pronësi private. Shkalla e përqendrimit të tregut mbetet mjaft e lartë pasi grupi i pesë bankave më të mëdha mbizotëron në treg me 75% të aseteve në korrik 2007. Kjo shifër përbën një ulje me pothuaj 4% të përqendrimit krahasuar me fundin e vitit 2005. Kthimi mesatar për asetet qëndroi stabil në 1.4% në 2006, ndërsa kthimi mesatar për ekuitetet u ul lehtësisht në 20.2% në 2006, nga 22.2% në fund të 2005-ës. Raporti mesatar i kapitalit adekuat qëndroi në 18.1% në fund të 2006, ose 0.5% pikë më e ulët se një vit më parë. Kjo i atribuohet kryesisht rritjes së përshtetuar të aseteve të ponderuara, në kurriz të rritjes së shpejtë të kreditit. Raporti i kapitalit adekuat ndryshon thelbësisht midis bankave, dhe më i ulëti është 12.4%. Testet e stresit tregojnë për soliditet të sektorit bankar ndaj lëkundjeve të mundshme që rezultojnë nga luhajtjet në normat e shkëmbimit dhe të interesit, si dhe nga përkeqësimi i cilësisë së kreditimit. Përgjithësisht, sektori bankar privat po rritet dhe në përgjithësi i shëndoshë.

Rritja vjetore e kreditit (74% në 2005) u moderua disi deri në 57% në 2006. U rrit në 58% gjatë katër muajve të parë të 2007-ës. Kreditimi në lek shqiptar shënoi rritjen më të lartë me rreth 78% në 2006,

ndërsa kreditimi në valutë u rrit me 47%. Niveli i ndërmjetësimit financiar ka mbetur relativisht i ulët. Në fund të 2006-ës, krediti total përbënte 31% të asetëve totale bankare ose 37% të depozitave totale. Kreditimet e pashlyera u ngjiten në 22% të PBB-së në mars 2007, ndërsa kreditimi për biznesit përbënte 66.5% të portofolit kreditues të bankave. Përqindja e huave të pashlyera ndaj kreditit total u rrit në 3.1% në dhjetor 2006, krahasuar me 2.3% në fund të 2005-ës. Përgjithësisht, kreditimi vazhdoi të zgjerohet fuqishëm.

Për ta mbajtur rritjen e kreditimit në nivele të qëndrueshme, mbikëqyrja e kujdesshme u fuqizua në dhjetor 2006. Rregullorja për menaxhimin e riskut të kredive u amendua, që vendosi kërkesa më të larta kapitali për bankat që regjistrojnë rritjen e kreditimit që tejkalon pragjet e vendosura. Përveç kësaj, ligji i ri bankar u miratua dhe hyri në fuqi në qershor 2007. Përgatitjet për ngritjen e byrosë për informacionin mbi kreditimin dhe legjislacioni për përmirësimin e ekzekutimit të kolateralit, kanë vazhduar. Kuadri rregullator për mbikëqyrjen e bankave, pas ndryshimeve rrënjësore të fundit, është i mirëzhvilluar dhe vazhdon procesin i harmonizimit me praktikën ndërkombëtare.

Ristrukturimi i autoritetit mbikëqyrës financiar u miratua nga parlamenti në maj 2007. Plani i veprimit për zhvillimin institucional synon të përforcojë më tej kapacitetet operative të institucionit. Amendimi i ligjit për sigurimet u miratua në fillim të 2007-ës. Sistemi i pensioneve mbetet me zhvillim të mangët. Përgjithësisht, janë bërë përparime në fushën e mbikëqyrjes jobankare; megjithatë, ka hapësira për mbikëqyrje më të fortë jobankare, sidomos për sa i përket industrisë së pensioneve.

### **3.2 Aftësia për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda BE-së**

#### *Ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale*

Rritja ekonomike dhe stabiliteti i Shqipërisë vazhdoi të jetë relativisht i fuqishëm, pavarësisht efekteve negative të krizës energjetike në fund të 2005 dhe në 2006. Megjithatë, klima e biznesit mbeti shumë e dobët dhe kërkon përmirësime domethënëse të mëtejshme. Mangësitë e theksuara të gjyqësorit, pasiguria për të drejtat e pronësisë, niveli i lartë i korrupsionit, infrastruktura e papërshtatshme dhe sidomos pasiguria në furnizimin me energji, vazhduan të pengojnë zhvillimin ekonomik dhe investimet.

#### *Kapitali njerëzor dhe fizik*

Buxheti për arsimin, që ka qenë në nivele të ulëta, u rrit ndjeshëm në 2007. Një ligj i ri për arsimin e lartë u miratua në parlament në maj 2007. Tregu i punës vazhdoi të përballlet me sfida të mëdha, si për shembull hapja e ngadaltë e vendeve të reja të punës, si edhe papunësia e rinisë dhe papunësia afatgjatë. Efikasiteti i planeve dhe politikave për tregun e punës, mbetën mjaft të kufizuara për shkak të kapaciteteve të mangëta statistikore dhe treguesve kyç të tregut të punës që janë vështirësisht të besueshëm.

Formacioni i kapitalit fiks bruto u rrit nga 30.3% të PBB-së në 2005 në 32.6% në 2006; kjo kryesisht si rezultat i rritjes së investimeve publike. Qeveria u përqendrua në investimet në sektorin energjetik, infrastrukturë dhe transport, veçanërisht në ndërtimin e rrugëve interurbane. Flukset neto të FDI (investimet e huaja të drejtpërdrejta) u rritën nga 3.3% të PBB-së në 2005, në 3.6% në 2006, e barasvlershme me një rritje prej rreth 16%. Sektori i telekomunikacioneve mori pjesën më të madhe të flukseve kumulative FDI në 2006 (35%), i ndjekur nga industria (33%) dhe shërbimet (12%). Një nismë e

re e quajtur "Shqipëria – 1 euro" u lançua në mesin e 2006-ës për të stimuluar flukset FDI, por vijimii kësaj nisme ka qenë i kufizuar deri tani.

Rrjeti rrugor është në gjendje të dobët dhe ka nevojë për rehabilitim dhe zgjerim thelbësor, sidomos rrugët lidhëse me vendet fqinje. Përgatitjet për ndërtimin e rrugës Durrës-Kukës-Morinë dhe përfundimi i rrugëve veri-jug dhe lindje-perëndim janë përsheptuar. Rreth 76% e buxhetit të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve në 2007 është planifikuar për rrjetin rrugor kombëtar.. Vetëm 10% e kësaj shumë është siguruar për mirëmbajtje, një përqindje e pamjaftueshme për të mbuluar nevojat bazë të mirëmbajtjes. Përgjithësisht, përmirësimi i infrastrukturës mbetet një sfidë.

#### *Struktura e sektorëve dhe sipërmarrjeve*

Performanca operative dhe financiare e KESH-it u përkeqësua shumë gjatë periudhës raportuese dhe progres i paktë është arritur për ta bërë shoqërinë financiarisht të qëndrueshme, gjë që kërkon përmirësim të faturimit dhe të arkëtimeve. Megjithatë, nën menaxhimin e ri, progres i dukshëm është bërë në arkëtime gjatë 3-mujorit të dytë 2007. Prodhimi i brendshëm vetëm pjesërisht arriti të plotësojë nevojat e brendshme për energji, dhe si pasojë, u desh që energjia të importohej. Kapacitetet e pamjaftueshme të interkonjeksionit për importimin e sasive të nevojshme, rezultoi në ndërprerje të furnizimit. Problem kyç mbetet fakti që çmimi me pakicë i energjisë është mbajtur nën kostot e importit, duke çuar në varësi të buxheti. Prerjet e vazhdueshme të energjisë patën efekt negativ mbi prodhimin e sektorit privat dhe investimet. Si rezultat, sektori energjetik mbetet një nga risqet më të mëdha për stabilitetin makroekonomik dhe për buxhetin. Përgjithësisht, sektori energjetik mbetet tepër vulnerabël. Është esenciale marrja e masave të fuqishme për adresimin e inefficiencave kryesore.

Përqindja që zënë sektorët kryesorë të ekonomisë, qëndroi relativisht stabël. Sektori i shërbimeve vazhdoi të jetë kontribuuesi kryesor në PBB në 2006 me rreth 47% (1% më pak se në 2005), i ndjekur nga bujqësia me rreth 21%, ndërtimi që po rritet gradualisht me 16%, industria me 10% dhe transporti me 6%. Ekonomia informale vazhdon të jetë e konsiderueshme, duke dëmtuar konkurrueshmërinë e ekonomisë. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme gjeneruan përafërsisht 64% të PBB-së në 2006. Ato zënë 99% të numrit total të firmave dhe 66% të punësimit total. Vlerësohet se 49% e sipërmarrjeve kanë qenë aktive në sektorin e tregtisë, 24% në sektorin (jotregtar) të shërbimeve, 11% në industri dhe 10% në transport. Pothuaj 50% e të gjitha sipërmarrjeve aktive po operojnë përgjatë korridorit Tiranë-Durrës, ku punojnë rreth 57% e numrit total të të punësuarve. SME-të vazhdojnë të jenë kontribuuesi kryesor në rritjen ekonomike, punësim dhe uljen e varfërisë.

#### *Ndikimi i Shtetit në konkurrueshmëri*

Tregtia përgjithësisht liberale dhe politikat për klimën e biznesit vazhduan të lehtësojnë zhvillimin e ekonomisë së orientuar nga sektori privat. Megjithatë, subvencione të konsiderueshme vazhduan t'u sigurohen sipërmarrjeve publike, sidomos KESH-it. Këto subvencione u dhanë për të përmirësuar furnizimin me energji dhe për të shmangur përkeqësimin e mëtejshëm të pozitave financiare të KESH-it, duke reduktuar kështu efektet e ndërprerjeve të energjisë në aktivitetin ekonomik. Por, kjo përbën një barrë të rëndë për buxhetin. Subencionet totale dhe transferuat nga buxheti shkuan në 0.3% të PBB-së ose 0.9% të të ardhurave të buxhetuara në 2006. Mbështetja buxhetore për KESH-in në 2007 arriti në 0.5% të PBB-së. Përgjithësisht, edhe pse autoritetet nuk ndërhyjnë drejtpërdrejt në zhvillimin dhe funksionimin e sektorit privat, subvencionet për ndërmarrjet publike, sidoqoftë, vazhduan të jenë relativisht të larta.

#### *Integrimi ekonomik me BE-në*

Vlera e eksportit dhe importit shqiptar të mallrave dhe shërbimeve përbënte 74% të PBB-së në 2006, duke rritur hapjen e ekonomisë krahasuar me 2005 (68% të PBB-së). BE është partneri tregtar më i madh i Shqipërisë. Eksportet e mallrave të Shqipërisë në BE zënë rreth 88% të eksportit total në 2006. Importet nga BE përbëjnë rreth 63% të importit total të mallrave. Në të njëjtën kohë, Shqipëria e zgjeroi tregtinë me vendet fqinjë joanëtare. Një termat e strukturës së eksportit, produktet e veshjeve të këmbës dhe industria tekstile së bashku zunë rreth 55% të eksportit total të Shqipërisë në mallra.

Norma reale e këmbimit qëndroi stabil në 2006. Për shkak se të dhënat për prodhueshmërinë e punës dhe konkurrueshmërinë e çmimeve bazuar në kostot reale për një njësi punë, janë të pakta dhe vështirësisht të verifikueshme, është e vështirë të analizohen prirjet e fundit në këtë aspekt.

Të ardhurat për frymë në Shqipëri, matur me standardet e fuqisë blerëse, ishin rreth 18% të mesatares BE-27 në 2007, pothuaj 0.5 pikë përqindje më e lartë se niveli i 2005-ës.

#### 4. STANDARDET EVROPIANE

Ky seksion analizon kapacitetet e Shqipërisë për të përafuar gradualisht legjislacionin dhe politikat e veta me *acquis* për sa i takon tregut të brendshëm, politikave sektoriale dhe drejtësisë, lirisë dhe sigurisë, në linjë me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit dhe prioritetet e Panrteritetit Evropian. Gjithashtu këtu analizohen kapacitetet administrative të Shqipërisë.

##### 4.1.1. Lëvizja e lirë e mallrave

Progres i dukshëm është shënuar në fushën e **standardizimit**. Në fund të shtatorit 2007, Shqipëria miratoi 11,814 standarde evropiane (EN) që përfaqësonin 72.5% të të gjitha EN-ve të Komitetit Evropian për Standardizim (CEN) dhe Komitetit Evropian për Standardizimin Elektroteknik (CENELEC). Ritmi i adaptimit të EN-ve është i mirë dhe objektivi i adaptimit të 80% të EN-ve deri në fund të vitit 2008, ka shumë mundësi të realizohet. Shqipëria vazhdon t'i japë prioritet miratimit dhe zbatimit të atyre EN-ve që janë harmonizuar nën direktivat e qasjes së re.

Drejtorja e Përgjithshme e Standardizimit ka bashkëpunuar me minsitritë e linjës në adoptimin e EN-ve, si dhe në tërheqjen e statusin detyrues të standardeve shqiptare bazuar në dekretet ekzistuese qeveritare. Kjo ka sjellë një reduktim të konsiderueshëm të numrit total të këtyre standardeve të detyrueshme. Përpyekjet e DP të Standardizimit për të rritur ndërgjegjësimin e sektorit privat rreth përfitimeve nga standardizimi, kanë çuar në një përdorim më të madh të standardeve, veçanërisht të EN-ve. Drejtorja ka marrë pjesë vazhdimisht në aktivitetet e CEN-it dhe CENELEC-it si një anëtare e atashuar dhe ka shënuar progres të konsiderueshëm drejt anëtarësimit të plotë në të dy këto organizmat.

Megjithatë, një projektligj i ri për standardizimin me aktet përkatëse zbatuese që është dorëzuar në qeveri, nuk është miratuar ende. Ky projektligj parashikon ngritjen e një bordi mbikëqyrës të DP të Standardizimit. Bordi do të përbëhet nga përfaqësues të të gjitha grupeve të interesit dhe do të monitorojë aktivitetet e Drejtorisë. Përpyekje të mëtejshme nevojiten për të rritur ndërgjegjësimin e operatorëve ekonomikë, në lidhje me konceptet e standardeve dhe certifikimeve, si dhe me rëndësinë e tyre në tregtinë ndërkombëtare. Përgjithësisht, përgatitjet në fushën e standardizimeve janë në rrugën e duhur, megjithëse ministritë e linjës kanë qenë të ngadalta në përafrimin e rregullave teknike me legjislacionin përkatës të BE-së.



Disa përparime janë arritur në fushën e certifikimit dhe komponentëve të tjerë të **vlerësimit të konformitetit**. Numri i kompanive të certifikuara sipas standardeve ISO 9001:2000, janë mëse dyfishuar gjatë 12 muajve të fundit. Deri më sot, të gjitha certifikimet sipas këtij standardi janë kryer nga organizma të huaj. Përmasat e kufizuara të tregut shqiptar nuk inkurajojnë krijimin e një infrastrukture certifikimi nga një palë e tretë. DP e Standardizimit i ka mbyllur aktivitetet e saj certifikuese dhe tashmë mund të përqendrohet ekskluzivisht në detyrat e saj që lidhen me standardizimin. Përgatitjet në këtë fushë po avancojnë mjaftueshëm.

Në fushën e **akreditimit**, vërehet se është bërë mjaft progres. Drejtoria e Akreditimit (DA) është ristrukturuar dhe ka filluar veprimet e duhura të akreditimit. Ajo akreditoi me sukses gjashtë laboratorët e parë në Shqipëri dhe organin e parë të saj të certifikimit. Akreditimi i laboratorëve të analizave është sektori më i avancuar. Shqipëria ka nënshkruar një kontratë bashkëpunimi me Bashkëpunimin Evropian për Akreditim<sup>7</sup>(EA). Përgatitjet në këtë fushë po avancojnë.

Progres është bërë në fushën e **metrologjisë**. Struktura e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit është rishqyrtuar, duke bërë që të ngrihen katër qendra rajonale, si dhe ngritjen e një drejtorie për mbikëqyrjen metrologjike, me qëllim ndarjen e aktiviteteve të metrologjisë nga ato të mbikëqyrjes. Stafi i DP të Metrologjisë ka përfituar trajnim të mëtejshëm. Në shtator 2007, Shqipëria u asociua në Konferencën e Përgjithshme të Peshave dhe Masave<sup>8</sup>. Megjithatë, ende nuk është hartuar një ligj i ri në metrologji, që transponon direktivat e qasjes së vjetër dhe ngre një sistem metrologjie të decentralizuar, dhe për të liberalizuar disa aktivitete metrologjike siç është kalibrimi. Përgatitjet në këtë fushë janë në fazën fillestare.

Progres është shënuar në fushën e **mbikëqyrjes së tregut**. Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut, në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE) është autoriteti koordinues në fushën e mbikëqyrjes së tregut dhe gjithashtu është përgjegjëse për hartimin e rregullave teknike për sektorët në varësi të saj dhe për mbrojtjen e konsumatorit. Drejtoria u ristrukturua dhe është përforcuar me personel shtesë. Mbikëqyrja aktuale e tregut aktualisht kryhet nga Inspektorati Teknik Qendror i cili është një Drejtori e Përgjithshme e pavarur e METE-s. Ky inspektorat nuk mbulon prodhimet ushqimore, kozmetike dhe materialet e ndërtimit. Këto fusha janë nën përgjegjësinë e ministrive të Bujqësisë, Shëndetësisë dhe Transportit. Inspektorati ka kryer vazhdimisht vlerësime konformiteti paratregtar dhe inspektime tregu në kundërshtim me legjislacionin ekzistues dhe standardet detyruese. Strategjia kombëtare për mbikëqyrjen e tregut për prodhimet industriale dhe ushqimin deri në 2012, mbetet për t'u miratuar. Përgjithësisht, përgatitjet në fushën e mbikëqyrjes së tregut po avancojnë.

Shqipëria ka arritur disa përparime në përafrimin e kuadrit ligjor horizontal me *acquis*. Ajo ka miratuar një ligj të ri mbi sigurinë e përgjithshme të produkteve, kushtet elementare për prodhimet dhe vlerësimin e konformitetit. Ky ligj garanton bazën ligjore për përafrimin e legjislacionit me atë të BE-së për sa i përket lëvizjes së lirë të mallrave, sigurisë e përgjithshme të produkteve dhe ushtrimin e mbikëqyrjes së tregut. Ligji mbi ilaçet dhe shërbimet farmaceutike është amenduar për të riorganizuar Komisionin e Çmimeve të Medikamenteve i cili është autoriteti që siguron transparencën në lidhje me vendosjen e çmimeve të produkteve medicinale për përdorim njerëzor. Shqipëria ka përgatitur mendime për ligjet për lodrat, enët e thjeshta me presion, dhe pajisjet me presion, instrumentet për peshimin jo-automatik, si dhe parapaketimin, ku është reflektuar legjislacioni evropian.

<sup>7</sup> European Cooperation For Accreditation

<sup>8</sup> General Conference on Weights and Measures

Ligji për **mbrojtjen e konsumatorit** që synon të inkorporojë disa elemente të *acquis* në këtë fushë, ende nuk ka hyrë në fuqi. Ende mbetet për t'u bërë dallimi i qartë ndërmjet mbikëqyrjes së tregut dhe mbrojtjes së konsumatorit. Përmirësime të mëtejshme nevojiten në trajtimin e ankesave të konsumatorëve dhe në zhvillimin e sistemeve për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me palë konsumatorin. Përgatitjen kanë filluar në fushën e mbrojtjes së konsumatorit.

#### 4.1.2 *Lëvizja e personave, shërbimet dhe e drejta e vendosjes*

Në fushën e **lëvizjes së personave** është shënuar progres shumë i kufizuar. Projektligji për punësimin e të huajve, ende nuk është përfunduar. Në lidhje me koordinimin e shërbimeve të sigurimeve shoqërore nuk është shënuar asnjë progres.

Progres është arritur për sa i përket **të drejtës së vendosjes** si dhe **ligjit për shoqëritë tregtare**. U miratua një ligj i ri për procedurat e regjistrimit të bizneseve që çoi në ngritjen e Qendrës së regjistrimit të Bizneseve. Kjo Qendër filloi punën në shtator 2007 dhe do të funksionojë si *one-stop-shop*. Gjykatat tashmë janë përjashtuar nga procesi i regjistrimit. Megjithatë, pasiguritë në lidhje me të drejtat e pronësisë vazhdojnë të dekurajojnë vendosjen e ndërmarrjeve. Përgatitjet në këtë fushë po avancojnë disi.

Në kontabilitet dhe auditim janë arritur disa përparime. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit janë publikuar dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar janë në proces përkthimi, pasi Shqipëria aktualisht përdor versionin e 2003-shit. Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit është forcuar. Megjithatë, nevojiten përpjekje të mëtejshme për të siguruar konsistencën e kuadrit ligjor, si dhe për të ndërtuar një kuadër raportimi financiar që të jetë i besueshëm dhe mirëfunksionues, sidomos për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme. Duhet të forcohet zbatimi në praktikë i raportimit financiar. Kanë filluar përgatitjet në këtë fushë.

Disa përparime janë shënuar në lidhje me njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve akademike dhe profesionale. Është miratuar plani i veprimtimit për përmirësimin e procedurave për njohjen e diplomave. Në prill 2007 u miratua ligji për profesionin e infermiereve/mamive. Përgatitjet në këtë fushë janë në fazë fillestare.

Në lidhje me **lirinë për ofrimin e shërbimeve**, është shënuar pak progres. Ende nuk ka ende një dallim të qartë midis ofrimit të shërbimeve mbi bazë të përkohshme dhe atyre nëpërmjet ndërmarrjes së përhershme. Sistemi i licencimit ka nevojë për përmirësime të mëtejshme. Nuk është shënuar asnjë progres i mëtejshëm në fushën e shërbimeve postare. Puna përgatitore për përafrimin e legjislacionit me *acquis* ka marrë drejtim, megjithëse nevojiten ende përpjekje të mëtejshme. Posta Shqiptare u transformua në kompani aksionere dhe pronësia e saj nuk i përket ministrisë përgjegjëse për funksionet rregullatore.

Përsa i përket shërbimeve financiare, janë arritur disa përparime. Kuadri ligjor dhe mbikëqyrës për sektorin bankar është forcuar. Ligji i ri për bankat hyri në fuqi në qershor 2007, duke e sjellë legjislacionin në këtë fushë më pranë standardeve të BE-së. Ky ligj hoqi diskriminimin për trajtimin e degëve të bankave të huaja. Rregullorja për mbi menaxhimin e riskut të kredive u amendua për të rritur kushtet e kapitalit për banka të caktuara. Po vazhdon puna për të transferuar tërësisht përgjegjësinë për mbikëqyrjen e sektorit të qirave në Bankën e Shqipërisë. Megjithatë, ende nevojiten përpjekje për të përafruar më tej ligjin e ri të bankave me *acquis*. Ende nuk është krijuar regjistri i kredive. Edhe pse mbikëqyrja e kujdesshme bankare është fuqizuar, nevojitet të zgjerohet më tej. Bashkëpunimi mes mbikëqyrësve të sektorëve të ndryshëm financiarë duhet të përmirësohet.

Disa përparime janë arritur në sektorin bankar jofinanciar. Ligji i sigurimeve u amendua për të rritur fondin e garancisë për kompanitë e sigurimeve. Janë miratuar një numër aktesh zbatuese për sigurimin, pensionet private dhe tregun e letrave me vlerë (përfshi *prospectus* dhe kalimin e pronësisë) janë miratuar. Është ngritur një autoritet i vetëm mbikëqyrjeje i sektorit jofinanciar bankar që ka zëvendësuar Komisionin e Letrave me Vlerë, Autoritetin e Mbikëqyrjes së Sigurimeve dhe Institucionin e Pensioneve Private. Megjithatë, masa të mëtejshme nevojiten për të fuqizuar kapacitetet e veta operuese.

Përgjithësisht, përgatitjet në fushën e lëvizjes së lirë të shërbimeve po avancojnë.

#### 4.1.3. *Lëvizja e lirë e kapitalit*

Në fushën e lëvizjes së lirë të kapitalit, nuk është shënuar progres. Mbeten kufizime të dukshme, veçanërisht në blerjen e pasurisë së paluajtshme nga të huajt, si edhe në portofolin e investimeve dhe lëvizjeve të tjera afatshkurtra të kapitalit. Ky aspekt kërkon vëmendje për të siguruar përputhshmërinë me detyrimet e MSA-së.

Vazhdon rishikimi i kuadrit ligjor për liberalizimin e plotë të lëvizjeve të kapitalit. Megjithatë, Shqipëria vazhdon të shfaqë kryesisht një ekonomi me bazë kesh (*cash*). Shkalla e ndërmjetësimit financiar vazhdon të jetë relativisht e ulët. Disa sektorë kanë akses të kufizuar në kreditë. Përgatitjet në këtë sektor janë në fazën fillestare.

#### 4.1.4 *Doganat dhe tatimet*

Ka patur disa përparime në fushën e **doganave**. Shqipëria ka marrë masat në kohë për zbatimin e dispozitave lidhur me tregtinë, të Marrëveshjes së Përkohëshme.

Mbledhja e tarifave doganore midis tetor 2006 dhe maj 2007 e tejkaloi synimin me rreth pesë përqind. Dispozitat zbatuese të Kodit doganor në lidhje me magazinat doganore janë amenduar. Sistemi i taksave të brendshme për produktet përpunëse është hequr. Kompjuterizimi i procedurave doganore ka vazhduar dhe rreth 98% e deklarimeve doganore po përpunohen duke përdorur ASACYDA dhe sistemin e përpunimit. Drejtoria e Përgjithme e doganave ka nënshkruar një marrëveshje me TIR

Megjithatë, nevojitet përputhje e mëtejshme me legjislacionin dhe praktikën e BE-së, në veçanti në fushat e procedurave të thjeshtuara doganore dhe procedurat e transitit. Një sistem IT (Teknologji Informacioni) e analizës së riskut që përdoret në doganën kryesore mund të mbulojë 70% të deklarimeve doganore në nivel kombëtar. Megjithatë, përdorimi i këtij moduli nevojitet të zgjerohet meqenëse norma aktuale prej (25%) e inspektimit fizik është ende e lartë sipas standardeve Evropiane. Nuk është shënuar progres për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale dhe kontrollin e mallrave me përdorim të dyfishtë (*dual-use*) në dogana. Tarifa shqiptare bazohet ende në Nomenklaturën e Kombinuar GATT 2005. Në përputhje me Marrëveshjen e Përkohëshme, Shqipëria duhet të fillojë përdorimin e Nomenklaturës së Kombinuar 2007.

Përmirësimet në infrastrukturën e doganave janë shumë të kufizuara. Është përgatitur një program për rindërtimin e pjesës më të madhe të vendkalimeve-kufitare të kategorisë së dytë dhe të tretë, por puna aktuale nuk ka filluar ende. Godina e Doganës në Tiranë kërkon urgjentisht përmirësime. Lëvizja e stafit në administratën doganore ka qenë e matur dhe stafit i është dhënë trajnim i mëtejshëm. Oficerët e Doganës nuk e kanë marrë akoma statusin e nëpunësit civil. Mungesa e sistemeve të performancës së

menaxhimit e frenon motivimin e stafit dhe zhvillimin e karrierës. Në përgjithësi, përgatitjet në fushën e doganave po avancojnë.

Progres është shënuar në fushën e **tatimeve**. Parlamenti miratoi një paketë fiskale duke synuar zvogëlimin e masës së ekonomisë informale. Ajo përfshin një normë takse të sheshtë prej 10% për përfitim të përbashkët dhe taksat nga të ardhurat personale duke vendosur tavane për transaksionet në kesh(cash). Ligji për Taksën e Vlerës së Shtuar (TVSH) është amenduar për të futur përjashtimet në dhënien me qira, për arin, si dhe për të zgjeruar përjashtimet ekzistuese edhe për banka të tjera përveç Bankës së Shqipërisë. Legjislacioni për akcizën është amenduar për të rritur nivelin e tarifës së akcizës në nivelet e BE-së për disa nga produktet që mbulohen.

Progres është arritur në **forcimin e kapaciteteve administrative**. Numri i degëve të administratës tatimore u mendua të jetë nga 36 në 12. Përgjegjësia për mbledhjen e taksave nga biznesi i vogël me anë të decentralizimit iu kalua bashkive. Nivelet e stafit u shkurtuan, kryesisht në njësinë e policisë tatimore dhe zyrat rajonale. Paralelisht kapaciteti i taksës audit u forcua me ngritjen e një seksioni të specializuar për taksën e hetimit të krimit (TACIO). Stafit të TACIO-s i është dhënë kompetencë hetimore dhe trajnim. Stafi i policisë tatimore që del i tepërt mund të futet në TACIO pas përzgjedhjes së duhur dhe trajnimit.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka ngritur një sektor për taksën e apelimit për të kontrolluar ankesat e taksapaguesve. Kompjuterizimi i zyrave të tatimit po përparon dhe një rrjet i ri është futur duke mbuluar 12 zyra tatimore qarku që përfaqësojnë 80% të gjithë taksapaguesve. Qeveria ka caktuar një referim page mujore minimale për llogaritjen e kontributeve të sigurimit shëndetsor e social dhe taksën e të ardhurave personale. Kjo i jep të drejtën administratës tatimore për të rivlerësuar deklaratimet nga entitetet jo-publike duke synuar kontributet sociale dhe taksën e të ardhurave. Analiza që synon identifikimin e taksës së masave me mundësi dëmtuese sipas Kodit të Sjelljes për tatimin e biznesit po finalizohet.

Megjithatë, nevojitet përafrim i mëtejshëm me legjislacionin dhe praktikën më të mira të BE-së. Disa nga amendimet e bëra për legjislacionin e akcizës përfaqësojnë një largim nga sistemi i BE-së. Përcaktimi i produktit dhe struktura, ashtu si dhe normat e zvogëluara për prodhuesit e vegjël të verës, produkteve ndërmjetëse dhe alkolit, nuk janë në përputhje me standardet e BE-së. Ligji i ri për taksën e pagesës së kërkuar, për gjokat e taksës së plotë të vlerësuar, dhe 15% e gjobave të vëna para apelimit në gjykatë, nuk është në linjë me praktikën e BE-së dhe ka sjellë debat midis aktorëve të biznesit. Normat e taksës së mbledhur mbeten të ulta dhe Shqipërisë i mungon mbledhja e taksës gjithëpërfshirëse si dhe strategjia e kontrollit. Heqja e papritur dhe në shkallë të gjerë e stafit është një burim shqetësimi që rrezikon dobësimin e kapaciteteve administrative.

Përgatitjet në fushën e tatimit po avancojnë në mënyrë të mjaftueshme.

#### *4.1.5. Konkurrenca*

Janë shënuar disa përparime në fushën **anti-trust**. Qeveria miratoi një dokument kombëtar për politikën e konkurrencës që të shërbejë si një guidë për ngritjen e tregut të lirë dhe efikas të konkurrencës. Dokumenti u bë çështje e një diskutimi të gjerë ndërmjet personave të interesuar. Prioritetet e tij janë telekomunikacioni, energjia dhe shërbimet financiare. Qeveria ka marrë vendimin të forcojë Autoritetin Shqiptar të Konkurrencës (AK) duke dyfishuar stafin e tij në 35. Një strukturë e re është miratuar ku

përfshin sektorët që merren me analizën e tregut dhe hetimet, çështjet ligjore dhe integrimin në BE. Pesë anëtarë u caktuan në Komisionin e Autoritetit të Konkurrencës, organ vendim-marrës.

AK ka kontribuar në promovimin e kulturës së konkurrencës duke lëshuar rekomandime për pjesë të ndryshme të projekt legjislationit dhe duke përgatitur dokumente për politikat konkurruese. Ka vlerësuar gjithashtu disa njoftime për shkrirjen. AK procedon me gjobat për shkeljet e rregullave të konkurrencës me dy dosje të mëdha në lidhje me telefoninë e lëvizshme (mobile) dhe siguracionin e makinave në pikat e kufirit. AK po procedon gjithashtu me një hetim tjetër të madh në tregun e sigurimeve dhe ka hapur hetimet në lidhje me tregun e çimentos si dhe një kartel për çmimet e bukës.

Ligji për Konkurrencën është pjesërisht i pajtueshëm me *acquis*. Megjithatë, nuk është e qartë se deri në çfarë shkalle mundet AK të punojë individualisht. Kultura e konkurrencës mbetet e dobët në Shqipëri. Autoriteti i Konkurrencës nevojitet të fuqizohet. Postet e reja duhet të plotësohen dhe kërkesat për trajnim plotësues të stafit e tij të sigurohen.

Progres është arritur në fushën e **ndihmës shtetërore**. Departamentit të Ndhmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës i është dhënë pavarësi në raportimet e tij në Komisionin e Ndhmës Shtetërore (KNSH). KNSH është organi vendim-marrës për ndihmën shtetërore. Vendimet e KNSH publikohen në Gazetën Zyrtare dhe janë të mundshme të përdoren në faqen e internetit të Ministrisë. Përfaqësuesit e administratës qendrore dhe vendore janë trajnuar për kuadrin e ri ligjor dhe institucional si dhe për ndihmën e shtetit dhe detyrimeve të tyre ligjore.

Departamenti i Ndhmës Shtetërore, i cili ka pesë anëtarë, ka vazhduar të analizojë skemat ekzistuese të ndihmës së shtetit, si dhe regjistrimin e atyre të reja. Departamenti ka këshilluar për disa drafte legjislative dhe ka organizuar aktivitete për të rritur sensibilizimin tek operatorët e ndihmës shtetërore. KNSH ka vlerësuar tre plane për masat e ndihmës shtetërore dhe ka refuzuar njërin prej tyre.

Janë miratuar dispozita për ankesat e paraqitura dhe për normat e interesit që do të zbatohen për tërheqjen e ndihmës shtetërore të papërputhme. Shqipëria ka filluar përgatitjet për zbatimin e dispozitave të ndihmës shtetërore në protokollin e çelikut të Marrëveshjes së Përkohëshme. Megjithatë, Shqipëria nevojitet të vazhdojë miratimin e legjislationit të ri zbatues në fushën e ndihmës shtetërore.

Përgatitjet në fushën e konkurrencës vazhdojnë të ecin mirë.

#### 4.1.6 *Prokurimi publik*

Disa përparime janë bërë në fushën e prokurimit publik. Shqipëria ka bërë hapa për të harmonizuar legjislationin e saj me *acquis* duke miratuar një ligj të ri prokurimi. Legjislationi zbatues është në fuqi. Ligji i ri i prokurimit merr parasysh parimet e trajtimit të mos-diskriminimit dhe të barazisë, transparencën, vlerën për paranë dhe mbrojtjen ligjore të interesave të ofertuesve<sup>9</sup>. Tenderimi direkt është hequr dhe janë futur kriteret për të identifikuar ofertat e ulta të parregullta.

---

<sup>9</sup> Bidder (personi që jep ofertë)

Faqja e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik (PPA) është përmirësuar për të rritur transparencën dhe aksesin për informim. Ai përfshin dokumentacionin standard dhe template të cilat mund të hidhen (download) në kompjuter. Shpërndahen gjithashtu manuale-udhëzues. Autoritetet e kontraktuara kërkojnë të publikojnë njoftimet e prokurimit dhe dosjet e tenderimeve në faqen e internetit të PPA, të cilat mund të aksesohen elektronikisht nga publiku.

Një njësi trajnimi është ngritur në PPA dhe janë organizuar seminare mbi legjislacionin e ri të prokurimit publik për oficerët dhe magistratët në nivel qendror dhe vendor. Ka patur 30% ankesa më pak në PPA që kur është futur legjislacioni dhe praktikrat e reja. PPA është forcuar me shtimin e dhjetë vendeve të reja pune të cilat janë plotësuar. Parlamenti ka miratuar një ligj për konçensionet, për punët dhe shërbimet, i cili synon zbatimin e standardeve Evropiane për konçensionet e punëve publike.

Megjithatë, kërkojnë përputhshmëri e mëtejshme në të gjitha fushat e prokurimit publik (kontratave publike, ndërmarrje me kapital shtetëror, konçensione). PPA mbetet gjithashtu përgjegjëse për vendimet e ankesave, si pasojë paanësia e procedurave të rishikuara nuk mund të garantohet. Kapacitetet administrative të gjithë këtyre marrëdhënieve me nevojat e prokurimit publik duhet të forcohen për të siguruar që Shqipëria mund të zbatojë plotësisht legjislacionin e ri të prokurimit publik siç duhet. Kërkojnë të dhënat e duhura për të monitoruar zbatimin e ligjit të ri. Bashkëpunimi midis PPA, Ministrisë së Financave dhe Departamentit të konçensioneve në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si dhe të prokurorëve në rastin e shkeljeve ligjore, duhet të përmirësohet ende.

Në përgjithësi, Shqipëria po avancohet në plotësimin e angazhimeve të saj sipas Marrëveshjes së Përkohëshme në këtë fushë.

#### 4.1.7 *Ligji i pronësisë intelektuale*

Ka patur disa përparime në fushën e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Përsa i përket zhvillimeve legjislative, Shqipëria ka ratifikuar Marrëveshjen e Hagës të vitit 1960 dhe Aktin e Gjenevës 1999 për regjistrimin ndërkombëtar të dizenjove industriale.

Zyra e të drejtave të autorit e përcaktuar sipas Ligjit të vitit 2005 për të drejtën e autorit dhe të drejtat që lidhen me të është bërë operative me 12 vetë. Zyra ka ndërtuar marrëdhënie pune me dy shoqëri për mbledhjen e të ardhurave të autorit që operojnë në Shqipëri, d.m.th. ALBAUTOR, e cila mbron të drejtën e autorit në muzikë, dhe FMAA që mbron të drejtën e autorit në veprat audiovizuale. Këshilli Kombëtar i radios dhe televizionit (KKRT) ka nënshkruar një memorandum mirëkuptimi me qendrën kombëtare të kinematografisë (QKK) me qëllim që të luftojë piraterinë dhe të respektojë ligjin e të drejtës të autorit.

Përsa i përket të drejtave të pronësisë industriale, Drejtoria e Përgjithme për patentat dhe markat (DPPM) është rikonstruktuar dhe plotësuar me staf. Regjistrimi dhe administrimi i patentave, markave dhe dizenjove industriale është kompjuterizuar. Kjo ka përmirësuar përpunimin e aplikimeve dhe furnizimin me informacion.

Megjithatë, kërkojnë forcim i mëtejshëm i kapaciteteve të zyrës së të drejtave të autorit dhe DPPM-së. Pirateria dhe falsifikimi mbeten të përhapura. Forcimi i IPR pengohet nga mungesa e eksperiencës dhe kualifikimeve të përshtatshme të gjykatave shqiptare në këtë fushë. Trajnimi i gjykatësve, prokurorëve dhe administratës së doganave nuk është i mjaftueshëm për të zgjidhur problemin. Nevojiten përpjekje të

mëtejshme për të adresuar kapacitetet e kufizuara të doganave të zbulojnë produktet e falsifikuara. Përgjegjësitë e qeverisë janë të fragmentizuara dhe bashkëpunimi ndër-institucional mbetet i dobët. Nuk ka strategji kombëtare për të drejtat e pronësisë intelektuale. Niveli i përgjithshëm i njohurive rreth IPR dhe shkeljeve mbetet i dobët. Ligji aktual për pronësinë industriale nga viti 1994 ka nevojë për përmirësime të konsiderueshme.

Shqipëria ka marrë angazhime të rëndësishme në kuadër të Marrëveshjes së Përkohëshme në fushat e të drejtave intelektuale, industriale dhe tregtare. Megjithatë, përgatitjet në këtë fushë mbeten në një stad fillestar.

#### 4.1.8. *Punësimi dhe politikat sociale*

Ka patur disa përparime në fushën e **punësimit**. Programe të subvencionuara vazhdojnë të nxisin punësimin e grupeve vulnerabël. Një vëmendje e veçantë i kushtohet punësimit të grave të marginalizuara, përfshirë romet, viktimat e trafikimit njerëzor, gratë e moshuara dhe gratë me aftësi të kufizuara. Ekziston një program i posaçëm për të ndihmuar integrimin e të rinjve të diplomuar në tregun e punës. Numri i personave të trajnuar në qendrat e trajnimit profesional është i qëndrueshëm. Kapacitetet e Shërbimit të Punësimit Kombëtar dhe zyrat e tij qendrore dhe vendore janë forcuar me anë të trajnimeve. Megjithatë, Shqipëria nuk ka miratuar ende një qasje shumë-sektorëshe për të stimuluar më tej mundësitë për punësim dhe për të përdorur si duhet krahun e saj të punës që është në rritje. Strategjitë e punësimit dhe trajnimit profesional duhet të integrohen ende në politikat ekonomike, sociale, arsimore, tatimore, të sipërmarrjes si dhe ato rajonale. Mungon vlerësimi i duhur i programeve të punësimit për të vlerësuar impaktin dhe efikasitetin e tyre. Ka mungesë sistemesh informacioni dhe administrimi për të siguruar një ide të saktë të shkallës së punësimit dhe të nevojave të njëzëve të papunë. (Shih gjithashtu seksionin politik për të drejtat ekonomike e sociale)

Ka patur nëfarë progresi për sa i përket **politikave sociale**.

Kuadri rregullator dhe institucional në fushën e *legjislacionit të punës* është përmirësuar me miratimin e ligjit për inspektimin e punës dhe ngritjen e Inspektoriatit të Punës i cili ka vendosur marrëdhëniet e bashkëpunimit me Departamentin e Përgjithshëm të Tatimeve dhe Shërbimin Kombëtar të Punësimit. Megjithatë, kapacitetet e pakta të zyrave rajonale të punësimit dhe të Inspektoriatit të Punës e pengojnë zbatimin e legjislacionit. Nuk ka patur progres në ngritjen e një kuadri modern të përafuar me *acquis* për sa i përket ligjit të punës. Shëndeti e siguria në punë mbeten të dobëta.

Sistemi i monitorimit të punës së të miturve, i cili synon të identifikojë fëmijët që punojnë, vlerëson rreziqet dhe i referon ata në alternativa që japin shanse për sukses, është një hap i mirëpritur që ka nevojë të shoqërohet me veprime konkrete. Megjithatë, puna e të miturve mbetet mjaft e përhapur. Nevojitet që të vazhdohen përpjekjet për të mbrojtur fëmijët që punojnë.

Shqipëria po avancon në përafrimin e legjislacionit të saj për kushtet e punës dhe mundësi të barabarta me standardet evropiane, për sa i përket barazisë gjinore. Megjithatë, Komiteti Shtetëror mbi Mundësitë e Barabarta mbetet i dobët dhe Akti i Barazisë Gjinore mbetet kryesisht i pazbatueshëm. Nevojitet veprim i mëtejshëm për të ndihmuar përfshirjen e grave në tregun e punës dhe pjesëmarrjen e tyre në procesin e vendim-marrjes. Shqipëria mbetet në fazën fillestare për sa i

përket përfshirjes së barazisë gjinore në çështjet e punësimit, si dhe në politika të tjera. (Shih të Drejtat Ekonomike dhe Politike).

Në fushën e mbrojtjes sociale, pagat minimale dhe pensionet janë rritur. Kontributet në sigurimet shoqërore dhe sistemet e pensioneve janë ulur, në mënyrë që të luftohet punësimi informal dhe të rritet mbledhja e sigurimeve shoqërore. Megjithatë, funksionet thelbësore të Institutit të Sigurimeve Shoqërore nuk janë konsoliduar. Nuk ka procedura të përcaktuara si duhet për pensionet dhe kontributet shoqërore. Duhet të ngrihet arkiva kombëtare numerike dhe database për monitorimin elektronik të punëtorëve dhe itinerareve të punësimit të emigrantëve. Hartimi i një strategjie 7-vjeçare për asistencën sociale dhe për Strategjinë e Përfshirjes Sociale 2007-2013 nuk ka përfunduar ende. Për sa i përket varfërisë dhe përjashtimit social, nevojitet urgjentisht përmirësimi i statistikave sociale dhe analizave që mund të shërbejnë si një bazë e fortë për nxitjen e zhvillimit të strategjive të përfshirjes sociale, planeve të veprimit dhe vlerësimit të programeve.

Ka pasur disa përparime në fushën e shëndetit publik. Shqipëria ka hartuar një Strategji të Sistemit Shëndetësor 2007-2013 dhe është angazhuar për arritjen e Objektivave të Mijëvjeçarit për Shëndetin, për shëndetin e nënave dhe fëmijëve. Ministrisë së Shëndetësisë i janë ofruar trajnime për kuadrin ligjor evropian për standardet e transfuzionit të gjakut dhe komponentëve të gjakut.

Përgatitjet në fushën e punësimit dhe politikave sociale janë në fazë fillestare.

#### 4.1.9 *Kërkimi shkencor dhe arsimit*

Janë shënuar disa përparime në fushën e **arsimit**. Buxheti për arsimin, i cili ishte në një nivel të ulët, është rritur ndjeshëm vitin e kaluar. Qeveria ka filluar zbatimin e strategjive kombëtare për arsimin para-universitar, arsimin para-universitar profesional si dhe trajnimet deri në vitin 2015. Vazhdon zbatimi i skemës për provimet përfundimtare dhe ato të pranimit për universitetet shqiptare (Matura Shtetërore). Cilësia e mësimdhënies është përmirësuar me anë të zhvillimit profesional të vazhdueshëm të mësuesve dhe përmirësimit të menaxhimit të shkollave.

Parlamenti ka miratuar një ligj të ri mbi arsimin e lartë, i cili përfshin vijimësinë e procesit të Bolonjës. Është lançuar një master-plan për arsimin e lartë që mbulon periudhën deri në vitin 2016. Janë marrë një sërë masash për reformën në trajnimin e mësuesve në universitete dhe rritjen e financimit të kërkimit shkencor, në lidhje me mësimin dhe mësimdhënien. Shqipëria po merr masa për të forcuar drejtimin, menaxhimin dhe qeverisjen në sistemin e arsimimit, përmirësimin e kushteve të mësimin dhe mësimdhënies, përmirësimin dhe racionalizimin e infrastrukturës së arsimit, si dhe për të hapur rrugën për reformën në arsimin e lartë.

Shqipëria është duke ngritur një kuadër për kualifikimet në linjë me kuadrin evropian të kualifikimeve. Agjencia kombëtare për trajnimin e arsimit profesional ka filluar punën. Ajo është përgjegjëse për standardet, kualifikimet, akreditimin, vlerësimin, kurrikulën dhe trajnimin e mësuesve. Po zhvillohet një strukturë më fleksibël për Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP). Po bëhet përpjekje për të përfshirë më tepër partnerë socialë në AFP, meqenëse ata duken të jenë ndërgjegjësuar për të luajtur një rol aktiv me qëllim përfundimtar të një force pune të kualifikuar. Është lançuar një iniciativë për zhvillimin e AFP pas shkollës së mesme dhe të lartë për ngritjen e një akademie të arsimit profesional në Universitetin e Durrësit duke pasur parasysh nevojat e ekonomisë kombëtare.



Megjithatë, në dallim me objektivat e BE-së për një të mësuar gjithë-jetën normat e regjistrimit vazhdojnë të jenë të ulta. Kjo në veçanti në nivelin e dytë si dhe midis fëmijëve në zonat rurale dhe tek vajzat. Përqindjet e braktisjes së shkollës në vitet e fundit të arsimit bazë janë të larta. Nivelet e ulta të aftësive pengojnë investimet dhe zhvillimin e industrive të produkteve me vlera të shtuara. Kërkohen përpjekje të vazhdueshme për të plotësuar objektivin e qeverisë për rritjen e përqindjeve të regjistrimit në shkollat profesionale nga 17% në 40% gjatë vitit 2009. Në fushën e arsimit të lartë, kërkohen përpjekje të mëtejshme për të rritur pjesëmarrjen në programin Tempus. Përgatitjet e Shqipërisë në këtë fushë po avancojnë në mënyrë të moderuar.

Ka progres të pakët në fushën e **kërkimit shkencor**. Shqipëria ka protokolle dypalëshe me Italinë, Greqinë, Republikën ish-jugosllave të Maqedonisë, Slloveninë dhe Turqinë për bashkëpunimin teknik dhe shkencor. Janë zhvilluar disa aktivitete për të siguruar familjarizimin me Programin Kuadër Shtatë (FP7), si mbledhjet me koordinatorët në universitetet lokale dhe institucionet shkencore si dhe ngritja e rrjetit të pikave të kontaktit. Shqipëria ka kërkuar të lidhet me FP7 (Programin Kuadër Shtatë) por procedurat e atashimit nuk kanë përfunduar ende. Përgatitjet në këtë fushë janë në një fazë fillestare.

#### 4.1.10. Çështje të OBT-së

Shqipëria është anëtare e OBT që nga viti 2000. Në 2007, Shqipëria ka vazhduar të zbatojë detyrimet e saj përkatëse me OBT. Megjithatë, Sektori i Marrëdhënieve me OBT dhe Bashkëpunimin Ekonomik në Ministrinë e Ekonomisë, i cili vepron si Sekretariat për çështjet e OBT-së, nuk është forcuar dhe nuk janë vënë re ndryshime në lidhje me kapacitetet e Shqipërisë për politikë-bërjen e tregtisë.

## 4.2. Politikat sektoriale

### 4.2.1 Industria dhe SME-të

Disa përparime mund të shënohen në fushën e klimës së biznesit për industrinë dhe SME-të. Kompanitë janë në gjendje të përdorin një numër identifikimi unik për marrëdhëniet e tyre me degët e ndryshme të administratës publike. Qeveria ka miratuar legjislacionin për ngritjen e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit (QKR). Legjislacioni i ri e ndryshon regjistrimin e biznesit nga një procedurë gjyqësore administrative në një proces administrativ të thjeshtuar. QKR, e cila u bë operative në 2007, vepron si one-stop-shop duke synuar të mundësojë regjistrimin e një biznesi në një ditë të vetme. Ajo ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me Drejtorinë e Përgjithshme të tatimeve për të thjeshtuar procedurat e regjistrimit tatimor. Regjistrimi i biznesit është gjithashtu i mundshëm në degët e QKR-se në 29 bashki.

Qeveria ka miratuar një strategji afat-mesme për 2007-2009 për të promovuar konkurrueshmërinë e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME-të). Strategjia kërkon të promovojë kulturën e sipërmarrjes, të përmirësojë klimën e biznesit, të rrisë konkurrueshmërinë dhe të përmirësojë financat e SME-ve.

Agjencia Albinvest, përgjegjëse për promovimin e SME-ve, eksporti dhe FDI (Investimi Direkt i Huaj), janë aktive në marketing për investimet e huaja dhe sigurojnë mbështetje për biznesin, duke përfshirë përgatitjen e studimeve për zonat potenciale të eksportit. Agjencia ka 36 punonjës dhe është forcuar më tej me ngritjen e një departamenti të ri për të menaxhuar fondet e garancisë për eksportin e 200 milion lek shqiptare (përafërsisht 1.6 milion euro) të krijuara nga qeveria. Fondi synon të ndihmojë financimin e eksporteve me anë të huave nga bankat tregtare të huaja dhe lokale për ndërmarrjet, të kombinuar me ndarjet e risqeve tregtare.

Janë bërë disa përparime në fushën e financimit të SME-ve. Qeveria ka krijuar një fond konkurrueshmërie prej 200 000 euro të menaxhuara nga Albinvest. Fondi funksionon si një skemë grant me ndarje-kostosh për të ndihmuar zhvillimin e bizneseve. Ai ka miratuar dhjetë aplikime për financim. Shqipëria ka një regjim specifik tatimor për kompanitë e vogla. Kontributet sociale janë ulur nga 30% në 21% dhe janë të prirur të ulen më tej në janar të 2008. Hapa janë marrë për të ulur informalitetin, si projekt ligji që përcakton paga referuese për bizneset private dhe zhvillimi i një metodologjie për standardet e punës për të luftuar mosdeklarimin e krahut të punës në disa aktivitete industriale.

Megjithatë, progresi konkret në trajtimin e ekonomisë informate, mbetet i ulët. Progresi në zbatimin e Kartës Evropiane për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme ka qenë i ngadaltë dhe masat për përmirësimin e klimës së biznesit për ndërmarrjet e vogla, ka qenë i vonuar. Për sa i përket, financimit të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, kredia prej 30 milion EUR e rënë dakord ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë, ende nuk është implementuar. Lënda e sipërmarrjes ende nuk është futur në programin shkollor arsimor dhe të shkollave profesionale. Kapacitet e QKR-së duhet të fuqizohen. Ambientet e përshtatshme dhe burimet e duhura financiare dhe njerëzore janë esenciale. Regjistrimi i shoqërive vazhdon të jetë burokratik dhe i lodhshëm. Shërbimet e regjistrimit *on-line* dhe parimi 'heshtja është miratim' ende nuk është implementuar. Edhe pse Shqipëria ka bërë disa hapa përpara në avokatinë e biznesit dhe përfaqësimin e bizneseve me anë të reformimit të legjislacionit për Dhomat e Tregtisë dhe duke ngritur Këshillin Konsultativ të Biznesit, pjesëmarrja e biznesit në proceset legjislative dhe në grupime, mbetet e kufizuar.

Shqipëria duhet të hartojë strategji që veprojnë si incentive (nxitës) që bizneset të hyjnë në sektorin formal. Nevojitet një qasje më aktive dhe më novatore për zhvillimin e klasterave dhe mekanizmave të transferimit të teknologjisë për SME-të. Strategjitë për inkubatorët e biznesit nuk janë shumë të avancuara. Bizneset informale mbeten tepër të përhapura, çka pengon konkurrencën e ndershme dhe shkakton efekte negative në klimën e biznesit. Organet e arbitrazhit dhe apelit për komunitetin e biznesit, janë joefikase dhe të hapura ndaj korrupsionit.

Përgatitjet në fushën e politikës industriale dhe SME-ve po avancojnë gradualisht.

#### 4.2.2. *Bujqësia dhe peshkimi*

Progres i kufizuar është shënuar në **zhvillimin bujqësor dhe rural**. Pagesa direkte për zonë janë introduktuar për verën, ullirin dhe kultivimin e frutave, që shërbyen si incentive për rritjen e prodhimit. Sistemi bujqësor i zgjerimit dhe kërkimit shkencor është në shqyrtim për ta përshtatur me prioritetet e politikave. Në fushën e fermave organike, progres është vënë re në harmonizimin e legjislacionit shqiptar me atë Komunitar, megjithatë sfidë mbetet fuqizimi i institucioneve publike përkatëse dhe zbatimi efikas.

Pengesa të ndryshme si thellimi i fragmentarizmit të fermave të vogla, çmimi i lartë i tokës, i cili e bën blerjen e tokës për qëllime bujqësore jotërheqëse, mungesa e arsimit të përshtatshëm të operatorëve të fermave për zbatimin e teknikave të përmirësuara të prodhimit, si dhe marketingu i pazhvilluar, të gjitha vazhdojnë të mos e lejojnë sektorin bujqësor të jetë konkurrues dhe të plotësojë kërkesën në rritje për produkte ushqimore. Veprimtaria bujqësore e orientuar drejt eksportit mundet, gjithsesi, të rrisë prodhueshmërinë dhe tregtinë në disa sektorë.

Strategjia Sektoriale e Bujqësisë dhe Ushqimit 2007-2013 u adresohet këtyre shqetësimeve. Ky dokument pason shumicën e prioritetëve të periudhës 2004-2006 (veçanërisht në konkurrencën në rritje dhe diversifikimin e aktiviteteve ekonomike në zonat rurale), por gjithashtu edhe disa të reja, si përcaktimi i

qartë i nënsektorëve strategjikë dhe rritjes së buxhetit të qeverisë për bujqësinë. Megjithatë, strategjia, si strategjia e zhvillimit rural, nuk është miratuar ende.

Disponibiliteti i kredive për investime në bujqësi dhe përfshirja sistematike e grupeve të interesit në politikë-bërje, janë elemente kyç të nevojshme për zbatimin e qëndrueshëm të strategjisë së planifikuar. Përgjithësisht, konkurrueshmëria e sektorit bujqësor ka nevojë të fuqizohet. Përgatitjet në fushën e bujqësisë mbeten në fazë fillestare.

Progres i paktë është bërë në fushën e **sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe politikës fito-sanitare**. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit ka një inventar të pjesës së *acquis* që Shqipëria planifikon ta harmonizojë në legjislacionin e saj. Ministria nxori mbi 20 udhëzime dhe urdhra në fushën e shëndetit të kafshëve. Megjithatë, për sa i përket kontrollit të sëmundjeve të kafshëve, shkalla e zbatimit është e paqartë. Iniciativa të ndryshme kanë ngritur ose përmirësuar kapacitetet në lidhje me postat e inspektimit veterinar, fitosanitar dhe kufitar, si edhe programet e monitorimit të laboratorëve dhe molusqeve. Në 2006, Këshilli i Ministrave miratoi një Vendim për sistemin e identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve të fermave, si edhe të lëvizjes së tyre. Sidoqoftë, për gjedhët, vetëm disa rrethe janë mbuluar, duke ulur ndjeshëm vlerën dhe benefitet e sistemit. Kjo pengon efikasitetin e masave të ndërmarra për eliminimin e brucelozës që është përhapur në disa zona.

Numri i pamjaftueshëm i stafit dhe mungesa e burimeve financiare kufizojnë kapacitetet e Ministrisë së Bujqësisë, ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për përmirësimin e sigurisë ushqimore. Kapacitetet e Ministrisë për përgatitjet për zbatimin e standardeve evropiane si dhe të masave të veta, mbetet e dobët..

Nuk është arritur progres specifik në sipërmarrjet e përpunimit ushqimor. Sistemet e kontrollit për molusqet bivalvul nuk janë ekuivalente me sistemin Komunitar. Kjo kufizon mundësitë eksportuese të Shqipërisë. Shqipëria ende nuk ka kapacitetet laboratorike të nevojshme për përmbushjen e kërkesave për eksportimin e peshkut dhe nënprodukteve të peshkut drejt BE-së. Garanci specifike për histaminën do të kërkohej për çdo ngarkesë të specieve të caktuara të destinuara për tregun e BE-së. Përgatitjet në fushën e sigurisë ushqimore, veterinare dhe fitosanitare, janë në fazë fillestare.

Disa përparime janë bërë në fushën e **peshkimit**. Po përmirësohen veçanërisht ekzekutimi i ligjit dhe inspektimet në terren. Një rritje në numrin e stafit të inspektorëve lejon kryerjen e kontrolleve më të shpeshta. Sidoqoftë, masat për të parandaluar shfrytëzimin e tepruar dhe peshkimin e paligjshëm duhen forcuar, sidomos për sa i përket licencimit dhe kontrolleve. Përgatitjet në fushën e peshkimit janë në fazë fillestare.

#### 4.2.3. *Mjedisi*

Disa përparime janë arritur në fushën e **legjislacionit horizontal**. Pjesa e parë e metodologjisë për Vlerësimin e Impaktit në Mjedis(EIA)/Vlerësimi Strategjik Mjedisor (SEA), që mbulon vlerësimin fillestar të impaktit mjedisor, është miratuar. Një ligj për mbrojtjen mjedisore tejkuftare që transponon disa dispozita të Konventave Espoo dhe Aarhus, është miratuar. Zbatimi i detyrimeve sipas Konventës së Aarhusit, është përmirësuar. Shqipëria ratifikoi Protokollin e Kijotos në 2005, por nuk janë shënuar hapa të mëtjshëm në këtë drejtim. Ligji kombëtar për Mjedisin, ende nuk është amenduar. Zbatimi i legjislacionit ekzistues për EIA ka nevojë për përmirësim. Përgatitjet kanë filluar në fushën e legjislacionit horizontal.

Progres i kufizuar është shënuar në **cilësinë e ajrit** në zonat urbane. Është përmirësuar lehtësisht për shkak të reduktimit të shkarkimeve nga automjetet dhe nga disa fabrika të mëdha në zonën e Elbasanit. Këshilli i Ministrave ka miratuar një vendim për cilësinë e karburanteve ku janë reflektuar disa standarde evropiane. Janë ngritur edhe dy stacione monitorimi dhe janë siguruar disa pajisje. Këto kontribuojnë në zhvillimin e rrjetit monitorues dhe në përmirësimin e mbledhjes së të dhënave të sakta për ndotjen e ajrit. Megjithatë, përpjekjet e mëtejshme në këtë fushë mbeten të nevojshme pasi Shqipëria është vetëm në fazat fillestare për sa i përket monitorimit të cilësisë së ajrit.

Progres i paktë është shënuar në fushën e **administrimit të mbetjeve**. Janë përgatitur aktet zbatuese të ligjit për administrimin e mbetjeve të rrezikshme. Puna po vazhdon për rehabilitimin e landfillit të Sharrës në bashkinë e Tiranës dhe në impiantin e trajtimit të ujërave industriale të Rafinerisë së Naftës në Ballsh. Një projekt për vlerësimin e impaktit mjedisor të fushës së naftës Patos-Marinez filloi në prill 2007. Megjithatë, asgjësimi në vend i mbetjeve të rrezikshme dhe materialeve kontaminuese në impiantin e Fierit dhe në atë të Shkrires së Bakrit në Rubik, ende nuk ka filluar. Vazhdojnë të ekzistojnë disa 'vatra të nxehta' të vogla. Një inventar i saktë i të gjitha 'vatrave të nxehta' shoqëruar me vlerësimin e impaktit mjedisor, është i nevojshëm para se të planifikohen ndërhyrje të reja. Bashkive u mungon një strategji e qartë për hedhjen e mbetjeve të ngurta. Hedhjet dhe djegiet e pakontrolluara të mjeteve vazhdojnë të paraqesin rreziqe për mjedisin dhe shëndetin. Përgatitjet në menaxhimin e mbetjeve nuk kanë avancuar shumë.

Nuk ka zhvillime për të raportuar mbi **ndotjen industriale** dhe **menaxhimin e riskut**.

Progres i pakët është bërë në **cilësinë e ajrit**. Gjatë 2006-ës, një program për monitorimin me etapa u krye në 54 ujësjellës. Megjithatë, objektivat e Strategjisë për Sektorin e Ujësjellësve dhe Kanalizimeve (2003) nuk janë realizuar. Furnizimi me ujë dhe kanalizimi i ujërave të zeza/industriale mbetet problematik, veçanërisht në zonat bregdetare. Ka akoma ndotje të konsiderueshme të ujit nga aktivitetet industriale, sidomos nga ato të nxjerrjes së naftës. Sistemi i ujësjellësve dhe kanalizimeve mbetet i vjetëruar. Nevojitet një strategji gjithëpërfshirëse për menaxhimin e ujit, përfshirë përafrimin me standardet ligjore evropiane, ku të përcaktohen nevojat për investime dhe të përmirësohen kapacitetet për menaxhimin e çështjeve të ujit të pijshëm dhe ujërave të zeza. Përgatitjet në këtë fushë janë në fazë fillestare.

Disa përparime janë shënuar në fushën e **mbrojtjes së natyrës**. Zonat e mbrojtura tashmë zënë rreth 10% të të gjithë territorit kombëtar. Megjithatë, duhet të vendosen indekse të përshtatshme për speciet. Nuk po merren masa kontrolli për prerjen e paligjshme të pyjeve dhe gjuetinë e paligjshme. Trajnim dhe burime të mjaftueshme duhet t'u akordohen punonjësve që operojnë në këto fusha. Ka vazhduar përafrimi me direktivat e Zogjve të Egër dhe Habitatit, por përpjekje të mëtejshme kërkohen në këtë fushë. Transpozimi i *acquis* për zogjtë e egër siç kërkohet nga Neni 16 i Traktatit të Komunitetit të Energjisë, mbetet për t'u realizuar.

Progres i kufizuar është arritur në fushat e **kimikateve** dhe **organizmave të modifikuar gjenetiksht (OMGj)**. Këshilli i Ministrave miratoi një plan veprimi për eliminimin e substancave organike që shkaktojnë ndotje të përhershme (POP) dhe ia dorëzoi Sekretariatit të Konventës së Stokholmit. Dispozitat për OMGj-të janë përfshirë në projektligjin për bio-sigurinë, i cili ende nuk është miratuar nga qeveria. Shqipëria është në fazë fillestare në këto fusha.

Në fushën e **zhurmës**, është miratuar legjislacion, por përgatitjet janë në fazë fillestare.

Për sa i përket **kapaciteteve administrative**, objektivi kryesor ngelet forcimi i politikë-bërjes mjedisore dhe sektoriale, si edhe zbatimi në terren i politikave për fushat nën përgjegjësinë e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave. Duhet të përcaktohen mirë përgjegjësitë e organeve të tjera që merren me mjedisin. Bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Mjedisit me ministrinë e tjera dhe pushtetin vendor, ka nevojë të përmirësohet.

Qeveria e ka përqaftuar parimin “ndotësi paguan”<sup>10</sup> por legjislacioni aktual nuk e lejon zbatimin në praktikë të këtij koncepti. Shkalla e arkëtimit të gjobave është shumë e ulët (15%) dhe inspektorëve të mjedisit u mungojnë burimet e duhura për kryerjen e detyrave që u takojnë.

Strategjia Kombëtare për Mjedisin – një dokument gjithëpërfshirës që ka gëzuar përfshirjen e gjerë dhe pranimin e saj nga ana e grupeve të interesit – ka mbetur në formë drafti dhe po pret të përfshihet në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim . Përpjekje të mëtejshme nevojiten në këtë fushë.

Shqipëria ka bërë disa përparime në përafrimin e legjislacionit mjedisor me standardet e BE-së. Megjithatë, vërehet prirja për të përqendruar përpjekjet në miratimin e ligjeve të reja, e për pasojë, zbatimi i legjislacionit ekzistues po ngelet pas. Përpjekje të mëtejshme nevojiten drejt ratifikimit dhe zbatimit të konventave ndërkombëtare. Kapacitetet administrative të organeve përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit duhet të forcohen dhe të përmirësohet bashkërendimi i punës mes tyre.

#### 4.2.4. *Politikat e transportit*

Është shënuar progres në fushën e **rrjeteve tej-Evropiane**<sup>11</sup>. Shqipëria merr pjesë aktive në zhvillimin e Rrjetit të Transportit Rajonal dhe të SEETO-s <sup>12</sup> (Observatori i Evropës Juglindore për Transportin) dhe ka miratuar Pesëvjeçarin e dytë të Planit Shumëvjeçar (2007-2011). Kërkohet bashkëpunim i vazhdueshëm në kuadrin e SEETO-s në mënyrë që të përmirësohet përcaktimi dhe zbatimi i prioritetëve rajonale dhe bashkërendimi i investimeve. Veçanërisht, Shqipëria duhet t’i japë SEETO-s informacione të besueshme për projektet dhe të dhënat e plota për trafikun dhe transportin në rrjetin e transportit rajonal. Zbatimi i projekteve të mëdha duhet të përmirësohet, përfshi këtu sigurimin e kapaciteteve të duhura administrative.

Progres i kufizuar është bërë në **transportin rrugor**. Shqipëria pranoi t’i japë akses të pakufizuar në territorin e saj trafikut tranzit Komunitar. Shqipëria ratifikoi marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e transportit rrugor: Marrëveshja Evropiane për punën e ekuipazheve të mjeteve të angazhuara në trafikun rrugor ndërkombëtar, 1970; Konventën për kontratat për transportin ndërkombëtar të mallrave në rrugë tokësore, 1956; Marrëveshjen Evropiane për arteriet kryesore të trafikut ndërkombëtar, 1957, si dhe protokollin e marrëveshjes për transportin ndërkombëtar të mallrave në rrugë tokësore, 1978.

Në shtator 2007 u miratuan amendimet në Kodin Rrugor që kishin për synim përafrimin me *acquis* për sa i përket inspektimit të mjeteve, peshat dhe matjet, si dhe licencat e drejtimit. Megjithatë, mbetet për t’u verifikuar përputhja me standardet korresponduese të BE-së. Ristrukturimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve në një agjenci që kontraktonte ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve nga ana e shoqërive private,

<sup>10</sup> polluter pays

<sup>11</sup> trans-European networks

<sup>12</sup> South East Europe Transport Observatory

është në pritje të miratimit. Cilësia e mirëmbajtjes së rrugëve mbetet e dobët, ndërsa prioritizimi dhe evidentimi i ndërhyrjeve mirëmbajtëse nuk ndjekin një plan të qartë veprimi. Siguria rrugore mbetet një problem serioz për shkak të kushteve të dobëta të rrugëve, sinjalistikës së mangët, ndërtimeve të paligjshme buzë rrugëve të reja, dhe nivelit të kufizuar të edukimit profesional që kanë shoferët. Zbatimi i programit të menaxhimit të aseteve-urë, po vazhdon por ende nuk ka përfunduar. Kërkohet më tepër thjeshtim i trafikut të transportit të mallrave në rrugë tokësore, si për trafikun kombëtar edhe atë tranzit. Përgatitjet në fushën e transportit rrugor po ngelen pas.

Progresi për sa i përket **transportit hekurudhor** ka qenë i kufizuar. Buxheti i Shtetit për 2007 parashikonte afërsisht 2.3 milion EUR për hekurudhat, shumë që të përdoret për mirëmbajtjen e shinave dhe binarëve ekzistues. Sektori hekurudhor ka vazhduar të përkeqësohet për shkak të kushteve tejet të këqija të binarëve dhe shinave. Është hartuar një Plan 5-vjeçar Biznesi për Hekurudhën Shqiptare, por ende nuk është miratuar. Përgatitjet në fushën e transportit hekurudhor po ngelen pas.

Në sektorin e **transportit ajror** janë bërë disa përparime. Shqipëria ratifikoi Marrëveshjen e Zonës së Përbashkët të Aviacionit (ECAA) dhe mori përsipër që gradualisht të integrohet në tregun e brendshëm të aviacionit të BE-së dhe të aplikojë standardet e aviacionit që ka BE. Ndërtimi i infrastrukturës së re në Aeroportin e Tiranës përfundoi në mesin e marsit 2007. Zbatimi i fazës së parë tranzitore - i pjesës së *acquis* që mbulon aviacionin – është në proces por nevojiten përpjekje të mëtejshme, sidomos në fushën e sigurisë dhe sigurimit të aviacionit, si dhe menaxhimit e trafikut ajror. Forcimi i kapaciteteve administrative të institucioneve shqiptare në fushën e transportit ajror, është akoma e paplotë. Puna për projektin e ri të Kodit Ajror është në proces, por mbetet për t'u verifikuar harmonizimi me *acquis* dhe angazhimet e Shqipërisë në kuadrin e ECAA-s. Shqipëria duhet të vërë në zbatim planin e veprimit që adreson deficiencat e evidentuara brenda Autoritetit të Aviacionit Civil për sa i përket mbikëqyrjes së standardeve të sigurisë në kompanitë ajrore në Shqipëri. Përgatitjet në fushën e transportit ajror mbeten në fazë fillestare.

Përparim i kufizuar është shënuar në fushën e **transportit detar**. Shqipëria ka ratifikuar Konventën Detare ndërkombëtare MARPOL 73/78 si dhe Konventën Detare të OKB-së për Transportin e Mallrave. Përditësimi i masterplanit të Portit të Durrësit filloi në qershor 2007. Ky Plan do të shërbejë si kornizë për zhvillimin e përgjithshëm të porteve shqiptare, në përputhje me rekomandimet e Planit Kombëtar të Transportit. Përpjekje thelbësore nevojiten për përmirësimin e sigurisë detare, përfshi këtu instancat shtetërore të Kontrollit Portual. Me rritjen e shkallës së bllokimit të anijeve<sup>13</sup> në 29.9% në 2006, flamuri Shqiptar është i dyti më i keq në listën e zezë të qershorit 2007 të Memorandumit të Mirëkuptimit të Parisit, dhe cilësohet si “risk tepër i lartë”. Njëkohësisht, performanca e Regjistrit Shqiptar Detar<sup>14</sup> cilësohet si shumë e ulët. Përpjekje të konsiderueshme kërkohen në këtë fushë. Përgatitjet në fushën e transportit detar po ngelen pas.

#### 4.2.5 Energjia

Për sa i përket stokut të naftës, nuk është bërë asnjë progres.

Shqipëria ka filluar të marrë disa masa në përmirësimin e sigurisë së **furnizimit me energji**. Kontrata për ndërtimin e një TEC-it të ri në Vlorë është firmosur. Shqipëria ka miratuar një ligj për koncesionet për të zhvilluar ndërtimet private dhe operacionet e impianteve të vegjël hidro-elektrike. Parlamenti ka

<sup>13</sup> detention rate

<sup>14</sup> Albanian Register of Shipping

ratifikuar konventën me Bullgarinë dhe ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë për ndërtimin e tubacionit (AMBO) për transportimin e naftës nga Deti i Zi në portin e Vlorës. Janë planifikuar projekte për të rritur më tej kapacitetet prodhuese të energjisë dhe të interkonjeksionit.

Megjithatë, Shqipëria nuk ka arritur të garantojë siguri të furnizimit me energji elektrike. Ajo akoma mbetet tepër e varur nga hidrocentralet dhe vazhdon të vuajë probleme serioze në furnizimin me energji. Prodhimi i brendshëm i pamjaftueshëm dhe kapacitetet e kufizuara të interkonjeksionit për import e bënë të pamundur përballimin e kërkesës për energji. Kjo çoi në ndërprerje të zgjatura dhe të shpeshta të energjisë. Lidhjet e paligjshme dhe humbja e energjisë për shkak të mangësive teknike në rrjetin e transmetimit, janë akoma të larta dhe përbëjnë një problem strukturor i cili duhet të adresohet me vendosmëri. Përpjekje të mëtejshme nevojiten në mënyrë që të përmirësohen arkëtimet dhe për të pajisur konsumatorët me matës energjie. Importet në shkallë të gjerë të energjisë shtrënguan pozitat financiare të KESH-it. Strategjia Kombëtare e Energjisë, e rishikuar, mbetet për t'u miratuar.

Shqipëria ka bërë disa përpertime në fushën e **tregut të brendshëm të energjisë**. Shqipëria ka ratifikuar Traktatin e Komunitetit të Energjisë dhe rrjedhimisht mori përsipër të zbatojë *acquis* përkatës që nga korriku 2007, me përjashtim të dispozitave që lidhen me hapjen e tregut për të cilat aplikohet një kalendar specifik. Një model i ri tregu u miratua në shtator 2007, por përputhshmëria e tij me kërkesat e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, mbetet për t'u konfirmuar. Disa përpertime janë bërë në sektorin e elektricitetit për sa i takon monitorimit të sigurisë së furnizimit, rregullave teknike dhe aksesit të palëve të treta. Një politikë me norma të reja tarifore u fut në tregun e brendshëm të energjisë. Normat për familjet u rritën ndërsa normat për bizneset u ulën në mënyrë që të reduktohet shtrembërimi i shkaktuar nga ndër-subvencionimi i dy kategorive të konsumatorëve dhe për të rritur pagimin e faturave. Ka filluar procesi i reformimit të KESH-it, që përfshin ndarjen e shoqërisë në tre subjekte të pavarura. Operatori i Sistemit të Transmetimit është ndarë ligjërisht dhe financiarisht, edhe pse përcaktimi i aseteve dhe përgjegjësive ligjore nuk është finalizuar akoma. Qeveria ka nisur përgatitjet për privatizimin e seksionit shpërndarës të KESH-it. Megjithatë, vetëm dy shoqërive u është dhënë statusi i Klientit të Ligjshëm. Hapja e tregut të energjisë elektrike është në fazë fillestare (*shiko edhe seksionin ekonomik*).

Zbatimi i Ligjit për **efikasitetin e energjisë** i 2005-ës ende nuk ka dhënë rezultate të ndjeshme. Përdorimi i burimeve të rinovueshme të energjisë, mbetet në nivele të ulëta. Asnjë progres nuk është bërë porsa i përket **sigurisë nukleare dhe mbrojtjes nga rrezatimi**. Përpjekje të konsiderueshme nevojiten akoma që Shqipëria të përmbushë kërkesat e Traktatit të Komunitetit të Energjisë në lidhje me transpozimin e *acquis*. Vëmendje e veçantë i duhet kushtuar prodhimit të energjisë, shërbimeve publike dhe mekanizmave të tregtisë ndërkufitare. Përgjithësisht, sektori i energjisë është ende në situatë kritike çka po pengon zhvillimin social dhe ekonomik të vendit.

#### 4.2.6

#### *Shoqëria e informacionit dhe media*

Në fushat e **komunikacioneve elektronike dhe teknologjive të informacioni**, është arritur fare pak progres. Liberalizimi i tregut mbetet në fazë fillestare. Një amendim në Ligjin për telekomunikacionet u miratua në fund të 2006-ës që u lejonte operatorëve të aplikonin për licenca urbane ose rajonale. Legjislacioni zbatues u kompletua në prill 2007. Dispozitat e shërbimeve VoIP janë përfshirë tashmë në ligj, edhe pse Enti Rregullator i Telekomunikacione duhet të specifikojë detajet për aplikim. Autoriteti i Konkurrencës hapi një hetim për abuzim me pozita dominuese nga dy kompanitë celulare dhe vendosi

gjopa për shkelje të rregullave të konkurrencës. TRE vendosi një tarifë interkonjeksiioni pasi operatorët e telefonisë fikse dhe celulare nuk gjetën gjuhën e përbashkët për një marrëveshje.

Qeveria nënshkroi një marrëveshje për privatizimin e 76% të shoqërisë shtetërore Albtelekom pas negociatave të zgjatura me ofertuesin fitimtar nga tenderi i privatizimit në 2005. Parlamenti e ratifikoi kontratën në korrik 2007. "Eagle Mobile", operatori i tretë celular që zotërohet nga Albtelekom, do të fillojë punën pas përfundimit të privatizimit. Kjo pritet të forcojë konkurrencën në tregun e telefonisë celulare.

Tarifat e interkonjeksit bazohen në terminim dhe Enti Rregullator i Telekomunikacioneve ka harmonizuar tarifat kombëtare dhe ndërkombëtare të terminimit për operatorët celularë. Megjithatë, tarifat vazhdojnë të jenë favorizuese për operatorët më të mëdhenj në Shqipëri dhe ka ankesa për mbajtje artificiale të çmimeve të larta. Nuk mund të garantohet zbatimi në praktikë i tarifave pasi janë derdhur jo të gjitha pagesat e interkonjeksionit ndërmjet operatorëve.

Shumë çështje mbeten në fushën e komunikimit elektronik, rrjeteve dhe shërbimeve për të përmirësuar përafrimin e legjislacionit shqiptar me kuadrin e BE-së. Modelet e kostove duhet të zhvillohen për futjen e tarifave bazuar në kosto. Duhet të introduktohen garanci që mbrojnë konkurrencën, siç është portabiliteti i numrit, paraselektimi i rrjetit (carrier) dhe 'aksesi i ndarë në nivelin e rrjetit lokal'<sup>15</sup>. TRE duhet të përmirësojë ekspertizën dhe kapacitetet e saj. Ajo akoma shfaq vështirësi për zbatimin në kohë të legjislacionit ekzistues nëpërmjet masave për rregullimin e tregut. TRE dhe Autoriteti i Konkurrencës tani po marrin një pozicion në favor të rregullimit direkt të tarifave me pakicë të operatorëve celularë. Trajnime specifike duhet të sigurohen për të zhvilluar ekspertizën në gjykata që merren me çështjet rregullatore në këtë fushë.

Për **shërbimet e shoqërisë së informacionit**, nuk është shënuar progres. Legjislacioni për tregtinë elektronike, firmat elektronike dhe akses i kushtëzuar, ende nuk është miratuar. Përgjithësisht, përgatitjet në fushën e shoqërisë së informacionit janë në fazë fillestare.

Progres është arritur në fushën e **politikës audiovizuale**. Këshilli Kombëtar i Radio-Televizionit (KKRT) mori masa rigorozë kundër operatorëve të televizioneve private që transmetonin jashtë zonës së tyre të licencuar. Megjithatë, burimet njerëzore dhe financiare të KKRT-së mbeten të kufizuara krahasuar me detyrat, veçanërisht për sa i përket dhënies së frekuencës, parandalimin e zënies së frekuencave në mënyrë pirate, luftimin e piraterisë së të drejtës së autorit dhe monitorimin e operatorëve transmetues.

KKRT ende nuk ka hartuar një strategji për zhvillimin e sektorit radio-televiziv dhe një plan të përditësuar për rregullimin e frekuencave analoge dhe numerike. Harmonizimi i ligjit për transmetimet me Konventën Evropiane për Televizionin Tejkombëtar dhe Direktivën e Televizionit Pa Kufij mbetet për t'u realizuar (*shiko edhe Liria e shprehjes*).

#### 4.2.7. *Kontrolli financiar*

Progres është arritur në fushën e **Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik**. Qeveria pranoi të përditësojë Strategjinë e Politikave dhe Planin e Veprimt 2005 në dritën e përvojave të fundit si dhe ndryshimet e propozuara në kuadrin ligjor për këtë fushë. Në këtë kontekst, parlamenti miratoi së fundmi një ligj për auditin e brendshëm dhe propozoi futjen e konceptit të kontabilitetit menaxherial në

---

<sup>15</sup> local loop unbundling



një draft të ri të Ligjit organik të Buxhetit. Të dyja janë akoma nën shqyrtim dhe duhet të akordohen me Strategjinë e rishikuar të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, për të garantuar futjen e balancuar të kontabilitetit menaxherial si dhe auditit të brendshëm të decentralizuar dhe funksionalisht të pavarur.

Njësitë ekzistuese të Auditit të Brendshëm kryejnë kryesisht detyra kontrolli dhe inspektimi, çka tregon se profesioni i auditit të brendshëm, i cili duhet të fokusohet te vlerësimi i sistemeve dhe këshillimit është akoma në fazat fare fillestare të zhvillimit.

Për sa i përket audit të jashtëm, si Kushtetuta edhe Ligji për Auditin e Brendshëm nuk janë plotësisht në linjë me udhëzimet e INTOSAI-t (Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditit), sidomos për sa i përket pavarësisë funksionale dhe financiare të institutit suprem të auditit (kontrollit të lartë të shtetit në rastin e Shqipërisë) dhe anëtarëve të tij (kriteret e shkarkimit). Strategjia e Zhvillimit (2009-2013) e Kontrollit të Lartë të Shtetit duhet të përqendrohet më tepër në audite financiare dhe performance, sesa në aktivitete inspektuese. Pavarësia e Kontrollit të Lartë të Shtetit duhet të fuqizohet.

Shqipëria duhet të zhvillojë një shërbim të duhur inspektimi për të luftuar mashtrimin ekonomik dhe për të kuptuar fushën e shtrirjes së funksioneve si audit i brendshëm, audit i jashtëm dhe inspektimi/kontrolli. Përgjithësisht, përgatitjet në fushën e Kontrollit Financiar po avancojnë.

#### 4.2.8. *Statistikat*

Progres është shënuar në fushën e **infrastrukturës statistikore**. Ligji për Statistikat Zyrtare është në përputhje me standardet evropiane. Një plan operimi strategjik, përfshi dispozitat buxhetore, është miratuar nga instituti kombëtar i statistikave, INSTAT. INSTAT nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me dy ofrues të mëdhenj të informacionit statistikor dhe marrëveshje të tjera janë në përgatitje me organet zyrtare përkatëse.

Shumica e **klasifikimeve** statistikore janë vendosur dhe përputhen me standardet e BE-së. Është detyrë e Qendrës Kombëtare të regjistrimit të ngritur në shtator 2007 për të përditësuar regjistrimin statistikor të sipërmarrjeve të 1998-ës. Ky është një zhvillim pozitiv drejt përafrimit të regjistrimit të biznesit me kërkesat e BE-së për sa i përket përmbajtjes dhe mbulimit. Regjistrimi i informacioneve për bujqësinë është planifikuar në fillim të 2009-ës.

Për sa i përket **statistikave sektoriale**, progresi në harmonizimin e standardeve të BE-së, ka qenë i pabarabartë.

Në lidhje me statistikat demografike dhe sociale, studimi i buxhetit familjar dhe studimi i krahut të punës, janë në proces. Të dhënat po përpunohen, por rezultatet ende nuk janë të disponueshme. Të dy studimet janë kryer në përputhje me kërkesat e BE-së dhe do të përmirësojnë statistikave sociale, përfshi statistikave të tregut të punës. Zyra e Gjendjes Civile po kompjuterizon informacionet mbi gjendjen civile të shtetasve nga regjistrat. Duhet të merren masa për të garantuar regjistrimin e të gjitha ngjarjeve demografike. Nevojitet bashkëpunim ndër-institucional për të garantuar përcjelljen e të gjitha të dhënave të INSTAT-i. Regjistrimi i popullsisë që parashikohet të bëhet në 2011 do ta bënte të mundur krijimin e një regjistri popullsie të saktë.

Në fushën e statistikave rajonale, të dhënat mbledhen kryesisht nga burime administrative dhe vetëm në nivel rrethi. Ende nuk është vendosur një klasifikim i krahasueshëm me nivelin 2 të klasifikimit NUTS.

Për sa i përket **statistikave makroekonomike**, të dhënat e PBB-së përpilohen duke përdorur ESA 95 si metodologji bazë. Koha për publikimin e shifrave të para është shkurtuar nga 19 në 11 muaj, dhe progres i mëtejshëm pritet. Indeksi i Çmimeve të Konsumit (CPI) është tashmë në harmonizim të gjerë me kërkesat e BE-së dhe pesha dhe struktura e këtij Indeksi do të rishikohen sapo të nxirren rezultatet e studimit të buxhetit familjar. Shifra Kombëtare tremujore përpilohen për 2001-2006 si shifra paraprake, dhe një grup testimi<sup>16</sup> është ngritur për të parë cilësinë dhe frekuencën e rezultateve. Rezultatet e studimit të buxhetit familjar dhe të studimit të krahut të punës, do të merren parasysh. Mbledhja e të dhënave për Indeksin e Çmimeve të Prodhuesve (PPI) është kryer në linjë me metodologjinë e përmirësuar e cila ndjek kërkesat e BE-së. PPI e re për tremujorin e parë 2007 u publikua në qershor.

Për sa i përket statistikave të biznesit, variabla të reja janë përfshirë në studimet strukturore të biznesit. Sa për statistikën afatshkurtra, përgatitjet po vazhdojnë për të garantuar konsistencën kohore të mbledhjes së të dhënave dhe qëndrueshmërinë e një skeme të re kontabiliteti për sipërmarrjet.

Në lidhje me statistikën bujqësore, pyetësi për studimet vjetore është përmirësuar dhe me INSTAT-in po vazhdon diskutimi për harmonizimin e metodologjisë që përdor Ministria e Bujqësisë. Pyetësi i përmirësuar për Studimin e Strukturave Fermere në 2007 është në linjë me kërkesat e BE-së. Një regjistrim i të dhënave të bujqësisë pritet të mbahet në tremujorin e parë të 2009-ës, dhe mbi atë bazë mund të ngrihet një Regjistër Fermer i duhur.

Prirja pozitive për sa i përket **statistikave të tregtisë me jashtë** është konfirmuar. Ka bashkëpunim të mirë ndërmjet administratës doganore dhe INSTAT-it.

Programi 5-vjeçar statistikor 2007-2011 është përgatitur duke marrë parasysh kërkesat e MSA-së dhe pjesës së *acquis* për statistikën. Aty përcaktohen prioritetet afatshkurtër dhe afatmesme në fushën e statistikave dhe, për herë të parë, përfshin monitorimin e zbatimit. Megjithatë, ky program nuk është adoptuar akoma.

Sistemi statistikor shqiptar po ecën drejt harmonizimit me standardet e BE-së. Përmirësime janë të nevojshme në fushat e statistikave makroekonomike dhe bujqësore. Burime të reja të dhënash duhet të zhvillohen me qëllim që të përmirësohet cilësia e PBB-së dhe për ta përpiluar PBB-në sipas tipit të shpenzimeve finale, për të përdorur tabela dhe për të përmirësuar cilësinë e vlerësimeve 3-mujore të PBB-së. Duhet të krijohet një regjistër kombëtar i popullsisë dhe një regjistër fermer<sup>17</sup>. INSTAT-it duhet t'i sigurohen burimet e mjaftueshme financiare dhe njerëzore në mënyrë që të garantohet cilësia e punës statistikore. Lëvizjet e shumta të personelit kërkojnë vëmendje të veçantë, dhe përmirësime nevojiten në lidhje me ambientet e zyrave. Përgatitjet në fushën e statistikave po avancojnë.

### 4.3. Drejtësia, liria dhe siguria

#### 4.3.1. Vizat, kontrolli kufitar, azili dhe migrimi

Ka pasur disa përparime në menaxhimin e **vizave**. Një sistem IT i centralizuar për të administruar vizat është duke u instaluar. Përsa i përket sigurisë së dokumenteve, janë miratuar specifikimet

---

<sup>16</sup> User group

<sup>17</sup> farm register

teknike për pasaportat e reja biometrike me mikroçip dhe për kartat e identitetit, të cilat janë në linjë me standardet e BE-së. Gjithashtu, janë lëshuar pasaporta diplomatike të reja dhe më të sigurta.

Nuk ka pasur ndryshime të mëdha me regjimin e vizave. Shqipëria operon me një regjim pa-viza me të gjithë vendet e BE. Qytetarëve të Serbisë nuk u kërkohet me vizë dhe qytetarëve të Bosnjë-Hercegovinës nga 15 qershor deri në 15 shtator, së bashku me të gjithë turistët që nuk rrinë më shumë se 24 orë. Marrëveshja për lehtësimin e vizave e nënshkruar rishtazi nga Shqipëria dhe BE parashikon tarifa të reduktuara për vizat dhe unifikoi procedurat e përpunimit të vizave. Ende nuk është finalizuar hartimi i amendimeve për ta sjellë ligjin për Të Huajt dhe ligjin për Kontrollin e Kufijve Shtetërorë në një linjë me *acquis communitaire*. Hapat e mëtejshëm drejt liberalizimit të vizave, varen nga zbatimi marrëveshjeve të lehtësimit të vizave dhe të ripranimit, si dhe nga progresi në menaxhimin e kufijve, sigurinë e dokumenteve të udhëtimit dhe luftën kundër krimit të organizuar. Nisur nga numri i kufizuar i konsullatave të Shqipërisë jashtë shtetit, dhe në veçanti, mungesa e një konsullate në disa rajone, duhen masa për të shmangur dhënien e vizave në kufi. Përgjithësisht, Shqipëria po avancohet në mënyrë të moderuar në menaxhimin e vizave.

Shqipëria ka bërë progres në fushën e **kontrollit kufitar**. Qeveria ka miratuar një strategji dhe plan veprimi kombëtar për menaxhimin e integruar të kufijve, të cilët plotësojnë kushtet e BE-së. Infrastruktura e re në 15 pikë-kalimet kryesore (BCP) po përmirëson kontrollin e kufijve. Bashkëpunimi ndërmjet agjencive është përmirësuar vazhdimisht në pikë-kalimet kryesore dhe në nivel qendror. Ligji i ri mbi organizimin e Policisë (*shiko pjesën politike - Qeveria dhe policia*) parashikon përmirësime në strukturën e kufijve dhe policisë së migrimit. Kjo do të ndihmojë edhe në përmirësimin e koordinimit me agjenci të tjera shtetërore.

Ministria e Brendshme dhe Ministria e Punëve të Jashtme janë duke zbatuar sistemin e menaxhimit total të informacionit (TIMS) për të koordinuar kontrollin në të gjitha pikë-kalimet. Hapja e një terminali të ri në aeroportin ndërkombëtar të Tiranës ka përmirësuar standardet e kontrollit kufitar atje. Terminali i ri ka një laborator të vogël të policisë kufitare që disponon mjete për të diktuar dokumentet e falsifikuara.

Bashkëpunimi ndërkufitar policor me fqinjët e Shqipërisë është i mirë dhe duke u fuqizuar. Shqipëria, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi dhe Kosova (nën rezolutën 1244) kanë hartuar bashkërisht një marrëveshje për bashkëpunimin e policisë kufitare. Marrëveshja do të formalizojë bashkëpunimin aktual procedural ndërmjet vendeve nënshkruese dhe lejon nënshkrimin e protokolleve dypalëshe specifike. Është ratifikuar një marrëveshje me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë për patrullimin e përbashkët kufitar. Me Italinë u nënshkrua një marrëveshje për shkëmbim informacioni. Po vazhdon shkëmbimi sistematik i informacioni dhe patrullimi i përbashkët i kufijve të gjelbër (tokësorë), ndërmjet policisë kufitare shqiptare dhe asaj greke.

Megjithatë, investime dhe punë e konsiderueshme kërkohen të gjitha pikë-kalimet kufitare të jenë konform standardeve evropiane. Është thelbësor zbatimi i duhur i strategjisë të menaxhimit të integruar të kufijve. Duhet të shtohet trajnimi për kontrollin kufitar. Mbikëqyrja e kufirit detar mbetet e dobët. Situata në portin e Durrësit mbetet kritike. Infrastruktura e dobët dhe trafiku i rënduar në port, e vështirësojnë jashtëzakonisht punën e policisë kufitare. Porti i Vlorës gjithashtu vuan nga infrastruktura e dobët. Ende pritet një zgjidhje që të mundësojë komandën civile të rojës bregdetare shqiptare, në linjë me angazhimet e Ohrit.

Përdorimi i anijeve detare me personel të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Mbrojtjes në bord nën komandën civile, ka qenë deri tani zgjidhja më racionale dhe më efektive në kosto. Shkurtimet e stafit në policinë kufitare dhe atë të migrimit, po kufizojnë efektet e përmirësimeve strukturore.

Përgjithësisht, emigracioni ilegal, kryesisht nga emigrantë ekonomikë, mbetet problem, sidomos në kufirin e gjelbër shqiptaro-grek. Shqipëria ka arritur pjesërisht objektivat e saj në fushën e kontrollit kufitar.

Progres të kufizuar ka pasur në çështjet e **azilit**. Kuadri legjislativ për azilin i përmbahet standardeve ndërkombëtare, dhe azilit-kërkuesit dhe refugjatët janë pajisur me dokumentacionin e nevojshëm.

Megjithatë, nuk ka një strategji të vetme koherente për azilin. Progresi në rishikimin dhe amendimin e kuadrit ligjor për azilin ka qenë i ngadaltë. Nevojiten akte nënligjore për zbatimin e Ligjit të 2003-shtit për integrimin lokal dhe bashkimin familjar, në veçanti për të lejuar zhvillimin e një sistemi për integrimin lokal të refugjatëve. Regjimi mbrojtës i Shqipërisë për personat që iu është dhënë azil mbetet i dobët, veçanërisht në aspektet juridike.

Ndryshimet e stafit si rezultat i ristrukturimit të Drejtorisë për Refugjatët dhe Kombësitë kanë vazhduar të ulin kapacitetet dhe të vonojnë vendimmarrjen. Kapacitetet e reduktuara çuan në mangësi në zbatimin e planit të veprimit për azilin dhe për menaxhimin e çështjeve të azilit. Kërkohet trajnim i mëtejshëm. Koordinimi me sistemin kombëtar të migrimit është në një fazë fillestare. Kërkohet koordinim më i mirë me policinë kufitare në mënyrë që sistemi para-skannues (*pre-screening*) të zbatohet siç duhet. Ekspertiza e stafit që punon në qendrat e reja të azilit, mbetet e dobët. Impakti që marrëveshjet e riparimit kanë pasur mbi sistemin e azilit, ende nuk është vlerësuar tamam. Përgjithësisht, Shqipëria i ka realizuar pjesërisht objektivat e saj në fushën e azilit.

Një njësi që koordinon dhe monitoron zbatimin e strategjisë kombëtare për **migrimin** është ngritur në Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale. Shqipëria ratifikoi Konventën Evropiane për Statusin Ligjor të Punëtorëve Migrantë dhe Konventën e OKB-së për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve Migrantë. Janë përgatitur manuale për procedurat në terren të migrimit. Kontrollat e migracionit në pikat e kalimit kufitar janë deri diku më efektive. Është miratuar ligji që rregullon migrimin e qytetarëve shqiptarë për arsye punësimi jashtë shtetit. Materiali informues është përgatitur për të qartësuar procedurat për kthimin dhe ri-integrimin e qytetarëve shqiptarë në Shqipëri. Një memorandum mirëkuptimi për menaxhimin e përbashkët të informacionit mbi migrimin de paligjshëm u nënshkrua me partnerët e Ballkanit Perëndimor.

Megjithatë, Shqipëria vazhdon të jetë vend tranzit për migrantët ekonomikë, azil-kërkuesit dhe personat e trafikuar. Kërkohet një sistem me efektiv për menaxhimin e të dhënave mbi azilin dhe migrimin, në veçanti në zbatim të angazhimeve ndërkombëtare të Shqipërisë. Bashkëpunimi me vendet fqinje përsa i përket migrimit të parregullt duhet të përmirësohet. Mjediset për pritjen dhe marrjen e të dhënave të migrantëve të parregullt në pikat e kalimit kufitar, duhet të përmirësohen. Qendrat e pritjes do të përfitonin nga trajnime të mëtejshme të stafit dhe nga shtimi i specialistëve ligjorë, socialë dhe psikologjikë.

Për zbatimin e Marrëveshjes së Ripranimit ndërmjet KE-Shqipëri, aktualisht po negociohen protokollat e ripranimit me Austrinë dhe Slloveninë, me vendet e rajonit dhe vendet e origjinës të migrantëve që kalojnë transit nëpër Shqipëri, si Turqia dhe Moldavia.

Ligji i ri për Policinë e Shtetit dhe struktura e re e policisë kufitare dhe të migrimit, synojnë të forcojnë kapacitetet e policisë me synim që të përmbushë detyrimet e saj në kuadrin e marrëveshjes së ripranimit. Megjithatë, ka rrezik që shkurtime në policinë kufitare dhe të migrimit të kufizojnë kapacitetet e Shqipërisë për përmbushjen e detyrimeve në planin afatshkurtër.

Shqipëria ka realizuar pjesërisht objektivat në fushën e migrimit.

#### 4.3.2. *Pastrimi i parave*

Disa përparime, por jo të njëllojta, janë bërë në luftën kundër **pastrimit të parave**. Qeveria ka përmirësuar përdorimin e sistemit bankar të vendit. Ligji për taksat u amendua për të penalizuar firmat që nuk paguanin rrogat nëpërmjet bankave. Pothuajse të gjitha rrogat e administratës publike paguhën tani nëpërmjet bankave. Kodi penal u amendua për ta bërë vepër penale mbajtjen e mallrave të vjedhura. Kjo mund të përmirësojë ndjeshëm luftën kundër pastrimit të parave nëse zbatohet ashtu siç duhet. Disa përparime janë bërë në modernizimin e sistemit IT të Njësisë së Inteligjencës Financiare (FIU) në Ministrinë e Financës dhe për krijimin e linjeve elektronike me bankat. Inspektive janë bërë në zyrat rajonale të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, si dhe në noteri. Me dekret qeveritar, shkëmbimi valutor u lejohet vetëm agjencive të licencuara. FIU dhe Banka e Shqipërisë ndërmorën një seri inspektimesh të përbashkëta të bizneseve të shkëmbimit valutor në Tiranë. Ministria e Brendshme dhe ajo e Financës, Prokuroria e Përgjithshme dhe Shërbimi Informativ Shtetëror kanë krijuar një njësi të përbashkët për hetimin dhe ndjekjen penale të krimit financiar, duke zëvendësuar task-forcën për krimin ekonomike dhe korrupsionin në prokurorinë e rrethit Tiranë.

Bashkëpunimi operativ ndërkombëtar gradualisht po përmirësohet. FIU ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me 26 vende, përfshirë shtatë vende anëtare të BE-së, dhe tani po negocion marrëveshje me gjashtë të tjera. Shqipëria ratifikoi Konventën e Këshillit të Evropës për Pastrimin, Kërkimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e të Ardhurave nga Krimi dhe për Financimin e Terrorizmit. Njësia policore e krimit ekonomik ka kryer disa operacione të suksesshme kundër falsifikimit të valutës, gjatë të cilave bllokoi valutat false dhe arrestoi të dyshuarit.

Megjithatë, rezultatet praktike në luftën kundër pastrimit të parave mbeten të pakta. Ekonomia e Shqipërisë, veçanërisht sektori privat, për pjesën më të madhe bazohet në para-në dorë (*cash*). Kjo e bën të vështirë operimin e mekanizmave të kontrollit të shtetit. Grupet e krimit të organizuar e përdorin Shqipërinë si bazë për aktivitete kriminale në vende të tjera. Vendi atëherë mbetet në rrezik domethënës për sa i përket pastrimit të parave. Ligji për pastrimin e parave po rishikohet, por akoma nuk është në të njëjtën linjë me *acquis* dhe rekomandimet e Task-Forcës për Aksion Financiar dhe të 'Moneyval' të Këshillit të Evropës. Mospërputhjet midis dispozitave të kodit penal dhe kodit doganor, nuk janë rregulluar akoma.

Burimet hetuese dhe ekspertiza, mbështetja teknologjike dhe bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të përfshira në luftën kundër pastrimit të parave, mbeten të pakta. NJIF (FIU) mbetet e varur nga Ministria e Financës për buxhetin e saj dhe stafin. Rekrutimi i stafit dhe nisja e operacioneve në Njësinë e re të Përbashkët për Krimin Ekonomik dhe Korrupsionin janë të vonuara. Numri dhe përvoja e pamjaftueshme e stafit po pengojnë performancën e Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara. Aktet zbatuese për administrimin efikas të pasurive të

konfiskuara ende nuk janë përfunduar. Kërkohet mbështetje e mëtejshme nga Ministria e Financës dhe agjencitë ndërkombëtare të fushës.

Nuk ka pasur progres në vendosjen e mekanizmave që kontrollojnë paranë në dorë (*cash*). Niveli i raportimit dhe sekuestrimit mbetet shumë i ulët dhe nuk reflekton nivelin e parave që hyjnë e dalin nga vendi. Ende nuk po aplikohen sanksione për mos-raportimin. Raporti ndërmjet raporteve për transaksione të dyshimta dhe hetimeve, ndjekjeve penale apo dënimeve, mbetet i ulët. Përgatitjet për luftën kundër pastrimit të parave janë në fazë fillestare.

#### 4.3.3. Drogat

Progres ka pasur në luftën kundër **drogës**, por trafiku i drogës mbetet një shqetësim serioz.

Operacionet policore rezultuan në kapjen e sasive të mëdha të drogës. Ligji që penalizon autoritetet vendore dhe inspektorët e policisë lokale për mos-raportimin e kultivimit të drogës në zonat e tyre, ka rritur suksesin e operacioneve policore. Kultivimi i kanabisit brenda vendit ka rënë me 70% dhe çmimi i saj është rritur, çka tregon sukses në kufizimin e sasisë në qarkullim.

Progres ka pasur në zbatimin e planit të veprimit lidhur me strategjinë kombëtare anti-drogë dhe rekomandimet e Mini-Grupit të Dublinit. Është përmirësuar koordinimi midis njësive të policisë antidrogë, policisë kufitare dhe doganave. Bashkëpunimi me shërbimin sekret shtetëror vazhdon të jetë i mirë. Po përdoren më mirë task-forcat kundër lëndëve narkotike, çka po sjell bashkimin e agjencive për çështjet e drogës. Bashkëpunimi me partnerët në vende të tjera, po përmirësohet. Instituti shkencor i Policisë është pajisur me mjete të reja. Po ndërtohet infrastruktura e duhur për magazinimin e drogës së sekuestruar.

Megjithatë, rritja e kërkesës për drogë në Evropë vazhdon të inkurajojë trafikun e drogës përmes Shqipërisë. Trafikantët shqiptarë kanë vendosur lidhje të forta me rrjetet ndërkombëtare të drogës. Tregjet kryesore për drogën mbeten Italia dhe Greqia, por edhe tregu i brendshëm po zgjerohet, sidomos Tirana. Sasitë e kapura nga autoritetet shqiptare mbeten të vogla në krahasim me sasitë që llogaritet se kalojnë nga Shqipëria. Në shumë raste trafiku i armëve dhe municioneve ndërthuret me trafikun e drogës.

Progres i mëtejshëm nevojitet në zbatimin e planit të veprimit të strategjisë kombëtare anti-drogë dhe të rekomandimeve të Mini-Grupit të Dublinit. Kërkohet bashkëpunim më i mirë ndërmjet policisë dhe gjyqësorit për ndjekjen penale të trafikantëve të dyshuar të drogës, veçanërisht në nivele të larta, për akuza të rënda në këtë aspekt. Kjo vlen edhe për personat e korrumpuar në të gjitha nivelet e administratës publike në lidhje me trafikun e drogës. Rrjedhja e informacionit në operacionet anti-drogë, ende nuk po parashikohet si vepër penale. Njësitë policore anti-drogë kanë nevojë për personel më të qëndrueshëm në mënyrë që të ruhen kapacitetet dhe të përfitojnë plotësisht nga nismat trajnuese ndërkombëtare. Sensibilizimi i publikut për drogën dhe infrastrukturën e trajtimit të abuzuesve me drogën, mbetet i kufizuar. Ende nuk janë promovuar alternativa ndaj kultivimit të drogës. Nuk ka pasur përpjekje sistematike për të evidentuar shkallën dhe natyrën e prodhimit të brendshëm të drogave sintetike si dhe ekspertiza në lidhje me këtë është akoma e kufizuar.

Sekuestrimet në pikë-kalimet kufitare janë minimale. Në pikë-kalimet kufitare dhe në kufirin e gjelbër (tokësor), duhet të përmirësohen masat diktuese dhe pajisjet. Të dhënat dhe procedurat e

magazinimit të drogës dhe asgjësimit të saj, duhet të përmirësohen dhe të standardizohen. Në luftën kundër drogës, Shqipëria po avancon në mënyrë të moderuar.

#### *4.3.4. Policia*

Disa përparime të mira, por jo të të njëtrajtshme, janë bërë në fushën e policisë. Parlamenti ka miratuar një ligj të ri për Policinë e Shtetit (shiko seksionin për Qeverinë) i cili përcakton menaxhimin e përmirësuar të burimeve njerëzore, materiale dhe financiare. Ligji i ri i kalon këto funksione nga Ministria e Brendshme tek policia. Ky është një hap i rëndësishëm drejt depolitizimit të policisë. Një strukturë e re organizative për policinë është miratuar nga Ministri i Brendshëm. Puna e policisë gjatë zgjedhjeve lokale të shkurtit 2007 ka qenë profesionale dhe e paanëshme.

Shqipëria ka nënshkruar një marrëveshje strategjike me Europol-in. Kjo marrëveshje siguron një bashkëpunim më të ngushtë dhe shkëmbime më të mirë të niformacioneve. Shqipëria ka ratifikuar Konventën e Bashkëpunimit Policor të Vendeve të Europës Juglindore. Një marrëveshje bashkëpunimi për trajtimin e krimit financiar dhe akteve korruptive është nënshkruar midis Ministrive të Brendshme dhe të Financës, Shërbimit Inteligent Shtetëror dhe Prokurorisë. Një grup pune po adreson çështjen e përmirësimit të përcaktimit të gradave në polici. Një strategji vëzhgimi policor të komuniteteve është aprovuar.

Shkurtimi i numrit të personelit policor nga 11,300 në 10,500 ka qenë i nevojshëm por është bërë pa vëmendjen e nevojshme për të ruajtur kapacitetet dhe vazhdimësinë e menaxhimit në disa njësi kyçe. Hetimi i suksesshëm dhe përndjekja ende pengohen nga komunikimi jo i mirë dhe nga procedura të menaxhimit të çështjeve që nuk përpunohen midis policisë dhe prokurorisë veçanërisht në nivel rrethi. Menaxhimi i policisë duke përfshirë menaxhimin e veprimtarisë dhe strukturat e kontrollit të brendshëm duhet të forcohen. Nuk ka ende në veprim një manual procedural për të gjithë punonjësit e policisë. Më shumë përpjekje duhen bërë për të bërë të mundur që oficerët e policisë të ndiqen penalisht për veprimtari kriminale në vend që të pushohen nga puna.

Kapacitetet policore për të parandaluar dhe për të regjistruar krimin mbeten të dobta. Një projekt-ligj që lejon përdorimin e automjeteve të sekuestruara nga policia dhe prokuroria është akoma në pritje për miratim në parlament. Kontroll më i rreptë nga policia rrugore dhe punë edukuese më e mirë nevojiten për përmirësimin e sigurisë së trafikut rrugor. Prgatitjet në fushën e policisë kanë përparuar por përmirësimet strukturore duhet që tani të pasohen nga rezultate në operacione.

#### *4.3.5. Lufta kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit*

Përparim jo i njëtrajtshëm është shënuar në luftën kundër **krimit të organizuar**, një prioritet kyç i Partneritetit Europian. Krimi i organizuar mbetet një prolem shumë serioz në Shqipëri.

Një numër arrestimesh të profilit të lartë në këtë fushë si brenda dhe jashtë vendit ka përmirësuar situatën e sigurisë në qytetet shqiptare dhe ka ndihmuar në rritjen e besimit të publikut për forcat e policisë. Përgjigjja e policisë ndaj krimeve të rënda është përmirësuar dhe në shumicën e rasteve autorët janë arrestuar brenda 48 orëve. Pajisje të reja taktike dhe hetimi janë futur në veprim duke

rritur kapacitetet e policisë në kundërpërgjigjen ndaj krimit të organizuar dhe grabitjeve me armë.

Bashkëveprimi ndërmjet Interpol Tirana dhe zyrave homologe, veçanërisht në vendet fqinje, është përmirësuar. Kjo ka bërë të mundur zbatimin e një numri të konsiderueshëm mandatesh arresti ndërkombëtar që kanë rezultuar në ekstradime të të dyshuarve për t'u përballur me procese gjyqësore në Shqipëri. Bashkëveprimi me vendet fqinje për të lufuar vjedhjet e automjeteve është përmirësuar. Disa operacione të suksesshme kundër trafikut të armëve kanë rezultuar në kapje të sasive të konsiderueshme armësh dhe municionesh, shumica e të cilave u vodhën nga depot e ushtrisë në 1997.

Megjithatë, mbetet fushë e konsiderueshme për përmirësimin e rezultateve për sa i përket ndjekjes penale të shkeljeve dhe sekuestrimit të të ardhurave nga krimi. Shumë kërkesa arresti ndërkombëtar nuk kanë gjetur zbatim nga autoritetet shqiptare. Bashkëpunimi midis policisë dhe prokurorisë veçanërisht në përdorimin e mjeteve hetuese speciale duhet të përmirësohet. Përpjekjet kundër krimit të organizuar pengohen në mënyrë të konsiderueshme nga korrupsioni në të gjitha nivelet e autoriteteve policore. Hetimet dhe përndjekjet e rasteve të korrupsionit në polici dhe gjyqësor nuk kanë akoma vendosmërinë e duhur.

Nuk ka pasur progres domethënës në startegjinë e përforsimit dhe koordinimit mes oficerëve të policisë dhe agjencive të ngarkuara me shpenzimet publike dhe prokurimet. Dobësitë në mbrojtjen e dëshmitarëve vazhdojnë të pengojnë ndjekjet penale të krimit të organizuar. (shiko gjithashtu seksionin mbi sistemin gjyqësor).

Potenciali i Njësisë policore të Inteligjencës Kriminale nuk mund të arrihet plotësisht deri sa kompjuterat e Drejtorisë së Përgjithshme policore të lidhen me serverat e database të reja MEMEX në Ministrinë e Brendshme. Njësia Speciale Operative policore pengohet nga mungesa e vazhdimsisë së menaxhimit. Plan-veprimi kombëtar kundër trafikimit të automjeteve të vjedhura nuk është aprovuar akoma. Çështja e automjeteve të vjedhura përfshin policinë, doganat dhe autoritetet e regjistrimit të automjeteve dhe zyrat e taksave. Koordinimi i dobët i këtyre autoriteteve pengon suksesin në luftën kundër vjedhjes së automjeteve. Policia është duke zhvilluar një strategji kombëtare për luftimin e trafikimit të automjeteve të vjedhura, por kjo nuk është ende e përfunduar. Në fushën e luftës kundër krimit të organizuar, Shqipëria ka avancuar në mënyrë të moderuar.

Ka pasur disa përparime në luftën kundër **trafikimit të qënieve njerëzore**, të cilën qeveria ka vazhduar ta hetojë dhe ta ndjekë penalisht në mënyrë të vendosur. Kontrollat kufitare janë bërë më efektive. Bashkëpunimi me vendet fqinje dhe vendet e tjera është përmirësuar. Kodi penal është amenduar për të penalizuar trafikimin e qënieve njerëzore. Një numër telefoni kombëtar pa pagesë është hapur në ndihmë të viktimave të trafikimit. Shqipëria ratifikoi Konventën e Këshillit të Europës mbi Veprimin Kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore dhe një marrëveshje dypalëshe me Greqinë mbi trafikimin e fëmijëve. Qeveria ka vazhduar me përpjekjet e saj modeste të mbrojtjes dhe ri-integrimit të viktimave të trafikimit. Ministria e Punës Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta ka zbatuar një program micro-kredie për viktimat femra të trafikimit për t'i ndihmuar ato të hapin biznese të vogla, për të inkurajuar ri-integrimin dhe për të ndaluar ri-trafikimin e tyre.

Megjithatë, Shqipëria është ende një vend transit i rëndësishëm dhe nivelet e trafikimit seksual të femrave dhe fëmijëve (kryesisht nga komuniteti Rom) janë rritur. Shkurtime të stafit kanë ulur



kapacitetin e njësive policore anti-trafikim. Databaza e planifikuar për ndjekjen e çështjeve të viktimave nuk funksionon ende. Në 2006 vetëm 20 nga 227 viktima të dyshuara apo të identifikuar të trafikimit ishin të gatshme të dëshmonin kundër trafikantëve të tyre, për shkak të mbrojtjes së dobët të dëshmitarëve. Një koordinim më i mirë midis organeve të përfshira do të përmirësonte elementët e identifikimit, mbrojtjes, ri-integrimit dhe rehabilitimit të strategjisë kombëtare kundër trafikimit. Masa të veçanta për kthimin e grave dhe fëmijëve nuk janë vendosur ende në vendet pritëse kufitare. Rrjeti i Shqipërisë për marrëveshjet e bashkëpunimit operacional me partner rajonal dhe ndërkombëtar në trafikimin e qënieve njerëzore duhet të zgjerohet. Shqipëria ka arritur vetëm pjesërisht objektivat e saj në luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore.

Në luftën kundër **terrorizmit**, Shqipëria po avancon. Strukturat anti-terrorizëm (counter-terrorism) në shërbimet policore dhe informative (intelligence) aktualisht po bashkëpunojnë mirë. Bashkëpunimi me aktorët ndërkombëtarë të fushës ka qenë i mirë. Shqipëria ka ratifikuar Konventën e Këshillit të Europës për Parandalimin e Terrorizmit. Shqipëria ka miratuar një ligj për kontrollin e eksporteve për pajisje dhe teknologji ushtarake që është në një linjë me *acquis*.

Drejtoria policore e anti-terrorizmit është duke zhvilluar një strategji kundër terrorizmit, e cila qartëson ndarjen e detyrave ndërmjet autoriteteve shtetërore, por kjo nuk është përfunduar ende. Punë e mëtejshme nevojitet për të afruar legjislacionin shqiptar me detyrimet ndërkombëtare për parandalimin e terrorizmit. Kjo përfshin përkufizimin e terrorizmit që në legjislacionin shqiptar mbulon akte që nuk janë të njohura ndërkombëtarisht si akte terroriste. Pajisjet dhe trajnimi për analistët dhe hetuesit anti-terrorizëm mbeten të pamjaftueshme. Përgatitjet në luftën kundër terrorizmit kanë avancuar në mënyrë të moderuar.

#### 4.3.6 Mbrojtja e të dhënave personale

Ka pasur përparim të kufizuar në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Ministria e Drejtësisë po rishikon Ligjin e 1999 për mbrojtjen e të dhënave personale për ta sjellë atë në linjë me *acquis* dhe standartet e Këshillit të Europës. Megjithatë, një autoritet mbikqyrës për mbrojtjen e të dhënave me kompetenca të mjaftueshme mbi sektorin publik dhe privat dhe burime të mjaftueshme nuk është ngritur ende. Përgatitjet në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale janë në fazë fillestare.

Shtojca Statistikore

**TË DHËNAT BAZË (që nga 5 tetori 2007)**

**Shqipëria**

<b>Të dhënat bazë</b>	<b>Shënim</b>	<b>1997</b>	<b>1998</b>	<b>1999</b>	<b>2000</b>	<b>2001</b>	<b>2002</b>	<b>2003</b>	<b>2004</b>	<b>2005</b>	<b>2006</b>
Popullsia (mijëra)	1)	3 088	3 061	3 049	3 058	3 063	3 084	3 103	3 120	3 135	3 149
Sipërfaqja totale e vendit (km <sup>2</sup> )		28 750	28 750	28 750	28 750	28 750	28 750	28 750	28 750	28 750	28 750
<b>Llogaritë kombëtare</b>	<b>Shënim</b>	<b>1997</b>	<b>1998</b>	<b>1999</b>	<b>2000</b>	<b>2001</b>	<b>2002</b>	<b>2003</b>	<b>2004</b>	<b>2005</b>	<b>2006</b>
PBB (në milionë lek)		346.198	409.209	471.579	523.043	583.369	622.711	694.098	751.024	817.374p	:
PBB (në milionë euro)	:	:	2 419	3 209	3 945	4 541	4 705	5 048	5 883	6 582	:
PBB (në euro për frymë)	:	:	790	1 052	1 290	1 483	1 526	1 627	1 885	2 099	:
PBB (sipas Standardeve të Fuqisë Blerëse (SFB) për Frymë)	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
TS: PBB (në SFB për frymë), BE-25=100)	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
TS: Norma e rritjes e PBB-së, lek, çmime konstante, % ndryshim nga viti pararendës)	-10.8	9.0	13.5	6.7	7.9	4.2	5.8	7.5	5.8p	:	:
TS: Rritja e Punësimit (llogaritë kombëtare, % ndryshim nga viti pararendës)	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Rritja e prodhueshmërisë së punës: rritja PBB për person të punësuar (% ndryshim nga viti pararendës)	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
TS: Rritja e kostos për njësi punë (llogaritë kombëtare, % ndryshim nga viti pararendës)	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
TS: Prodhueshmëria e punës (PBB në SFB për person të punësuar, BE-25=100)	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Vlera bruto e shtuar nga sektorët kryesorë (%)											
Bujqësia		31.6	28.8	25.8	25.5	23.6	23.4	23.5	22.3	20.7p	:
Industria		8.8	7.4	7.3	7.8	7.3	6.9	6.7	10.0	9.7p	:
Ndërtimi		6.1	5.0	6.0	8.3	10.4	12.0	13.7	13.9	14.3p	:
Shërbimet		53.5	58.8	60.9	58.5	58.6	57.6	54.0	53.8	55.3p	:
Shpenzimet e konsumit final, si përqindje e PBB-së (%)		107.5	102.4	92.7	86.0	80.9	86.0	86.1	89.2	87.0p	:
Familjet dhe NPISH, si përqindje e PBB-së (%)		97.3	92.2	82.7	76.6	70.5	74.8	75.2	78.2	76.2p	:
Qeveria e përgjithshme, si përqindje e PBB-së (%)		10.2	10.3	10.0	9.5	10.4	11.2	10.9	11.0	10.8p	:
Formacioni i kapitalit fiks bruto, si përqindje e PBB-së (%)		20.5	21.0	23.0	31.7	38.4	37.9	40.5	37.2	36.3p	:
Ndryshimet në inventarë, si përqindje e PBB-së (%)	2)	-3.5	0.3	0.7	2.4	1.3	0.8	-1.8	-4.0	1.2p	:
Eksportet e mallrave dhe shërbimeve, në funksion me PBB (%)		9.7	10.8	15.8	17.9	18.4	19.6	20.4	22.0	22.8p	:
Importet e mallrave dhe shërbimeve, në funksion me PBB (%)		34.2	34.6	32.2	38.1	39.0	44.3	45.1	44.4	47.3p	:
<b>Industria</b>	<b>Shënim</b>	<b>1997</b>	<b>1998</b>	<b>1999</b>	<b>2000</b>	<b>2001</b>	<b>2002</b>	<b>2003</b>	<b>2004</b>	<b>2005</b>	<b>2006</b>
Indeksi i vëllimit të prodhimit industrial (2000=100)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
<b>Norma e inflacionit</b>	<b>Shënim</b>	<b>1997</b>	<b>1998</b>	<b>1999</b>	<b>2000</b>	<b>2001</b>	<b>2002</b>	<b>2003</b>	<b>2004</b>	<b>2005</b>	<b>2006</b>
TS: Indeksi i Çmimit të Mallrave të Konsumit (CPI), (total, %ndryshim nga viti pararendës)	3)	:	8.7	-1.0	4.2	3.5	1.7	3.3	2.2	2.0	2.5
<b>Bilanci i pagesave</b>	<b>Shënim</b>	<b>1997</b>	<b>1998</b>	<b>1999</b>	<b>2000</b>	<b>2001</b>	<b>2002</b>	<b>2003</b>	<b>2004</b>	<b>2005</b>	<b>2006</b>
Bilanci i pagesave: totali i llogarive rrjedhëse (në milion euro)		- 313	- 61	- 129	- 185	- 315	- 422	- 331	- 288	- 493	- 535
Llogaria rrjedhëse e bilancit të pagesave: bilanci tregtar (në milion euro)		- 474	- 537	- 626	- 897	- 1 149	- 1 218	- 1 177	1 277	- 1 477	- 1 685
Llogaria rrjedhëse e bilancit të pagesave: eksporti i mallrave (në milion euro)		140	185	258	277	340	348	395	486	530	631
Llogaria rrjedhëse e bilancit të pagesave: importi i mallrave (në milion euro)		615	722	884	1 174	1 489	1 567	1 572	1 762	2 007	2 316
Llogaria rrjedhëse e bilancit të pagesave: shërbimet neto (në milion euro)		-30	- 38	96	12	100	- 8	- 72	- 41	- 140	- 67

Llogaria rrjedhëse e bilancit të pagesave: të ardhurat neto (në milion euro)	36	69	71	115	156	138	151	143	135	236
Llogaria rrjedhëse e bilancit të pagesave: transferuat rrjedhëse neto (në milion euro)	155	445	330	586	578	666	767	887	989	1 009
nga të cilat transferata të qeverisë	25	73	156	105	31	41	53	61	61	43
Investimet e Huaja të Drejtpërdrejta (FDI) në ekonominë raportuese (në milion euro)	42	40	39	157	231	141	157	278	224	259

#### Financat publike

	Shënim	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006
Deficiti i përgjithshëm qeveritar/teprica, lidhur me PBB (%)		- 12.7	- 11.6	- 9.0	- 7.6	- 6.9	- 6.1	- 4.9	- 5.1	- 3.4	- 3.3
TS: borxhi i përgjithshëm qeveritar, lidhur me PBB (%)		49.8	53.5	53.7	60.2	58.5	63.9	61.5	58.3	55.3	59.7

#### Treguesit financiarë

	Shënim	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006
Borxhi i huaj bruto i tërë ekonomisë, lidhur me PBB (%)		15.0	17.0	16.1	17.0	17.2	22.1	21.1	19.0	16.6	16.9
Borxhi i huaj bruto i tërë ekonomisë, lidhur me eksportin total (%)	4)	15.3.4	156.3	101.6	94.9	93.1	112.5	103.5	86.5	73.0	:
Oferta e parasë: M 1 (kartëmonedhat, monedhat, depozitat ditore (në milion euro)		537	496	701	936	1 113	1 154	1 053	1 354	1 833	2 011
Oferta e parasë: M 2 (M 1 plus depozitat me maturim deri në dy vjet (në milion euro)		950	1 180	1 631	1 995	2 376	2 453	2 542	3 066	3 431	3 882
Oferta e parasë: M 3 (M 2 plus instrumentet e tregtueshme (në milion euro)		1 162	1 418	1 993	2 475	3 069	3 148	3 261	3 973	4 654	5 479
Kreditit total i institucioneve financiare monetare për rezidentët (konsoliduar) (mln euro)		:	105	135	175	218	292	369	4548	982	1 554
Normat e interesit: norma ditë-pas-dite e parasë, vjetore (%)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Norma e interesit të huas (një vit), vjetore (%)	5)	43.0	25.0	25.8	24.0	11.9	16.0	10.5	13.7	12.2	11.2
Normat e interesit të depozitave (një vit), vjetore (%)	6)	27.8	16.5	9.1	8.0	7.8	9.3	7.6	6.0	5.6	5.5
Normat e shkëmbimit të euros: mesatarja e periudhës – 1 euro = ... monedhë vendase		:	169.164	146.960	132.580	128.470	132.360	137.510	127.670	124.190	123.080
Indeksi efektiv i normës së shkëmbimit (2000=100)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Vlerat e asetëve në rezervë (përfshi arin) (në milion euro)		500	573	488	696	853	902	908	1 103	:	:

#### Tregtia e jashtme

	Shënim	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006
Bilanci tregtar: të gjithë mallrat, tërë partnerët (në milion euro)		- 433	- 565	- 754u	- 896	- 1 145	- 1 259	- 1 252	- 1 344	- 1 585	:
Vlera e eksporteve: të gjithë mallrat, tërë partnerët (në milion euro)		121	185	329u	283	341	331	395	479	532	:
Vlera e importeve: të gjithë mallrat, tërë partnerët (në milion euro)		555	750	1083u	1 179	1 486	1 590	1 648	1 823	2 116	:
Kushtet/Termtat tregtarë (indeksi i çmimit të eksporteve/ importeve, (%) ndryshim nga viti pararendës		91.3	96.2	106.8	100.2	101.5	99.9	98.2	99.0	80.3	100.6
Përqindja e eksportit ndaj BE-27 vende në vlerën e importit total (%)		89.8	94.2	95.6u	93.2	91.3	92.6	93.8	90.9	89.4	:
Përqindja e eksportit ndaj BE-27 vende në vlerën e importit total (%)		89.9	88.0	82.8u	80.7	80.3	77.0	74.3	70.5	67.2	:

#### Demografia

	Shënim	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006
Bilanci tregtar: të gjithë mallrat, tërë partnerët (në milion euro)	1)	14.1	13.7	13.5	11.4	12.5	9.5	9.3	8.1	7.2	5.5
Vlera e eksporteve: të gjithë mallrat, tërë partnerët (në milion euro)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Vlera e importeve: të gjithë mallrat, tërë partnerët (në milion euro)	1)	22.2	15.0	12.2	11.9	10.8	10.2	8.4	7.8	7.6	7.4
Kushtet/termtat tregtare (indeksi i çmimit të eksportit/importit, (%) ndryshim nga viti pararendës	1)	:	:	71.7	72.1	72.1	72.1	72.1	72.1	72.1	73.9
Përqindja e eksportit ndaj BE-27 vende në vlerën e importit total (%)	1)	:	:	76.4	78.6u	77.5	77.9	78.6	78.6	78.6	78.0

#### Tregu i punës

	Shënim	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006
Norma e aktivitetit ekonomik (15-64: përqindja e pop. 15-64 vjeç ekonomiksht aktive (%)	7)	:	:	68.3	66.2	62.3	61.8	60.1	58.8	57.8	:
TS: Norma e punësimit (15-64): përqindja e pop. 15-64 vjeç që është e punësuar (%)	7)	:	:	55.7	55.0	52.1	52.1	51.1	50.3	49.7	:
Përqindja e popullsisë meshkuj të moshës 15-64 vjeç që është e punësuar (%)	7)	:	:	69.0	66.0	64.0	63.9	62.6	61.2	60.0	:
Përqindja e popullsisë femra të moshës 15-64 vjeç që është e punësuar (%)	7)	:	:	42.3	44.1	39.6	39.7	39.1	38.9	38.8	:
TS: Norma e punësimit e punëtorëve më në moshë (55-64): përqindja e popullsisë me moshë 55-64 që është e punësuar (%)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:

Punësimi nga sektorët kryesorë (%)											
Bujqësia	7)	69.6	70.8	72.1	71.8	57.7	57.7	58.2	58.5	58.5	:
Industria	7)	7.9	7.7	7.7	5.4	6.0	7.6	7.2	8.1	7.9	:
Ndërtimi	7)	1.4	1.0	1.0	1.2	6.1	6.1	6.0	5.5	5.5	:
Shërbimet	7)	21.0	20.5	19.2	21.5	28.5	28.6	28.5	27.9	28.1	:
TS Norma e papunësisë: përqindja e krahut të punës i papunësuar (%)	8)	:	:	18.4	16.8	16.4	15.8	15.0	14.4	14.1	:
Përqindja e krahut të punës meshkuj që janë të papunësuar (%)	8)	:	:	16.4	14.9	14.2	13.6	12.9	12.4	12.1	:
Përqindja e krahut të punës femra që janë të papunësuar (%)	8)	:	:	21.4	19.3	19.9	19.1	18.2	17.5	17.2	:
Norma e papunësisë e personave < 25 vjeç: përqindja e krahut të punës me moshë < 25 vjeç që është e papunësuar (%)	9)	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
TS Norma e papunësisë afatgjatë: përqindja e krahut të punës në papunësi afatgjatë (%)	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
<b>Kohezioni social</b>	<b>Shënim</b>	<b>1997</b>	<b>1998</b>	<b>1999</b>	<b>2000</b>	<b>2001</b>	<b>2002</b>	<b>2003</b>	<b>2004</b>	<b>2005</b>	<b>2006</b>
Rrogat dhe pagat mesatare mujore nominale (monedha vendase)	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Indeksi i rrogave dhe pagave reale: indeksi i rrogave dhe pagave nominale të ndara nga CPI (2000=100)	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
TS:Braktisja e hershme e shkollës: përqindja e popullsisë me moshë 18-24 vjeç që nuk ka përfunduar arsimin e mesëm dhe që aktualisht nuk merr arsimim ose formim profesional (%)	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
<b>Standardi i jetesës</b>	<b>Shënim</b>	<b>1997</b>	<b>1998</b>	<b>1999</b>	<b>2000</b>	<b>2001</b>	<b>2002</b>	<b>2003</b>	<b>2004</b>	<b>2005</b>	<b>2006</b>
Numri i makinave pasagjerësh për 1000 banorë	:	24.9	29.7	30.3	37.5	43.6	48.2	56.4	60.9	62.2	71.5
Numri i abonimeve në shërbimin celular për 1000 banorë	:	:	:	:	:	120.8	259.4	370.6	403.5	488.0	561.8
<b>Infrastruktura</b>	<b>Shënim</b>	<b>1997</b>	<b>1998</b>	<b>1999</b>	<b>2000</b>	<b>2001</b>	<b>2002</b>	<b>2003</b>	<b>2004</b>	<b>2005</b>	<b>2006</b>
Dendësia e rrjetit hekurudhor (linja në funksionim, për 1000 km <sup>2</sup> )	:	:	:	:	13.9	14.3	15.0	15.0	15.1	15.0	15.5
Gjatësia e autostradave (mijëra km)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>Novacioni dhe kërkimi shkencor</b>	<b>Shënim</b>	<b>1997</b>	<b>1998</b>	<b>1999</b>	<b>2000</b>	<b>2001</b>	<b>2002</b>	<b>2003</b>	<b>2004</b>	<b>2005</b>	<b>2006</b>
TS: Shpenzimet për burimet njerëzore (shpenzimet publike për arsimin (lidhur me PBB (%)	:	3.3	3.2	3.3	3.1	3.3	3.0	3.1	3.2	3.2	:
TS: Shpenzimet e brendshëm bruto për kërkimin shkencor dhe zhvillimin, lidhur me PBB (%)	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
TS: Përqindja e familjeve që kanë akses interneti në shtëpi (%)	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
<b>Mjedisi</b>	<b>Shënim</b>	<b>1997</b>	<b>1998</b>	<b>1999</b>	<b>2000</b>	<b>2001</b>	<b>2002</b>	<b>2003</b>	<b>2004</b>	<b>2005</b>	<b>2006</b>
TS: Totali i shkarkimeve të gazrave serë, CO2 ekuivalent (tonë, 1990=100)	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
TS: Intensiteti energjetik i ekonomisë (kg i ekuivalentit të naftës për 1000 euro Pbb0	10)	:	510.2	427.4	394.4	383.1	353.9	369.2	383.9	:	:
TS: Përqindja e energjisë së rinovueshme në konsumin e energjisë elektrike (%)	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
TS: Transporti rrugor i mallrave si përqindje e transportit total tokësor të mallrave (%)	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
<b>Energjia</b>	<b>Shënim</b>	<b>1997</b>	<b>1998</b>	<b>1999</b>	<b>2000</b>	<b>2001</b>	<b>2002</b>	<b>2003</b>	<b>2004</b>	<b>2005</b>	<b>2006</b>
Prodhimi parësor i të gjithë produkteve të energjisë (mijë TOE)	:	:	1 345	1 113	987	933	896	1 012	1 178	:	:
Prodhimi parësor i naftës së papërpunuar (mijë TOE)	:	360	365	323	314	335	308	539	443	:	:
Prodhimi parësor i antracitit dhe linjtit (mijë TOE)	:	40	49	33	20	15	5	19	19	0	0
Prodhimi parësor i gazit natyror (mijë TOE)	:	18	17	14	12	8	8	12	9	11	11
Importet neto të të gjitha produkteve të energjisë (mijë TOE)	:	:	626	761	858	1 001	965	1 043	1 080	:	:
Konsumi i brendshëm bruto i energjisë (mijë TOE)	:	:	1 971	1 874	1 845	1 934	1 861	2 055	2 258	:	:
Prodhimi/gjenerimi i energjisë (mijë GËH)	:	5.2	5.1	5.4	4.7	3.7	3.2	4.9	5.5	5.5	5.6

<b>Bujqësia</b>	<b>Shënim</b>	<b>1997</b>	<b>1998</b>	<b>1999</b>	<b>2000</b>	<b>2001</b>	<b>2002</b>	<b>2003</b>	<b>2004</b>	<b>2005</b>	<b>2006</b>
Indeksi i vëllimit të prodhimit bujqësor për mallrat dhe shërbimet (çmimet e prodhuesit, viti pararendës = 100)		:	:	:	:	:	:	102.9	105.1	101.2	:
Sipërfaqja totale bujqësore e përdorur (mijëra hektarë)		1 145	1 144	1 144	1 144	1 139	1 140	1 121	1 122	1 077	1 120
Blegtori: gjedh (mijëra kokë, fundi i periudhës)		771	705	720	728	708	690	684	654	655	634e
Blegtori: derra (mijëra kokë, fundi i periudhës)		97	83	99	103	106	114	132	143	147	152e
Blegtori: dele e dhi (mijëra kokë, fundi i periudhës)		3 006	2 923	3 061	3 045	2 933	2 773	2 919	2 739	2 701	2 770e
Prodhimi dhe përdorimi i qumështit në fermë (qumështi total, mijëra ton)		850	861	907	948	984	1 010	1 060	1 064	1 076	1 102e
Prodhimi i të mbjellave: drithëra (përfshi orizin) (mijëra ton, prodhim i korrur)		602	603	498	566	503	519	489	499	511	508
Prodhimi i të mbjellave: panxhar sheqeri (mijëra ton, prodhim i korrur)	11)	51	56	40	42	39	39	50	40	40	:
Prodhimi i të mbjellave: perime (mijëra ton, prodhim i korrur)	12)	572	605	610	620	677	669	675	678	685	688

ST: Treguesi Struktural

e: vlera

f: parashikim

p: e përkohshme

u: e pasigurt

1. Burimi: Eurostat.

2. Ndryshim në inventarë dhe mospërputhje statistikash.

3. ndryshimi midis dhjetorit të një viti krahasuar me dhjetorin e vitit pararendës.

4. Eksportet totale llogariten sipas koncepteve të llogarive kombëtare; borxhi i mbartur i disburuar (DOD) stoku kumulativ që mbulon borxhin publik të jashtëm si dhe borxhi i jashtëm i garantuar publikisht; por duke përjashtuar kreditin FMN.

5. Norma mesatare e ponderuar e aplikuar në huat e reja 12-mujore gjatë muajit përkatës, me maturim 12-mujor.

6. Norma mesatare e oponderuar për depozitat e sapopranuara kundrejt muajit përkatës, me maturim 12-mujor.

7. Thyerje në seri nisur që nga 2001 për shkak të ndryshimit të burimit të të dhënave.

8. Të dhënat administrative; papunësia i referohet papunësisë së regjistruar.

9. 2002, bazuar në Studimin e Kushteve të Jetesës të 1998-ës dhe Studimin e Matjes së Standardeve të Jetesës në 2002.

10. Vlerësime të Eurostat.

11. 2004-2005, vlerësime të FAO-s.

12. Përfshi shalqinjtë